



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2013

P R I S H T I N Ě , Q E R S H O R 2 0 1 4

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti Vjetor 2013

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	15
Fjala hyrëse e Guvernatorit	17
Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit	19
Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2013	23
1. Përmbledhje ekzekutive	25
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	28
2.1. Evropa Juglindore	30
3. Ekonomia e Kosovës.....	32
3.1. Sektori real	32
3.1.2 Çmimet	33
3.2. Sektori fiskal	34
3.2.1 Të hyrat buxhetore	34
3.2.2 Shpenzimet buxhetore	35
3.3. Sektori financiar	35
3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme.....	35
3.3.2 Sektori bankar	37
3.3.3 Fondet pensionale.....	51
3.3.4 Kompanitë e sigurimit.....	52
3.3.5 Institucionet mikrofinanciare.....	53
3.4. Sektori i jashtëm.....	55
3.4.1 Llogaria rrjedhëse	56
3.4.2 Llogaria financiare	59
3.4.3 Pozicioni ndërkombëtare i investimeve.....	61
3.4.4 Borxhi i jashtëm.....	61
3.5 Pritjet për vitin 2014	62
4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare	65
4.1. Licencimi dhe Standardizimi	65
4.1.1 Licencimi	65
4.1.2 Standardizimi dhe Rregullativa	66
4.1.3 Mbrojtja e konsumatorit.....	68
4.2. Mbikëqyrja bankare e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.....	69
4.2.2 Ekzaminimet në vend (on-site) të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare	71
4.3. Parandalimi i pastrimit të parave.....	71
4.4. Mbikëqyrja e sigurimeve	72

4.5. Mbikëqyrja e Pensioneve	74
5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun	78
5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme	78
5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive.....	81
5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar	85
5.4. Menaxhimi i Mjeteve	90
5.4.2 Menaxhimi i Investimeve	90
5.4.2 Menaxhimi i Rrezikut.....	92
5.4.3 Letrat me vlerë	93
5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës	94
5.6. Aktiviteti në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar	97
5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave	97
6. Zhvillimet e brendshme	100
6.1. Auditimi i Brendshëm	100
6.3. Aktiviteti ligjor i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës	102
6.4. Teknologjia Informative	103
7. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	104
7.1. Marrëveshjet, promovimi dhe përfaqësimi ndërkombëtar.....	104
7.2. Asistenca teknike	104
8. Pasqyrat financiare të BQK-së	107
9. Shtojca Statistikore.....	143
10. Referencat.....	163

LISTA E SHKURTESAVE

AJN	Asetet e Jashtme Neto
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ATM	Bankomat (angl. Automated Teller Machine)
ATP	Agjencionet për Transferimin e Parave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (angl. Broad Economic Categories)
BEEP	Projekti mbi Përmirësimin e Ambijentit Biznesor (angl. Business Environment Enhancement Project)
BERZH	Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim
BIC	Business Identifier Code
BIS	Banka për Rregullimin Ndërkombëtar (angl. Bank for International Settlements)
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka për Biznes
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Vendeve të Evropës Qendrore (angl. Central European Free Trade Agreement)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (angl. Consumer Price Index)
DJI	Dow Jones Industrial Average
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSFAE	Departamenti për Stabilitet Financiar dhe Analiza Ekonomike
DST	Drejtat Speciale të Tërheqjes
ECB	Banka Qendrore Evropiane (angl. European Central Bank)
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore (angl. European Fund for Southeastern Europe)
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
EUROSTAT	General Directorate of European Statistics
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSKP	Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve
GBR	Great Britain Pound
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman (angl. Herfindahl-Hirschman Index)
IAIS	Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (angl. International Association for Insurance Supervisors)

IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (angl. Imports Price Index)
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
KKP	Këshilli Kombëtar i Pagesave
KMB	Komercijalna Banka
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTPL	Sigurimi i Auto-Përgjegjësish
NLB	Nova Ljubljanska Banka
NPL	Kreditë Joperformuese (angl. Non Performing Loans)
OJSHEF	Organizata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Procredit Bank
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
POS	Pikë e Shitjes (angl. Point of Sale)
pp	Pikë Përqindje
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (angl. Producer Price Index)
PPP	Pariteti i Fuqisë Blerëse (angl. Purchasing Power Parity)
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RBK	Raiffeisen Bank of Kosovo
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate)
RKK	Regjistri i Kredive të Kosovës
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (angl. Return on Average Assets)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (angl. Return on Average Equity)
RTGS	Shlyerja e Pagesave në Kohë Reale (angl. Real Time Gross Settlement)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Riskut (angl. Risk Weighted Assets)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SEPA	Zona e Përdorimit të Euros si Njësi e Vetme Pagese (angl. Single Euro Payment Area)
SFR	Swiss Franc
SRK	Sistemi i Regjistrimit të Kontabilitetit
SWIFT	Society for Worldwide International Financial Telecommunication
TEB	Türk Ekonomi Bankasi
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TPL	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë (angl. Third Party Liability)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (angl. United Nations Mission in Kosovo)

USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (angl. United States Agency for International Development)
USD	United States Dollar
VPN	Teknologjia e Enkriptimit dhe Lidhjeve Virtuale

LISTA E FIGURAVE

1.	Inflacioni në Eurozonë dhe në disa vende të zgjedhura të Eurozonës-----	28
2.	Papunësia në vende të zgjedhura të Eurozonës -----	29
3.	Norma e kredive joperformuese në vende të zgjedhura të Eurozonës -----	29
4.	Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të Eurozonës -----	29
5.	Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL -----	30
6.	Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL në përqindje të PBB-së-----	30
7.	Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL -----	31
8.	Rritja reale PBB-së -----	32
9.	Komponentët kryesorë të PBB-së -----	32
10.	Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij-----	33
11.	Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	33
12.	Struktura e aseteve të sistemit financiar sipas sektorëve -----	35
13.	Asetet e jashtme neto sipas institucionieve -----	36
14.	Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm-----	36
15.	Vlera e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm dhe ndryshimi vjetor -----	36
16.	Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm-----	37
17.	HHI për asete, kredi dhe depozita -----	37
18.	Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	37
19.	Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar -----	38
20.	Struktura e letrave me vlerë-----	38
21.	Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve-----	39
22.	Struktura e kredive -----	39
23.	Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	39
24.	Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomikë-----	40
25.	Struktura e kredive sipas afatit të maturimit-----	40
26.	Trendi i rritjes së depozitave -----	40
27.	Struktura e depozitave sipas sektorëve -----	41
28.	Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve -----	41
29.	Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit-----	42
30.	Mesatarja vjetore e normave të interesit-----	42
31.	Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve-----	43
32.	Treguesit e profitabilitetit-----	43
33.	Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve-----	43
34.	Struktura e të hyrave-----	44
35.	Struktura e shpenzimeve -----	44
36.	Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar-----	44
37.	Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/detyrime afatshkurtëra-----	45

38.	Raporti NPL/gjithsej kreditë -----	45
39.	Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve-----	46
40.	NPL-të sipas sektorëve-----	46
41.	NPL-të dhe provizionet-----	46
42.	Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj -----	47
43.	Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	47
44.	Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	47
45.	Kapitalizimi i sistemit bankar-----	48
46.	Kapitali rregullativ dhe RWA-të-----	48
47.	Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut-----	49
48.	Struktura e investimeve të TKPK-së -----	49
49.	Struktura e aseteve të FKPK-së -----	51
50.	Struktura e aseteve të FSKP -----	51
51.	Asetet e kompanive të sigurimit-----	52
52.	Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit-----	52
53.	Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	53
54.	HHI për asetet dhe kreditë e IMF-ve -----	54
55.	Struktura e aseteve të IMF-ve -----	54
56.	Normat e interesit në kreditë e IMF-ve -----	54
57.	Raporti shpenzime/të hyra-----	55
58.	Bilanci i llogarisë rrjedhëse-----	55
59.	Importet, eksportet dhe bilanci tregtar-----	56
60.	Gjithsej eksportet dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve-----	57
61.	Gjithsej importet dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit -----	57
62.	Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve-----	57
63.	Struktura e neto eksportit të shërbimeve -----	58
64.	Transferet rrjedhëse-----	58
65.	Remitencat -----	59
66.	Investimet e huaja direkte si përqindje e PBB-së dhe deficitit të llogarisë rrjedhëse-----	60
67.	Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesorë ekonomikë-----	60
68.	Pozicioni ndërkombëtar i investimeve -----	61
69.	Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional -----	61
70.	Borxhi i jashtëm bruto-----	62
71.	Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve-----	62
72.	Çmimi i njësisë – janar dhjetor 2013-----	75
73.	Vlera e njësisë së Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve 2007-2013 -----	77
74.	Furnizimi me para të gatshme-----	78
75.	Pranimi i parave të gatshme -----	78
76.	Furnizimi me kartmonedha euro sipas denominimeve -----	78

77.	Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve -----	78
78.	Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve-----	79
79.	Monedha euro të pranuar sipas denominimeve -----	79
80.	Eksporti i parave të gatshme-----	80
81.	Importi i parave të gatshme -----	80
82.	Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi -----	80
83.	Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi -----	80
84.	Furnizimi me kartëmonedha euro-----	80
85.	Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim-----	80
86.	Paratë euro të falsifikuara të konfiskuara në nivel të Kosovës -----	81
87.	Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse-----	82
88.	Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse-----	82
89.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	82
90.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	82
91.	Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së -----	83
92.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	83
93.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse -----	83
94.	Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	83
95.	Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse -----	83
96.	Numri i transaksioneve në SEKN-----	85
97.	Vlera e transaksioneve në SEKN-----	85
98.	Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN-----	85
99.	Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN -----	85
100.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	86
101.	Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre -----	86
102.	Numri i kartelave të debitit sipas llojit të tyre-----	88
103.	Numri i kartelave të kreditit sipas llojit të tyre -----	88
104.	Numri i terminaleve ATM-----	88
105.	Numri i i terminaleve POS -----	88
106.	Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave -----	89
107.	Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave-----	89
108.	Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së -----	90
109.	Shuma e përgjithshme e mjeteve në portfolio e investimeve -----	90
110.	Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit -----	91
111.	Lëvizja e normave në tregun ndërbankar të eurozonës dhe lëvizja e normave në depozita të investuara nga BQK-----	91
112.	Norma e kthimit të investimeve në portolio dhe rreziku gjatë vitit 2012-----	91
113.	Horizonti kohor mesatar i investimeve të mjeteve financiare -----	92
114.	Shpërndarja e portfolios sipas rangimit kreditor afatshkurtër (S&P) -----	92

115.	Struktura e Letrave me Vlerë të Qeverisë sipas afatit të maturimit -----	93
116.	Struktura e pjesmarrësve në ankande -----	94
117.	Normat mesatare vjetore të kthimit-----	94
118.	Ankandet e bonove të Thesarit-----	94
119.	Numri i përdoruesve të regjistruar -----	94
120.	Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së -----	95
121.	Numri i kredive të reja -----	95
122.	Struktura e kredive sipas klasifikimit -----	95
123.	Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve-----	96
124.	Struktura e kredive joperformuese -----	96
125.	Numri i i kërkesave për raporte kreditore -----	96
126.	Struktura sipas edukimit-----	101

LISTA E TABELAVE

1.	Indikatorë të zgjedhur makroekonomikë -----	28
2.	Numri i institucioneve financiare -----	35
3.	Struktura e aseteve në sektorin bankar -----	38
4.	Struktura e detyrimeve të sistemit bankar -----	41
5.	Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit -----	51
6.	Indikatorët kyç të fondeve pensionale -----	52
7.	Kreditë-Trendi i Arkëtimeve -----	70
8.	Depozitat-Trendi i Rimbursimeve -----	70
9.	Siguruesit dhe origjina e kapitalit -----	73
10.	Struktura e mjeteve sipas origjinës së siguruesëve -----	74
11.	Ekzaminimet e kryera nga mbikëqyrja e pensioneve -----	75
12.	Struktura e investimit të mjeteve pensionale -----	76
13.	Struktura e investimit të mjeteve pensionale nga FSKP-ja -----	77
14.	Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave -----	81
15.	Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive -----	84
16.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara dërguara në SEKN -----	87
17.	Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN -----	87
18.	Numri i llogarive -----	89
19.	Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave -----	90

Lista e kutive

Kutia 1.	Ecuria e Procesit të Likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës -----	70
----------	---	----

Fjala hyrëse e Kryetarit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Në emër të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës kam kënaqësinë që përmes raportit vjetor 2013 t'iu prezantoj tendencat e ecurive kryesore ekonomike gjatë vitit 2013 dhe aktivitetet e BQK-së drejt nxitjes dhe ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar.

Ky raport, në përbërjen e tij është i pasur për sa i përket informacionit të prezantuar dhe gjithëpërfshirës për sa i takon shtrirjes në sektorët ekonomik dhe financiar, në shërbim të lexuesit, qoftë ai publik i gjerë, pjesëmarrës në tregun financiar, bartës i interesit në pronësi apo investitor potencial.

Konform kornizës ligjore të aplikueshme dhe standardeve më të mira të qeverisjes, aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës janë fokusuar në avancimin e kuadrit rregullativ, duke aprovuar një varg rregulloresh të reja, të pasuruara me kërkesat më prudente të kohës në fushën e rregullimit të sektorit financiar, atë të pagesave dhe të bankingut qendror në përgjithësi. Avancimi i kuadrit rregullativ ka zbehur ndjeshëm divergjencat mes kërkesave rregullative të vendeve nga ku ka origjinën pjesa më domethënëse e kapitalit të huaj dhe atij vendor duke e përafëruar atë me direktivat e Bashkimit Evropian. E gjithë kjo duket të jetë pasqyruar favorshëm në performancën e vetë institucioneve financiare duke rritur cilësinë e menaxhimit të rreziqeve, ruajtur mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetit, cilësinë e përgjithshme të portofolit kreditorë, të investimeve dhe mbi të gjitha duke racionalizuar koston e ndërmjetësimit financiar.

Më teje, Bordi i BQK-së ka pasuruar edhe kornizën e përgjithshme qeverisëse të BQK-së duke freskuar strukturën organizative dhe duke e mbështetur atë me një buxhet të përshtatshëm si dhe duke ruajtur pavarësinë financiare dhe operative të saj. Avancimi i kuadrit rregullativ është bërë edhe në domenin intern të BQK-së drejt një mjedisi efektiv të kontrollit të brendshëm, besueshmërisë së raportimit financiar të BQK-së dhe rritjes së analizave, statistikave dhe publikimeve tjera në funksion të një transparence më gjithëpërfshirëse. Ndër arritjet me peshë të veçantë gjatë vitit ishte sigurimi i kodit shtetëror "SWIFT" për pagesat ndërkombëtare të bankave komerciale që operojnë në tregun vendorë.

Përkundër rënies së ritmit të rritjes në ekonominë globale gjatë 2013 (3.0 përqind në 2013, kundrejt 3.2 përqind në 2012), recesionit në Eurozonë (-0.5 përqind), vlerësimet e BQK-së evidentojnë një normë reale të rritjes së PPB-së në 3.1 përqind kundrejt 2.5 përqind sa ishte në vitin 2012. Gjatë vitit 2013, rritja ekonomike i atribuohet kryesisht përmirësimit të bilancit tregtar që konsiderohet të jetë rezultat i zëvendësimit të disa produkteve të importuara me produkte vendore. Përveç zëvendësimit të importeve, viti 2013 ishte i favorshëm edhe sa i përket çmimeve të produkteve të importuara të cilat çuan në një normë të ultë të inflacionit prej 1.8 përqind krahasuar me normën prej 2.5 përqind të shënuar në vitin 2012.

Rritje të theksuar ka evidentuar edhe sektori financiar duke shënuar nivel të gjithsej asetëve prej 4.2 miliard euro apo rritje vjetore prej 10.2 përqind. Kjo rritje reflekton kryesisht rritjen e asetëve të fondeve pensionale në nivelin prej 23.3 përqind dhe bankave komerciale prej 8.1 përqind, përderisa gjithsej asetet në sektorin e sigurimeve u rritën për 1.4 përqind.

Ndërsa qëndrueshmëria e sektorit financiar është e evidente në të gjithë komponentët përbërës të kapitalit, profitabilitetit, likuiditetit dhe cilësisë së menaxhimit të rreziqeve.

Përtej nivelit të larët të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.7% ndaj nivelit të kërkuar rregullativ prej 12.0%, qëndrueshmëria e sektorit bankar nga këndvështrimi i solvences rikonfirmohet në raportin e mbuleshmërisë prej 110.6% të kredive jopërformuese me kapital. E gjithë kjo reflekton kapacitetin e larët të absorbimit të humbjeve me kapital nga rreziku me domethënës në tregun bankar.

Gjithashtu, pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar evidentohet i qëndrueshëm duke tejkaluar ndjeshëm kërkesat rregullative për sa i takon niveleve të likuiditetit dhe duke qenë i favorshëm në kontekstin e praktikave të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Ndihem i privilegjuar të përfundojë këtë fjalë hyrëse të raportit vjetor të BQK-së duke shprehur mirënjohje të thellë për të gjitha institucionet financiare për përkrahjen dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm dhënë BQK-së, si Thesari Amerikan, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Fondi Zhvillimor Gjerman, Banka Qendrore Evropiane dhe Bankat Qendrore të Rajonit.

Prof. Dr. Bedri Peci



Kryetar i Bordit

të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Fjala hyrëse e Guvernatorit

Ekonomia e Kosovës edhe gjatë vitit 2013 u karakterizua me stabilitet makroekonomik, i cili kryesisht është mbështetur në vazhdimin e rritjes ekonomike dhe normën e moderuar të inflacionit. Njëri prej kontribuuesve më të rëndësishëm në mirëmbajtjen dhe stabilitetin makroekonomik në Kosovë pa dyshim që është stabiliteti financiar, i cili paraqet edhe objektivin primar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Angazhimi i vazhdueshëm i BQK-së për të siguruar stabilitetin financiar në vend dhe sjellja e kujdesshme e vetë institucioneve financiare ka bërë, që Kosova edhe në vitin 2013 të gëzojë një sistem financiar të qëndrueshëm dhe në funksion të kërkesave të ekonomisë për shërbime financiare.

Spektori bankar ka vazhduar të jetë i qëndrueshëm në të gjitha aspektet, duke u bazuar në pozitën e kënaqshme të likuiditetit, cilësinë e mirë të portofolit kreditor dhe nivelin e lartë të kapitalizimit. Depozitat e mbledhura brenda vendit vazhduan të jenë burim i qëndrueshëm i financimit për bankat që operojnë në Kosovë, duke e bërë ekonominë e vendit më pak të varur nga lëvizjet në ofertën dhe koston e fondeve nga jashtë. Megjithatë, kreditimi drejtë ekonomisë vazhdoi të rritet me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me periudhat paraprake. Aktiviteti ndërmjetësues i sektorit bankar gjatë vitit 2013 u karakterizua me zvogëlim të normave të interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat, duke reflektuar, mes tjerash edhe masat e ndërmarra nga sektori bankar për rritje të efikasitetit. Performancë e kënaqshme u regjistrua edhe nga komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, ku vlen të theksohet rritja e kthimit nga investimet e fondeve pensionale si dhe zgjerimi i mëtejme i aktivitetit të kompanive të sigurimit, përderisa aktiviteti kredidhënës i institucioneve mikrofinanciare vazhdoi të zvogëlohet.

Gjatë vitit 2013, BQK vazhdoi t'i kushtojë vëmendje të veçantë avancimit të kornizës ligjore për institucionet financiare si në aspekt të legjislacionit primar ashtu edhe atij sekondar. Lidhur me këtë, vlen të theksohet edhe hartimi i strategjisë për mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimit financiar e cila ndihmon në forcimin e pozitës së konsumatorëve të shërbimeve financiare në Kosovë. Në të njëjtën kohë, u shënua progres në avancimin e mëtejme të mbikëqyrjes financiare drejt mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, si dhe avancimit të kapaciteteve për vlerësimin e stabilitetit financiar dhe makroekonomik në Kosovë. Si bazë e rëndësishme për avancimin e rolit të BQK-së në sigurimin e stabilitetit financiar kanë shërbyer edhe rekomandimet nga Programi i Vlerësimit të Stabilitetit Financiar (FSAP), që është realizuar në vitin 2012 bashkërisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Për të siguruar një adresim sa më efektiv të këtyre rekomandimeve, BQK-ja ka hartuar një plan të detajuar veprimi, përmes së cilit po arrijmë që në mënyrë të strukturuar të realizojmë detyrat që dalin nga raporti i FSAP-it. Gjatë këtij viti, arritje të rëndësishme u shënuan edhe në fushën e sistemit të pagesave, ku duhet theksuar sigurimin e kodit të veçantë shtetëror SWIFT për institucionet financiare që operojnë në Kosovë, gjë që do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë gjatë realizimit të transfereve ndërkombëtare. BQK ka arritur që me sukses të realizojë edhe detyrat tjera që lidhen me shërbimet bankare ndaj institucioneve dhe ekonomisë në përgjithësi, duke përfshirë mes tjerash, furnizimin e rregullt të ekonomisë me para të gatshme, si dhe emetimin e bonove të thesarit në emër të Qeverisë së Kosovës.

Shtyllë tjetër e rëndësishme e aktivitetit të BQK-së gjatë vitit 2013 ka qenë edhe njoftimi i rregullt i publikut dhe autoriteteve vendimmarrëse rreth zhvillimeve ekonomike e financiare në

Kosovë, që është realizuar përmes avancimit të mëtutjeshëm të statistikave të përpiluara nga BQK dhe publikimeve të ndryshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit ndërkombëtar, përmes së cilit po arrijmë që në mënyrë më të shpejtë të konvergjojmë drejtë arritjes së standardeve dhe praktikave më të mira të bankingut qendror.

Banka Qendrore mbetet e përkushtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar përmes adaptimit të politikave dhe praktikave më efikase të identifikimit të rreziqeve potenciale, si dhe në krijimin e politikave dhe infrastrukturës inkurajuese për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar. Arritjet e deritanishme në tejkalimin e sfidave dhe realizimin e detyrave paraqesin një bazë të mirë për avancim të mëtejshëm të kapaciteteve për realizimin e objektivave tona ligjore, gjë të cilën BQK-ja synon ta arrijë përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve institucionale teknike dhe humane, si dhe nivelit të lartë të përkushtimit dhe llogaridhënies të të gjithë punonjësve të saj.

Bedri Hamza



Guvernator i Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Komiteti i Auditimit

Bordi i Bankës Qendrore

Aktivitetet e Bordit të Bankës Qendrore kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Për këtë qëllim Bordi ka mbajtur takime të vazhdueshme në të cilat është informuar dhe është diskutuar lidhur me ecuritë e përgjithshme të sistemit financiar në Kosovë dhe më gjerë, sikurse që ka mbajtur edhe më se 16 mbledhje formale në të cilat ka marrë vendime.

Bordi ka aprovuar me kohë buxhetin vjetor të Bankës Qendrore sikurse që edhe ka bërë mbikëqyrjen e vazhdueshme të ekzekutimit të tij. Ka shqyrtuar dhe ka aprovuar pasqyrat dhe raportet periodike dhe përfundimtare financiare të BQK-së.

Bordi ka shqyrtuar dhe ka aprovuar nxjerrjen dhe plotësimin e rregulloreve nga fusha e sistemit financiar sipas kërkesave dhe propozimeve të cilat janë propozuar nga Bordi Ekzekutiv, të cilat janë prezantuar në vazhdim:

- Shfuqizimin e Rregullës VIII për Qeverisjen e Bankave
- Ndryshimin e Rregullores për Adekuatshmërin e Kapitalit të Bankave
- Ndryshimin e Rregullores për Ekspozimet e Mëdha
- Ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor
- Ndryshimin e Rregullores për Mbikëqyrjen e Konsoliduar të Grupeve Bankare
- Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor për IMF
- Rregulloren për Raportimin e Institucioneve Mikrofinanciare në BQK
- Rregulloren për Kontrollin e Brendshme dhe Funkcionimin e Auditimit të Brendshëm për IMF
- Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje për IMF
- Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit për IMF
- Rregulloren për Auditimin e Jashtëm të Institucioneve Mikrofinanciare
- Rregulloren për Kufizimet në Mbajtjen e Pasurisë së Paluajtshme dhe të Luajtshme për IMF
- Rregulloren për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative
- Ndryshimin e Rregullores për Depozitën Ekuivalente me Kapitalin për Degët e Bankave të Huaja
- Rregulloren për Kliringun dhe Funkcionimin e Llogarive për Shlyerje
- Rregulloren për Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar
- Ndryshimet në Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare

Ndryshimin e Rregullores mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare

Bordi i Bankës Qendrore ka miratuar gjithashtu:

- Planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2013
- Raportin vjetor të Komitetit dhe Shefit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së për vitin 2012
- Raportin vjetor financiar të BQK-së për vitin 2012;
- Buxhetin e BQK-së për vitin 2014;
- Raportet dhe pasqyrat periodike të gjendjes financiare të BQK-së;
- Strukturën organizative të BQK-së

Me qëllim të përmbushjes së kompetencave të përcaktuara me ligj, Bordi me kohë ka kryer të gjitha detyrat lidhur me:

- Zbatimin e procesit të nominimeve dhe emërimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me Ligjin e BQK-së;
- Shqyrtimin e të gjitha raporteve dhe rekomandimeve të Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorit, me qëllim të përmbushjes së stabilitetit financiar; dhe
- Çështje të tjera që janë në kompetencën e Bordit të Bankës Qendrore.

Bordi ka ushtruar edhe detyra tjera të cilat kanë qenë në harmonim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Më 31 dhjetor 2013 Bordi i Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Mejdi Bektashi, Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore

Bedri Hamza, Guvernator dhe anëtar i Bordit të Bankës Qendrore

Bedri Peci, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore

Fatmir Plakiqi, anëtar i Bordit të Bankës Qendrore (Drejtor i Thesarit të MF)

Pozitë vakante e anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore nga 12 qershor 2013

Bordi Ekzekutiv

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 34 pika 3 Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori (kryesues i Bordit Ekzekutiv) dhe zëvendësguvernatorët.

Kompetencat dhe detyrat e Bordit Ekzekutiv janë përcaktuar në nenin 36 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2013, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ka mbajtur 24 takime.

Më 31 dhjetor 2013, Bordi Ekzekutiv përbëhej nga Bedri Hamza (Guvernator/Kryesues i Bordit Ekzekutiv), Lulzim Ismajli (Zëvendësguvernator për Operacione Bankare), Fatmir Gashi (Zëvendësguvernator për Funksiione të Përgjithshme) dhe Fehmi Mehmeti (Zëvendësguvernator për Mbikëqyrje Financiare).

Sekretar i Bordit Ekzekutiv gjatë vitit 2013 ishte Flamur Mrasori (Këshilltar i Përgjithshëm i Guvernatorit).

Komiteti i Auditimit

Në kuadër të qeverisjes transparente në strukturën organizative të BQK-së, në pajtim me nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Kosovës dhe statutit të Komitetit të Auditimit, vepron edhe Komiteti i Auditimit.

Objektivat e Komitetit të Auditimit janë që të asistojnë Bordin Drejtues të BQK-së në lidhje me përmbushjen e përgjegjësisë në relacion me veprimin e auditimit të brendshëm, kontrollave të brendshme, etikën afariste dhe qeverisjen transparente si dhe për raportin financiar të BQK- së.

Komiteti Auditimit emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore dhe përbëhet prej tre anëtarëve (dy anëtar joekzekutivë të zgjedhur nga radhët e Bordit të Bankës Qendrore dhe një anëtar–ekspert i jashtëm nga fusha e kontabilitetit dhe auditimit).


Më 31 dhjetor të vitit 2013, Komiteti Auditimit përbëhej nga këta anëtarë:

Mejdi Bektashi, Kyetar i Bordit të Bankës Qendrore;

Bedri Peci, Anëtar i Bordit të Bankës Qendrore;

Arben Dërmaku, anëtar i jashtëm.

Struktura organizative e BQK-së: 31 dhjetor 2013



1. Përmbledhje ekzekutive

Në nivel global, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2013 u karakterizua me rritje. Sipas vlerësimeve të FMN-së, norma reale e rritjes së PBB-së ishte 3.0 përqind kundrejt rritjes prej 3.2 përqind në vitin 2012. Rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2013 ishte më e theksuar në vendet e zhvilluara, ndërsa në vendet në zhvillim aktiviteti ekonomik ishte më i ngadalshëm. Në anën tjetër Eurozona u ballafaqua për të dytin vit me radhë me recesion që vazhdoi të shkaktohet nga problemet e sektorit fiskal por edhe nga shtrëngimet e sektorit financiar, sidomos në zonat periferike të saj. Këto zhvillime si dhe shtrëngimi i aktivitetit financiar ndërkuftar kanë paraqitur sfidë shtesë për suksesin e politikave monetare lehtësuese në Eurozonë. Si rrjedhojë, njëra ndër shqetësimet e BQE-së për vitin e ardhshëm mbetet rreziku, që mund të vijë nga deflacioni. Për dallim nga vendet e Eurozonës, vendet e EJL-së gjatë vitit 2013 u karakterizuan me përmirësim të aktivitetit ekonomik kundrejt vitit 2012. Gjithashtu edhe niveli i çmimeve ishte në norma të dëshirueshme pasi, që shumica e vendeve u karakterizuan me inflacion të moderuar. Rritja e aktivitetit ekonomik në vendet e EJL-së gjatë vitit 2013 ishte kryesisht rezultat i përmirësimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse por edhe rritjes së lehtë të investimeve të huaja direkte.

Për ekonominë e Kosovës zhvillimet gjatë vitit 2013 ishin të favorshme. Norma reale e rritjes së PBB-së u përshpejtua dhe arriti në 3.1 përqind nga 2.5 përqind sa ishte në vitin 2012. Konsumi i përgjithshëm ka pasur rritje solide që është nxitur nga remitencat, kreditë konsumuese të sektorit bankar, pagat e sektorit publik dhe privat, etj. Sa i përket investimeve për dallim nga viti paraprak që ishte karakterizuar me rënie, gjatë vitit 2013 investimet u rritën si rezultat i rritjes së IHD-ve dhe kredive investuese për sektorin privat, ndërsa investimet e sektorit publik gjatë vitit 2013 kishin ndikim negativ. Gjatë vitit 2013, rritja ekonomike në Kosovë i atribuohet kryesisht përmirësimit të bilancit tregtar që konsiderohet të jetë rezultat i zëvendësimit të disa produkteve të importuara me produkte vendore. Përveç zëvendësimit të importeve, viti 2013 ishte i favorshëm edhe sa i përket çmimeve të produkteve të importuara të cilat çuan në një normë të ulët të inflacionit. Norma e inflacionit në vitin 2013 ishte 1.8 përqind krahasuar me normën prej 2.5 përqind të shënuar në vitin 2012. Me zhvillime pozitive u karakterizua edhe sektori fiskal, pasi që të hyrat nga tatimet e brendshme shënuan rritje të konsiderueshme dhe arritën që ta kompensojnë rënien e të hyrave nga tatimet kufitare, që erdhi si rezultat i rënies së importit. Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet buxhetore, kryesisht për shkak të rritjes së subvencioneve dhe transfereve si dhe mallrave e shërbimeve.

Vlera e gjithsej aseteve të sistemit financiar në Kosovë arriti në 4.2 miliardë euro në vitin 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 10.2 përqind. Rritja e aseteve të gjithsej sistemit financiar gjatë vitit 2013 kryesisht reflekton rritjen e aseteve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale. Pjesa e mbetur e aseteve të sistemit financiar, konkretisht asetet e insitucioneve mikrofinanciare dhe të ndihmësve financiar, në vitin 2013 ishte më e ulët krahasuar me vitin paraprak.

Asetet e sektorit bankar vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej aseteve të sistemit financiar. Në vitin 2013, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 8.1 përqind, duke arritur vlerën prej 3.1 miliardë euro. Në ecurinë e aseteve, vihet re një zgjerim i portfolios bankare në investime në letra me vlerë dhe rritje e kategorisë së bilancit me BQK-në, përderisa aktiviteti kreditues vazhdon të rritet me ritëm më të ulët. Zgjerimi i portfolios së investimeve në letra me vlerë, si dhe rritja e rezervave të bankave komerciale në BQK kundrejt rritjes së aktivitetit kreditor vazhdon të reflektojë një qasje më konzervative të bankave komerciale për sa i përket kreditimit të ekonomisë. Në vitin 2013, gjithsej vlera e kredive të sektorit bankar të Kosovës arriti në 1.8 miliardë euro, një rritje vjetore prej 2.4 përqind. Në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej depozitave arriti në 2.4 miliardë euro, që tregon për rritje vjetore prej 7.5 përqind.

Rritjes së depozitave gjatë kësaj periudhe kryesisht i kontribuoi rritja e përsheptuar e depozitave të ndërmarrjeve private në vitin 2013, përderisa depozitat e korporatave tjera financiare dhe depozitat e ndërmarrjeve publike u karakterizuan me rënie. Në vitin 2013, treguesit kryesor të profitabilitetit të sektorit bankar shënuan përmirësim kryesisht si rezultat i rritjes së profitit. Gjithashtu, gjatë vitit 2013, niveli i kapitalizimit është përforduar dhe Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit arriti në nivelin prej 16.8 përqind (14.2 përqind në dhjetor 2012). Sa i përket ekspozimit të sektorit bankar në vend ndaj rrezikut kreditor, në vitin 2013 vihet re një rritje e ekspozimit krahasuar me vitin paraprak, me ç'rast raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive arriti në 8.7 përqind (7.5 përqind në vitin 2012). Megjithatë, rritja e këtij raporti kryesisht reflekton ngadalësimin e rritjes së gjithsej kredive, përderisa vlera e kredive të këqija nuk është karakterizuar me përsheptim të rritjes në këtë periudhë. Edhe pozita e likuiditetit të sektorit bankar gjatë vitit 2013 mbeti në nivel të kënaqshëm. Kryesisht si rezultat i rritjes më të shpejtë të depozitave krahasuar me kreditë, raporti ndërmjet kredive dhe depozitave zbriti në 73.7 përqind, nga 77.4 përqind sa ishte në dhjetor 2012.

Sa i përket tregut të sigurimeve, numri dhe struktura e kompanive të sigurimit mbeten të pandryshuara nga viti i kaluar, kur sistemi financiar numëronte 13 kompani të sigurimit prej të cilave 90 përqind ofrojnë shërbime të sigurimit jo-jetë, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 përqind paraqet segmentin e sigurimit të jetës. Në vitin 2013, gjithsej asetet e kompanive të sigurimit që operojnë në vend arritën vlerën prej 132 milionë euro, rritje vjetore prej 1.4 përqind. Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2013 u karakterizua me humbje neto prej 337 mijë euro, që është dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak kur ky sektor kishte regjistruar humbje në vlerë 3.1 milionë euro. Zvogëlimi i humbjeve u mundësua kryesisht nga menaxhimi më i mirë i shpenzimeve.

Gjatë vitit 2013, janë përgatitur dy projekt ligje me rëndësi të veçantë për sektorin financiar në Kosovë. Njëri nga këto është projekt ligji për sigurimet e përgjithshme, ndërsa tjetri ka të bëjë me projekt ligjin për institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jobankare. Po ashtu, progres i rëndësishëm është shënuar edhe në nxjerrjen e legjislacionit financiar sekondar.

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2013 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë. Konsistent me praktikën ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut kreditor, likuiditetit, tregut dhe rreziqeve tjera, bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Në theks të veçantë gjatë ekzaminimeve ka qenë përcjellja e përmbushjes së rekomandimeve të dala gjatë ekzaminimeve, vendimeve përkatëse si dhe vlerësimeve të pajtueshmërisë së bankave me kornizën ligjore në fuqi, posaçërisht rregulloreve të BQK-se të cilat kanë hyrë në fuqi nga data 3 dhjetor 2012.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2013 është angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes së sigurimeve, duke u bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve të siguruesve ndaj publikut. Me kujdes të veçantë është mbikëqyruar pozicioni financiar i kompanive të sigurimit, gjë që ka rezultuar me përmirësim të vazhdueshëm të pozicionit financiar të këtij sektori.

Në vitin 2013, divizioni i mbikëqyrjes së Fondeve Pensionale ka filluar rishikimin, përshtatjen dhe harmonizimin e legjislacionit sekondar të pensioneve me Ligjin për Fonde Pensionale të Kosovës nr. 04/L-101 dhe rregullativën e Bashkimit Evropian. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës u karakterizua me një performancë pozitive në vitin 2013, me ç'rast gjithsej asetet e sistemit pensional shënuan rritje vjetore prej 23.3 përqind dhe arritën vlerën prej 918.7 milionë euro. Gjatë vitit 2013, TKPK u karakterizua me rritje të çmimit të aksionit dhe rritje të kthimit nga investimet. Fondi i Kursimeve Pensionale gjatë vitit 2013 ka realizuar kthim pozitiv nga investimi i mjeteve në vlerë prej 68.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 7.5 përqind, përderisa

edhe çmimi i aksionit ka qenë më i lartë në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak prej 7.3 përqind.

Ngjashëm me vitet paraprake edhe gjatë vitit 2013 BQK siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar për të mundësuar kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Sa i përket zhvillimeve në sistemin e pagesave, në vitin 2013 është miratuar Ligji për Sistem të Pagesave si dhe është rishikuar dhe harmonizuar rregullativa përcjellëse, duke përforcuar kështu kompetencat mbikëqyrëse të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregut në industrinë bankare. Gjatë vitit 2013 është shënuar një rritje në vëllim dhe vlerë e transaksioneve të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN) është bërë avancim i mëtejshëm i sistemit dhe është funksionalizuar pjesëmarrja e “IS Bank” në SEKN, bankë kjo që filloi së operuari gjatë vitit 2013 në vend.

Gjatë vitit 2013, të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë investuar në instrumente financiare që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide. BQK realizoi kthime pozitive nga investimet, me ç'rast kthimet ishin më të favorshme nga investimet në letrat me vlerë krahasuar me investimet në depozita bankare. Gjatë vitit 2013 BQK ka realizuar 21 ankande ku edhe për herë të parë u emetuan bono të Thesarit me afat maturimi prej 364 ditë me normë mesatare të kthimit prej 1.99 përqind, përderisa normat vjetore të kthimit janë karakterizuar me trend rënës kryesisht si pasojë e rritjes së kërkesës për pjesëmarrje në këto ankande. Regjistri i Kredive ka regjistruar 385 përdorues të ri në vitin 2013, si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare, përderisa hulumtimi mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditor gjatë vitit arriti në 623,334 hulumtime.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

Zhvillimet ekonomike në nivel global gjatë vitit 2013 u karakterizuan me trende pozitive, por se normat e rritjes ekonomike ishin lehtë më të ulëta në krahasim me vitin paraprak. Vlerësimet e FMN-së janë se rritja ekonomike globale më vitin 2013 ishte 3.0 përqind, krahasuar me 3.2 përqind në vitin 2012. Aktiviteti ekonomik në nivel global është nxitur nga vendet e zhvilluara, ndërsa vendet në zhvillim, edhe pse u karakterizuan me trende pozitive, kishin norma më të ulëta të rritjes.

Tabela 1. Indikatorë të zgjedhur makroekonomik


Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Ekonomia Globale	3.2	3.0	3.9	3.6		
Eurozona	-0.7	-0.5	2.5	1.3	2.0	2.9
Vendet në zhvillim	5.0	4.7	6.0	5.8	1.4	0.7
Evropa Evropiane në zhvillim	1.4	2.8	5.8	4.1	-4.5	-3.9

Burimi: FMN (Prill 2014)

Në vitin 2013, Eurozona u karakterizua me recesion duke shënuar normë negative të rritjes ekonomike prej 0.4 përqind, që u nxit nga problemet e vazhdueshme sektorin fiskal dhe financiar në vendet periferike si Spanja, Italia, Greqia Portugalia dhe Sllovenia, por edhe vendet tjera si Holanda. Në anën tjetër, vendet si Gjermania dhe Franca edhe pse nuk kishin recesion, kishin rritje mjaft të ulët prej 0.5 përkatësisht 0.2 përqind. Recesioni në Eurozonë gjatë vitit 2013 ishte si rezultat i nivelit relativisht të ulët të besueshmërisë për përmirësime në sektorin real të ekonomisë, si dhe shqetësimeve rreth borxhit publik. Gjatë vitit 2013, borxhi publik arriti në 95.7 përqind të PBB-së krahasuar me 92.9 përqind në vitin 2012 përkundër se deficitit buxhetor shënoi rënie. Mungesa e rritjes ekonomike e bën sfiduese ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxheve në Eurozonë. Gjithashtu edhe problemet në sistemin financiar, i cili gjatë viteve të fundit ka lëvizur në drejtim të zvogëlimit të aktivitetit ndërbankar, konsiderohen të kenë kontribuar në krijim të mëtejme të pasigurive. Me qëllim të nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe ndërbankar, ECB gjatë vitit 2013 ka ulur dy herë normën bazë të rifinancimit. Në maj 2013, norma e rifinancimit u zvogëlu nga 0.75 në 0.50 përqind, ndërsa në nëntor 2013 u zvogëlu në nivelin 0.25 përqind, që njëherësh paraqet nivelin më të ulët historik.

Projeksionet për vitin 2014 janë mjaft inkurajuese pasi që rritja globale pritet të arrijë në 3.7 përqind, ndërsa kjo rritje pritet të jetë e balancuar në mes të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. (IMF WOE, 2014). Sidoqoftë, dobësitë që karakterizuan ekonominë globale mbesin prezente edhe për vitin 2014. Rreziqet për vitin 2014 kryesisht vijnë nga mundësia që presionet deflacioniste të jenë prezente në vendet e zhvilluara, vazhdimi i kërkesës së dobët në vendet në zhvillim, rikuperimi tejet i ngadalshëm në Eurozonë.

Figura 1. Inflacioni në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje



Burimi: Eurostat (2014)

Në nivel global, norma e inflacionit arriti në 3.8 përqind krahasuar me 4.0 përqind në vitin paraprak (tabela 1). Rritja e çmimeve në nivel global u nxit më së shumti nga inflacioni në vendet në zhvillim, ndërsa vendet e zhvilluara gjatë vitit 2013 u karakterizuan me norma të ulëta të inflacionit, duke rritur kështu shqetësimet për mundësinë e shfaqjes së deflacionit në disa vende të eurozonës. Në vendet e Eurozonës, norma e inflacionit gjatë vitit 2013 ishte 1.5 përqind, që është dukshëm më e ulët se synimi i ECB-së për inflacion në rreth 2 përqind. Kjo ishte pikërisht një ndër arsytet që çoi në uljen e normës bazë të refinancimit nga ECB-ja. Rënia e nivelit të inflacionit në eurozonë ka ardhur kryesisht si rezultat i dobësimit të kërkesës nga sektori privat dhe nivelit të përmbajtur të shpenzimeve publike (figura 1). Si pasojë e këtyre zhvillimeve u ndikuan negativisht çmimet e produkteve kryesore, sidomos çmimet e metaleve. Gjithashtu, me qëllim të evitimit të rreziqeve nga ana e ofertës, shumë vende të zhvilluara kanë krijuar rezerva të naftës, faktor ky i cili ndikoi që gjatë vitit 2013 çmimet e naftës të jenë më të ulëta në nivel global. Përveç kësaj edhe rritja e prodhimit të naftës në SHBA ka bërë që kërkesa e SHBA-së për import të naftës të bie, duke bërë presione rënëse në çmimet e naftës në nivel global. Rënia e çmimeve të naftës është reflektuar edhe në çmimet e produkteve ushqimore, të cilat poashtu u karakterizuan me tendencë rënëse.

Sa i përket papunësisë, të dhënat aktuale tregojnë për lëvizje të vogla të normës së papunësisë në shumicën e ekonomive të zhvilluara botërore. Ndërsa, shkalla e papunësisë në vendet e Eurozonës ka vazhduar të rritet në vitin 2013, si rezultat i rënies së aktivitetit ekonomik, duke shënuar ngritje nga 11.4 përqind në vitin 2012 në 12.3 përqind në vitin 2013. Greqia, Spanja dhe Portugalia përveç se janë vendet që i prijnë listës për sa i përket shkallës së papunësisë, gjithashtu paraqesin vende në të cilat papunësia ka vazhduar të rritet më së shumti gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012 (figura 2). Lëvizje të lehta ka pasur edhe në Gjermani ku norma e papunësisë është rritur lehtë nga 5.5 përqind në vitin 2012 në 5.6 përqind për vitin 2013. Tregtia në nivel global gjatë vitit 2013 u karakterizua

Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje




Figura 3. Norma e kredive jopërfomuese në vende të zgjedhura të eurozonës




Figura 4. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës, në përqindje




Figura 2. Papunësia në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje

me rritje prej 2.6 përqind, që kryesisht erdhi si rezultat i përshejtit të eksporteve dhe importeve si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluara.

Norma e rritjes së kreditimit në Eurozonë gjatë vitit 2013 ishte negative me 2.0 përqind krahasuar me rritjen prej 0.4 përqind në vitin 2012. Gjatë vitit 2013, norma e rritjes së kreditimit mbeti negative si ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe ndaj ekonomive familjare, por se ishte kategoria e ndërmarrjeve që kishte rënie më substanciale. Kjo edhe si rezultat i përkeqësimit të kualitetit të portfolios kreditore dhe aftësisë paguese të sektorit privat. Për më tepër, aktiviteti financiar ka mbetur i izoluar vetëm brenda ekonomive të secilit anëtar, si rezultat i rritjes së pasigurive mbi aktivitetin ekonomik, që njëherit ka qenë faktor në zvogëlim të kreditimit përtej kufinjëve politik. Kjo është reflektuar edhe më tutje edhe në rritje të kostos së ndërmjetësimit, sidomos për vendet më të prekura nga kriza. Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të Eurozonës, bankat raportuan përmirësim në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 4).


2.1. Evropa Juglindore

Gjatë vitit 2013, edhe vendet e Evropës Juglindore (EJL) u karakterizuan me aktivitetin pozitiv ekonomik, që kishte për karakteristikë rënie të kërkesës së brendshme, por rritje të kërkesës së jashtme. Kroacia vazhdon të ballafaqohet me rënie të aktivitetit ekonomik prej 0.6%, ndërsa nga recesioni i vitit 2012 doli Bosnja e Hercegovina duke shënuar rritje për 0.5 përqind. Edhe Serbia gjatë vitit 2013 ka kaluar në rritje prej 2.0 përqind kundrejt rënies prej 1.7 përqind në vitin paraprak. Maqedonia e Mali i zi nga rritja negative prej 0.5 përqind kanë kaluar në rritje prej 1.5 përqind në vitin 2013 (figura 5). Stabilizimi i aktivitetit ekonomik në rajon gjatë vitit 2013 në masë të konsiderueshme i adresohet përmirësimeve në eksporte por edhe rritjes së lehtë të investimeve të huaja direkte (IHD-ve).

Përmirësimi i lehtë i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2013 në vendet e rajonit është reflektuar edhe në normën e papunësisë. Vlerësimet e Komisionit Evropian tregojnë për rënie të normës së papunësisë në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi, ndërsa në Bosnjë e Hercegovinë ka pasur rritje të lehtë të normës së papunësisë.


Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJL-së në vitin 2013 ishte 8.8 përqind e PBB-së (0.2pp më e ulët se në vitin 2012). Gjatë këtij viti, të gjitha vendet e EJL-së u karakterizuan me ngushtim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, me përjashtim të Maqedonisë e cila rriti deficitin nga 3.0 përqind në 4.5 përqind të PBB-së (figura 6). Mali i Zi, Shqipëria dhe Bosnja

Figura 5. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL



Burimi: FMN (2014) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2014

Figura 6. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje të PBB-së



Burimi: Komisioni Evropian (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2013


e Hercegovina vazhdojnë të kenë nivelin më të lartë të deficitit, ndërsa Maqedonia, Kosova dhe Serbia gjatë vitit 2013 raportuan nivelin më të ulët të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Zvogëlimi i nivelit të deficitit në shumicën e vendeve në rajon ishte rezultat i rënies së çmimeve të produkteve kryesore në tregjet ndërkombëtare si nafta, metalet dhe produktet ushqimore, të cilat ngadalësuan rritjen e vlerës së importeve. Gjithashtu, përveç ngadalësimit të rritjes së importeve, gjatë vitit 2013 rritja e eksporteve në të gjitha vendet e rajonit ishte më e lartë se sa vitin paraprak. Mesatarisht, eksportet gjatë vitit 2013 u rritën me mbi 6 përqind nga vendet e rajonit, krahasuar me eksportet në vitin 2012 që zvogëluan me mbi 5 përqind. Sidoqoftë, efekti i përmirësimeve tregtare u zbeh nga rënia e dërgesave të emigrantëve në disa prej vendeve të rajonit, me përjashtim të Kosovës ku dërgesat e emigrantëve vazhduan të rriten. Ndër komponentat më të rëndësishme në bilancin e pagesave në vendet e rajonit mbeten investimet e huaja direkte që u rritën në masë të konsiderueshme gjatë vitit 2013, sidomos kur merret parasysh se viti 2012 u karakterizua me nivel relativisht të ulët të IHD-ve.

Tendenca rënëse e inflacionit në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar që edhe në vendet e rajonit të zbuten presionet inflacioniste. Me përjashtim të Serbisë, ku norma e inflacionit arriti në 8.8 përqind, çmimet në vendet tjera rajonale u karakterizuan me inflacion të moderuar prej mesatarisht 2 përqind (figura 7). Sa i përket performancës së sektorit fiskal, shumica prej vendeve të rajonit u karakterizuan me performancë më të dobët si në shpenzime ashtu edhe në të hyrat buxhetore në krahasim me planifikimet fillestare. Sidoqoftë, gjatë

vitet 2013, konsiderohet se performanca më e dobët në të hyrat buxhetore ka detyruar vendet rajonale që të shkurtojnë edhe kategori të ndryshme në shpenzime, sidomos shpenzimet kapitale.

Sektori financiar në vendet e rajonit ka përcjellur zhvillime të ngjashme me vendet e Eurozonës, duke u karakterizuar me rënie ose ngadalësim të kreditimit. Aktiviteti kreditor ka pasur norma negative të rritjes në Shqipëri, Serbi, ndërsa me norma mjaft të ngadalësuar të rritjes në vendet tjera si Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë. Kjo në shumë raste ka ardhur edhe si rezultat i bankave të huaja, që u janë nënshtruar rregullave të bankave amë për zgjerim të kujdesshëm në nivel të grupeve të tyre për sa i përket kreditimit. Depozitat në pothuajse të gjitha vendet e rajonit kanë shënuar rritje edhe gjatë vitit 2013. Sa i përket kualitetit të portfolios kreditorë, gjatë vitit 2013 kreditë joperformuese si përqindje e gjithsej kredive në të gjitha vendet e rajonit shënuan norma dyshifrore, duke arritur në 23.5 përqind në Shqipëri, 14.9 përqind në Bosnjë e Hercegovinë, 10.9 përqind në Maqedoni dhe në 20.6 përqind në Serbi. Kosova mbetet vendi me kualitetin më të mirë të portfolios kreditorë ku në dhjetor kreditë joperformuese ishin 8.7 përqind. Sa i përket kapitalizimit në disa nga vendet rajonale treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është rritur lehtë. Niveli i kapitalizimit në Shqipëri u rrit nga 16.2 në 17.9 përqind të gjithsej asetëve, në Kosovë nga 14.2 përqind në 16.7 përqind dhe në Serbi nga 19.9 në 20.5 përqind. Në Bosnjë e Hercegovinë, treguesi i kapitalizimit mbeti në nivel të njëjtë me vitin paraprak prej 17.0 përqind, ndërsa në Maqedoni shënoi rënie të lehtë nga 17.1 në 16.8 përqind.

Figura 7. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJK



Burimi: Komisioni Evropian (2014)

3. Ekonomia e Kosovës

3.1. Sektori real


Zhvillimet në treguesit kryesorë makroekonomikë tregojnë për aktivitet të përshpejtuar gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Rrjedhimisht, vlerësimet e BQK-së janë se rritja reale ekonomike në vitin 2013 ka arritur normën prej 3.1 përqind (figura 8). Për dallim nga vitet paraprake, gjatë vitit 2013, janë përmirësimet në neto eksportet që vlerësohet të kenë pasur kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Gjatë vitit 2013, deficitin tregtar u ngushtua si rezultat i rënies së importeve dhe rritjes së eksporteve, gjë që mund të shërbejë edhe si indikacion për një masë të zëvendësimit të importeve me prodhime vendore. Kontributi i përmirësimit të neto eksporteve në rritjen ekonomike vlerësohet të ketë qenë 1.2 pikë përqindje. Me kontribut pozitiv është vlerësuar edhe komponenta e konsumit. Sidoqoftë për dallim nga viti paraprak, konsumi kontribuoi me normë më të moderuar prej rreth 0.8 pikë përqindje. Komponenta e investimeve gjatë vitit 2013 gjithashtu ka pasur kontribut pozitiv prej 1.1 pikë përqindje në rritjen ekonomike, krahasuar me vitin 2012 kur kjo komponentë kontribuoi negativisht.

Konsumi vazhdon të jetë komponenti më pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të PBB-së. Në vitin 2013, pjesëmarrja e konsumit në PBB është vlerësuar të ketë qenë 104.5 përqind.

Investimet gjatë vitit 2013 kanë pasur pjesëmarrje prej 28.1 përqind në PBB, që paraqet nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Sidoqoftë për dallim nga vitet paraprake kur sektori publik nëpërmjet investimeve kapitale konsiderohej si bartës kryesor i rritjes së investimeve, në vitin 2013 kontributin kryesor në rritjen e kësaj komponente e kishte sektori privat. Rritja e investimeve private të cilat përbëjnë rreth 60 përqind të gjithë investimeve, vlerësohet të jetë rezultat i rritjes së investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive investuese.


Neto eksportet në vitin 2013 shënuan deficit prej 1.68 miliardë euro, që paraqet zvogëlim prej 2.5 përqind krahasuar me vitin 2012. Rrjedhimisht, në vitin 2013, raporti ndërmjet deficitit të neto eksporteve dhe PBB-së u zvogëlua në 32.7 përqind krahasuar me 35.1 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Figura 8. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje



(e) Vlerësim i BQK-së, (f) Projektion i BQK-së

Figura 9. Komponentët kryesorë të PBB-së



(e) Vlerësim i BQK-së
Burimi: ASK (2014)

3.1.2 Çmimet


Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2013 u karakterizua me rënie. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2013 ishte 1.8 përqind, krahasuar me normën prej 2.5 përqind në vitin 2012 (figura 10). Trendi i rënies së inflacionit ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2013 duke arritur në 0.6 përqind në muajin dhjetor. Rënie e shkallës së inflacionit është shkaktuar kryesisht nga çmimet e mallrave të importuara, gjë që reflekton zhvillimet deflacioniste në vendet e Eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare.

Sa i përket komponentëve të CPI-së, rritje e çmimeve gjatë vitit 2013 u shënuar tek pijet alkoolike dhe duhani me 7.2 përqind, veshmbathja me 2.9 përqind, rekreacioni dhe kultura me 2.7 përqind, ushqimi dhe pijet joalkoolike me 2.1 përqind etj, ndërsa rënie e çmimeve u shënuar tek transporti me 1.9 përqind dhe mjetet e komunikimit me 0.9 përqind. Sidoqoftë, kontributin kryesor në ndryshimin e normës së inflacionit gjatë vitit 2013 e kishin produktet ushqimore dhe pijet joalkoolike me 0.8 pikë përqindje si dhe pijet alkoolike dhe duhani me 0.5 pikë përqindje, që përveç rritjes në çmim është edhe si rezultat i peshës së madhe të kësaj kategorie në shportën e konsumatorit (figura 11). Çmimet produkteve ushqimore, duhanit dhe pijeve të ndryshme kanë determinuar lëvizjen e çmimeve edhe në vitet e kaluara për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar por edhe për shkak të pjesëmarrjes së lartë, që e kanë këto kategori në shportën e konsumatorit kosovar (43.0 përqind). Sidoqoftë, në vitet e fundit vërehet një tendencë rënëse e pjesëmarrjes së këtyre produkteve në gjithsej shportën e konsumatorit.

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë janë mjaft të ngjashme me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo konfirmohet deri diku edhe nëpërmjet indeksit të çmimeve të importit (angl: Import Price Index: IPI). Mesatarja e IPI-së gjatë vitit 2013 është rritur për 0.2 përqind. Siç është paraqitur në figurën 11, CPI-ja ka treguar sjellje të ngjashme me IPI-në. Ndërsa, çmimet e prodhimit u karakterizuan me rritje vjetore prej 2.5 përqind, rritje kjo e cila është nxitur nga rritja e çmimeve të nxjerrjes së qymyrgurit, linjtit, mineraleve dhe produkteve të industrive tjera nxjerrëse.


Norma reale efektive e këmbimit (NREK) të valutës euro kundrejt valutave të vendeve partnere tregtare të Kosovës, gjatë vitit 2013, u vlerësua për mesatarisht 0.2 përqind. Vlerësimi i NREK është kryesisht pasojë e faktit se norma e inflacionit në Kosovë ishte më e lartë se sa në vendet

Figura 10. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij



Burimi: ASK (2014) me kalkulime të BQK-së

Figura 11. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2014)

partnere tregtare. NREK u vlerësua për 0.3 përqind ndaj vendeve të BE-së, ndërsa u zhvlerësua për 0.5 përqind ndaj vendeve të CEFTA-s, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë shtuar konkurrueshmërinë ndaj vendeve të CEFTA-s dhe zvogëluar ndaj vendeve të BE-së.

3.2. Sektori fiskal

Sektori fiskal gjatë vitit 2013 u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve. Të hyrat buxhetore¹ shënuan rënie prej 0.5 përqind dhe arritën vlerën prej rreth 1.3 miliardë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore² arriti në rreth 1.5 miliardë euro që paraqet rritje vjetore prej 3.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 152.5 milionë euro ose 3.0 përqind të PBB-së (2.4 përqind të PBB-së në vitin 2012). Ndërsa borxhi i përgjithshëm i Qeverisë është rritur për 16.1 përqind dhe ka vlerën prej 475.7 milionë euro që është ekuivalente me 9.1 përqind të PBB-së.

3.2.1 Të hyrat buxhetore

Gjatë vitit 2013, është shënuar performancë më e mirë në realizimin e të hyrave vendore të cilat shënuan rritje vjetore prej 7.8 përqind dhe arritën vlerën neto prej 270.8 milionë euro. Rritja e të hyrave vendore reflekton ngritjen e efikasitetit të ATK-së në mbledhjen e të hyrave dhe lehtësimit të procedurave për deklarimin dhe pagesën e obligimeve tatimore. Gjithashtu edhe rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2013 konsiderohet të ketë kontribuar në rritjen e të hyrave vendore.

Gjatë kësaj periudhe, të gjitha kategoritë kryesore të të hyrave nga tatimet vendore u karakterizuan me rritje. TVSH-ja neto e mbledhur brenda vendit, e cila ka një pjesëmarrje prej 42.0 përqind në gjithsej të hyrat nga tatimet vendore, shënoi rritje prej 14.9 përqind duke arritur vlerën prej 113.7 milionë euro. Të hyrat neto nga tatimi në korporata, që njëherit paraqesin edhe kategorinë e dytë më të madhe në kuadër të tatimeve vendore (23.3 përqind), shënuan rritje vjetore prej 3.0 përqind dhe arritën vlerën prej 63.1 milionë euro. Gjithashtu të hyrat neto nga tatimi në të ardhura personale shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind dhe arritën vlerën prej 61.2 milionë euro. Në kuadër të të hyrave nga tatimet vendore, rritje të lartë vjetore shënuan edhe të hyrat neto nga bizneset individuale (7.5 përqind), të cilat arritën vlerën prej 27.8 milionë euro.

Në anën tjetër, të hyrat e mbledhura nga tatimet në kufi shënuan rënie prej 1.0 përqind dhe shënuan vlerën prej 834.1 milionë euro. Rënia e të hyrave nga tatimet e mbledhura në kufi kryesisht reflekton rënien e nivelit të importit. Përkundër rënies, të hyrat e mbledhura nga tatimet në kufi vazhdojnë të përfaqësojnë kategorinë kryesore të të hyrave buxhetore, me pjesëmarrje prej 75.5 përqind në gjithsej të hyrat në vitin 2013 (77.0 në vitin 2012).

Në kuadër të të hyrave kufitare, kategoria kryesore mbetet TVSH-ja, me një pjesëmarrje prej 49.3 përqind. Në vitin 2013 të hyrat neto nga TVSH-ja u karakterizuan me rënie prej 1.6 përqind, duke arritur vlerën prej 411.0 milionë euro. Të hyrat kufitare nga akciza, që kanë një pjesëmarrje prej 36.1 përqind në gjithsej të hyrat kufitare, shënuan po ashtu një rënie të lehtë prej 0.7 përqind në vitin 2013. Me rritje prej 1.9 përqind u karakterizuan të hyrat nga dogana në importe, që arritën vlerën neto prej 119.5 milionë euro.

Me rënie u karakterizuan edhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe atij lokal, të cilat arritën vlerën prej 95.0 milionë euro, përderisa në vitin paraprak patën shënuar vlerën prej 104.3 milionë euro. Zëra tjerë të rëndësishëm në kuadër të të hyrave të realizuara buxhetore në vitin

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi i distribucionit të KEK-ut, depozitat e ndryshme të cilat mbahen në mirëbesim në emër të palëve të treta deri në përcaktimin e definimit të tyre.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, si dhe kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve buxhetore.

2013 ishin edhe gjobat dhe tarifatat, të cilat shënuan rritje prej 7.6 përqind dhe arritën vlerën prej 42.9 milionë euro, pastaj tantimat të cilat arritën vlerën prej 24.7 milionë euro dhe dividendat nga ndërmarrjet publike që arriti vlerën prej 43.0 milionë euro.

3.2.2 Shpenzimet buxhetore

Në vitin 2013, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore arriti në rreth 1.5 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 3.1 përqind. Shpenzimet qeveritare për investime kapitale gjatë vitit 2013 shënuan rënie prej 3.8 përqind dhe arritën vlerën prej 529.2 milionë euro. Përkundër kësaj rënie, shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 36.0 përqind të gjithsej shpenzimeve.

Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve rrjedhëse gjatë vitit 2013 vlerësohet të ketë kontribuar pozitivisht në rritjen e konsumit të përgjithshëm. Shpenzimet rrjedhëse të cilat përbëhen nga pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet dhe transferet pa përfshirë pagesat e borxhit, shënuan vlerën prej 945.5 milionë euro që paraqet rritje prej 7.6 përqind krahasuar me vitin paraprak. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, shpenzimet qeveritare për subvencione dhe transfere kanë shënuar rritje vjetore prej 11.7 përqind, duke arritur në 312.9 milionë euro. Me rritje u karakterizuan edhe shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime, si dhe shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje, që shënuan rritje prej 14.5 përkatësisht 2.3 përqind duke arritur në 193.9 përkatësisht 417.1 milionë euro.

3.3. Sektori financiar

3.3.1 Karakteristikat e përgjithshme

Gjithsej asetet e sektorit financiar arritën vlerën 4.2 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.5 përqind (9.9 përqind në dhjetor 2012).

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013
Bankat komerciale	8	8	9	9
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	38	39
Institucionet mikrofinanciare	17	20	17	17

Burimi: BQK (2014)

Rritja i atribuohet kryesisht rritjes së asetëve të fondeve pensionale dhe bankave komerciale dhe pjesërisht rritjes së lehtë të kompanive të sigurimit. Ndërsa, asetet e institucioneve mikrofinanciare dhe të ndihmësve financiar shënuan rënie në krahasim me vitin paraprak.

Struktura e asetëve të sistemit financiar në vitin 2013 ishte e ngjashme me vitet paraprake. Sa i përket numrit të institucioneve financiare, ndryshimet e vetme u shënuan te ndihmësit financiarë ku numri i tyre u rrit në 39 (38 në vitin 2012) (tabela 2). Sa i përket pjesëmarrjes së

Figura 12. Struktura e asetëve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: BQK (2014)


sektorëve në gjithsej asetet e sistemit financiar, sektori bankar vazhdon të përfaqësojë pjesën më të madhe të strukturës së aseteve. Megjithatë, në krahasim me vitin paraprak, pjesëmarrja e aseteve të të gjithë sektorëve, me përjashtim të fondeve pensionale, shënoi rënie. Fondet pensionale ishin i vetmi sektor që rriti pjesëmarrjen në vitin 2013 në 21.7 nga 19.5 përqind sa ishte në 2012 (figura 12).

Një pjesë e konsiderueshme e aseteve të sistemit financiar vazhdon të investohet në tregjet e jashtme. Vlera e Aseteve të Jashtme Neto (AJN) në dhjetor 2013 arriti në 2.56 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.5 përqind (13 përqind në dhjetor 2012).³ Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdojnë ta kenë AJN-të e BQK-së (figura 13). I vetmi segment që shënoi bilanc negativ të AJN-ve ishte ai i institucioneve mikrofinanciare, kryesisht si rezultat i mbështetjes së lartë të këtyre institucioneve në financimin nga jashtë në formë të linjave kreditore.

Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm në dhjetor 2013 arritën vlerën prej 3 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.7 përqind (13.4 përqind në dhjetor 2012) (figura 14). Struktura e kërkesave kryesohet nga depozitat me pjesëmarrje prej 37.9 përqind, pasuar nga letrat me vlerë përveç aksioneve me pjesëmarrje prej 27.2 përqind dhe asetet e ekuitetet tjera me pjesëmarrje prej 21.6 përqind (figura 15).


Në kuadër të kërkesave, gjatë vitit 2013, rritjen më të madhe vjetore e shënuan investimet në letrat me vlerë me 68.4 përqind dhe kreditë me 37.8 përqind, ndërsa paraja e gatshme e mbajtur në institucione jashtë vendit shënoi rritje vjetore prej 11.6 përqind. Me rënie u karakterizuan paraja e mbajtur në bankat e huaja në formë të depozitave (rënie prej 9.3 përqind), ari monetar dhe DST-të (rënie prej 5.9 përqind) dhe kutoa me FMN-në (rënie prej 4.2 përqind). Rritja e investimeve në instrumente si investimet në letra me vlerë dhe kredi është një indikator i orientimit të investimeve në instrumente që sjellin kthim më të lartë në asete (figura 15).

Figura 13. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 14. Struktura e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 15 Vlera e kërkesave ndaj sektorit të jashtëm (në milionë) dhe ndryshimi vjetor



Burimi: BQK (2014)

³ Në këtë kontekst, sektori financiar përfshinë edhe Bankën Qendrore.

Gjithsej detyrimet ndaj sektorit të jashtëm, në dhjetor 2013, arritën vlerën prej 455.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.4 përqind. Struktura e detyrimeve kryesohet nga detyrimet ndaj FMN-së me 34.2 përqind, pasuar nga kreditë me 31.9 përqind, depozitat me 19.9 përqind dhe alokimi i DST-ve me 13.6 përqind. Rritja e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm është kryesisht rezultat i rritjes së kredive, që bankat komerciale në vend kanë marrë nga sektori i jashtëm dhe pjesërisht depozitave të jorezidentëve në sektorin bankar në Kosovë (figura 16).

Ekspozimi i sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm mbetet relativisht i ulët si në kuadër të aseteve, ashtu edhe të detyrimeve (33.2 dhe 5.6 përqind respektivisht). Për më tepër edhe ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm mbetet i ulët. Investimet jashtë vendit përbëjnë 24.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërsa vetëm 5.7 përqind e detyrimeve janë ndaj sektorit të jashtëm.

3.3.2 Sektori bankar

Struktura e sektorit bankar në Kosovë në vitin 2013 ishte e ngjashme me periudhat paraprake. Sipas pronësisë, struktura e sektorit bankar vazhdoi të dominohet nga bankat me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 89.9 përqind të gjithsej aseteve të sektorit bankar, ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga bankat me pronësi vendore.


Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin bankar është ulur si rezultat i rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla. Në dhjetor 2013, pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha në vend ka zbritur në 67.4 përqind krahasuar me 69.3 përqind në 2012. Rënia e koncentrimit shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), i cili tregon trendin rënës në katër vitet e fundit (figura 17).

3.3.2.1 Bilanci i gjendjes i sistemit bankar

i. Asetet


Vlera e aseteve të sektorit bankar të Kosovës gjatë vitit 2013 arriti në 3.06 miliardë euro që paraqet një rritje

Figura 16. Struktura e detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 17. HHI për asete, kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2014)

Figura 18. Struktura e aseteve të sektorit bankar, në milion euro



Burimi: BQK (2014)


vjetore prej 8.1 përqind (6.8 përqind në dhjetor 2012) (figura 18). Rritjen më të madhe në kuadër të aseteve e shënuan investimet në letra me vlerë (38.2 përqind) dhe kategoria e bilancit me BQK-në (10.5 përqind) (figura 19). Kjo lëvizje e fondeve të bankave komerciale reflekton hezitimin e bankave për rritje të kreditimit, që po shprehet edhe me normën më të ulët të rritjes së kredive.

Megjithatë, kreditë vazhdojnë të jenë kategoria kryesore në kuadër të strukturës së aseteve të sektorit bankar me një pjesëmarrje prej 59 përqind në vitin 2013. Si rezultat i ngadalësimit të rritjes së kredive, pjesëmarrja e kredive në gjithsej asetet e sektorit bankar, krahasuar me vitin 2012, ishte për 3.3 pikë përqindje më e ulët. Ndërsa, kategoria që ka shënuar rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes gjatë katër viteve të fundit është kategoria e letrave me vlerë, të cilat në dhjetor 2013 përfaqësuan 11.6 përqind të gjithsej aseteve (tabela 3). Rritja e vazhdueshme e investimeve në letra me vlerë deri diku reflekton ngadalësimin e kredidhënies nga bankat, gjë që ka rritur mjetet në dispozicion për investime në letra me vlerë, por edhe shtimin e mundësive për diversifikim të investimeve në asete me shkallë të ulët rreziku siç janë bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës.

Në kuadër të portfolios së letrave me vlerë, investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë rritur pjesëmarrjen në 28.2 përqind, që tregon se zhvillimi i tregut vendor të bonove të thesarit po paraqet një produkt atraktiv për investimet e bankave që operojnë në Kosovë.


Megjithatë, pjesa më e madhe e investimeve në letra me vlerë vazhdon të përfaqësohet nga investimet në tregjet e jashtme. Më konkretisht, pjesa më e madhe e investimeve në letra me vlerë përbëhet nga fletëobligacionet e qeverive të huaja (71.8 përqind), që tregon se bankat gjatë vitit favorizuan investimet që bartin rrezik më të ulët.

Figura 19. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2014)

Figura 20. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	12.5%	331.5	12.5%	425.7	15.0%	463.3	15.1%
Bilanci me bankat komerciale	439.1	17.9%	329.5	12.4%	287.9	10.2%	339.9	11.1%
Letrat me vlerë	173.4	7.1%	202.0	7.6%	256.6	9.1%	354.5	11.6%
Kreditë bruto	1,458.7	59.4%	1,698.1	64.1%	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%
Asetet Fikse	44.0	1.8%	47.4	1.8%	57.7	2.0%	55.5	1.8%
Asetet Tjera	32.9	1.3%	41.3	1.6%	38.1	1.4%	40.3	1.4%
Gjithsej	2,455.1	100%	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%

Burimi: BQK (2014)

Kjo vërehet edhe nga pjesëmarrja tejet e ulët e investimeve të bankave në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jofinanciare, të cilat zakonisht konsiderohen si instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut (figura 20).


ii. Kreditë

Në vitin 2013, gjithsej vlera e kredive të sektorit bankar të Kosovës arriti në 1.81 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 2.4 përqind. Megjithatë, kreditimi nga sektori bankar edhe në këtë vit vazhdoi të karakterizohet me ngadalësim të trendit të rritjes (figura 21). Ngadalësimi u vërejt si te kreditë për ekonomitë familjare ashtu edhe te kreditë për ndërmarrje. Kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind (6.2 përqind në dhjetor 2012), ndërsa kreditë për ndërmarrje shënuan rritje vjetore prej 2 përqind (3.9 përqind në dhjetor 2012).

Kreditë për ndërmarrjet vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive me pjesëmarrje prej 67 përqind, përdërisa kreditë për ekonomitë familjare përbëjnë 31.2 përqind të gjithsej kredive (figura 22). Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, pjesa më e madhe përbëhet nga kreditë për ndërmarrjet tregtare të cilat përbëjnë 52.6 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet (figura 23).


Ngadalësimi i kreditimit për ndërmarrjet vërehet se është kryesisht rezultat i ngadalësimit të kreditimit për korporatat jofinanciare, që shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind krahasuar me 3.9 përqind në 2012. Ky ngadalësim reflekton kryesisht zhvillimet në kreditimin e sektorit të tregtisë, që përfaqëson sektorin me numrin më të madh të bizneseve në Kosovë dhe me pjesëmarrjen më të lartë në kreditimin bankar. Në vitin 2013, kreditimi i sektorit të tregtisë shënoi rritje vjetore prej 0.8 përqind, normë kjo që është dukshëm më e ulët se sa rritja vjetore prej 4.8 përqind në vitin 2012. Kreditimi i tregtisë, u ndikua edhe nga zvogëlimi i importeve në Kosovë. Rritjen më të theksuar në kuadër të kredive të ndërmarrjeve e shënuan kreditë e

Figura 21. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 22. Struktura e kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 23. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

destinuara për shërbime tjera (si hoteliere dhe restorante), të cilat shënuan rritje vjetore prej 6.6 përqind, mirëpo pesha e tyre në gjithsej kreditë vazhdon të jetë e ulët (figura 24).


Rritje shënoi edhe kreditimi për sektorin e bujqësisë, me normë prej 5 përqind, por e cila ishte më e ulët në krahasim me vitin paraprak (7.7 përqind në vitin 2012). Përkundër faktit se bujqësia vazhdon të përfaqësojë sektorin me qasjen më të ulët në kreditimin bankar, vërehet se norma e rritjes së kredive bujqësore është ndër më të lartat krahasuar me sektorët tjerë. Kjo është edhe refleksion i subvencioneve të Qeverisë për nxitjen e aktivitetit bujqësor në Kosovë, si dhe skemës së garantimit të kredive bujqësore të mbështetur nga USAID. Në anën tjetër, kreditimi për sektorin e industrisë u karakterizua me rënie, e cila posaçërisht u vërejt te kreditimi i ndërtimtarisë që shënoi rënie vjetore prej 5.2 përqind krahasuar me rritjen prej 7.7 përqind në vitin paraprak.

Sipas afatit të maturimit, struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë me afat më të gjatë maturimi, të cilat përfaqësojnë 67.2 përqind të gjithsej kredive (figura 25). Gjatë vitit 2013, vërehet një zhvendosje e lehtë drejt kredive me afat më të shkurtër maturimi, që mund të reflektojë shtrëngimin e kriterëve të bankave komerciale në formë të zvogëlimit të afatit të maturimit.

iii. Detyrimet


Detyrimet e sektorit bankar vazhdojnë të dominohen nga depozitat (80.1 përqind e gjithsej detyrimeve), të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale në Kosovë (tabela 4). Vlera e gjithsej depozitave në vitin 2013 arriti në 2.4 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.5 përqind (figura 26). Mbështetja e lartë në depozitat vendore si burim financimi, kundrejt mbështetjes në fonde të jashtme me kosto më të lartë të financimit, ka bërë që bankat që operojnë në Kosovë të përfitojnë nga një burim më i qëndrueshëm i financimit dhe të evitojnë varësinë ndaj financimit të jashtëm.

Figura 24. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 25. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 26. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 4. Struktura e detyrimeve të sistemit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	70.7	2.9%	40.0	1.5%	6.0	0.2%	16.5	0.5%
Depozitat	1,936.9	78.9%	2,104.0	79.4%	2,279.1	80.6%	2,449.0	80.0%
Huatë tjera	23.4	1.0%	30.4	1.1%	18.9	0.7%	13.4	0.4%
Detyrimet tjera	160.3	6.5%	191.3	7.2%	223.6	7.9%	246.4	8.1%
Borxhi i ndërrvarur	33.5	1.4%	31.0	1.2%	31.0	1.1%	56.3	1.8%
Mjetet vetanake	230.4	9.4%	252.8	9.5%	270.7	9.6%	277.90	9.1%
Gjithsej detyrimet	2,455	100%	2,650	100%	2,829	100%	3,060	100%

Burimi: BQK (2014)

Në kuadër të detyrimeve, rritjen vjetore më të theksuar (79.1 përqind) e shënoi borxhi i ndërrvarur (angl. subordinated debt) kryesisht si rezultat i nevojës për rritje të kapitalit në disa nga bankat komerciale për të siguruar pajtueshmëri me ndryshimin e kërkesave rregullative të BQK-së.⁴


Struktura e depozitave të sektorit bankar vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare të cilat përbëjnë 72.5 përqind të gjithsej depozitave. Pjesa e mbetur përfshindepozitat e ndërrmarrjeve me

pjesëmarrje prej 22.7 përqind, depozitat e jorezidentëve me 3.6 përqind dhe depozitat tjera (ku hyjnë Qeveria dhe organizatat tjera joqeveritare) me 1.2 përqind (figura 27).

Struktura e depozitave të ndërrmarrjeve dominohet nga depozitat e ndërrmarrjeve private me pjesëmarrje prej 71.5 përqind. Në pjesën e mbetur hyjnë depozitat e korporatave tjera financiare me 15.5 përqind, dhe të ndërrmarrjeve publike me 13 përqind (figura 28). Në kuadër të depozitave të ndërrmarrjeve, në vitin 2013, depozitat e ndërrmarrjeve private ishin e vetmja kategori që shënoi rritje dhe atë me normë vjetore prej 18.5 përqind, ndërsa dy kategoritë tjera u karakterizuan me rënie. Depozitat e korporatave tjera financiare shënuan rënie vjetore prej 25.9 përqind, ndërsa ato të ndërrmarrjeve publike shënuan një rënie vjetore prej 4.7 përqind.


Depozitat e jorezidentëve gjatë vitit 2013 shënuan rritje për 2.5 përqind, që paraqet një rritje dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me rritjen e vitit paraprak (35.4 përqind). Ky ngadalësim

Figura 27. Struktura e depozitave sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 28. Struktura e depozitave të ndërrmarrjeve sipas sektorëve, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

⁴ Sipas Rregullores së Re për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, në fuqi që nga fundi i vitit 2012, BQK shtrëngoi kërkesat për përllogaritjen e kapitalit rregullativ nga bankat komerciale.

i theksuar i rritjes, deri në një masë, mund të reflektojë trendin negativ të normave të interesit në depozita.

Sipas afatit të maturimit, depozitat e sektorit bankar vazhdojnë të dominohen nga depozitat e afatizuara, me pjesëmarrje prej 46.7 përqind, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga depozitat e transferueshme (36.8 përqind) dhe të kursimeve (16.5 përqind). Në kuadër të depozitave të afatizuara, pjesëmarrjen më të lartë (62.1 përqind) e kanë depozitat me maturim deri në 1 vit. Depozitat me maturim nga 1 deri në 2 vite përbëjnë 18.8 përqind, ndërsa ato me mbi 2 vite maturim përbëjnë 19.1 përqind të depozitave të afatizuara (figura 29). Kategoria që shënoi lëvizjen më të theksuar në kuadër të depozitave të afatizuara gjatë vitit 2013 ishin depozitat afatmesme (1 deri në 2 vite) të cilat shënuan rënie vjetore prej 27.3 përqind. Ky zhvillim ishte kryesisht pasojë e zhvendosjes së depozitave drejt kategorisë me maturim afatshkurtër, që mund të jetë pasojë e ndryshimit të kushteve të ofruara nga bankat, konkretisht, zvogëlimit të normave të interesit në depozita.

Figura 29. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


3.3.2.2 Normat e interesit⁵

Normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita u karakterizuan me trend rënës gjatë vitit 2013. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua në 12.4 përqind (13.4 përqind në vitin 2012), ndërkaq ajo e depozitave u zvogëlua në 3.4 përqind (3.6 përqind në vitin 2012). Rrjedhimisht, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në 2013 ishte 9 përqind, krahasuar me 9.8 në 2012 (figura 30).

Norma mesatare e interesit në kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 12.4 përqind në dhjetor 2013 nga 13.2 përqind në dhjetor 2012. Kreditë investuese u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit (12 përqind në 2013; 12.9 përqind në 2012) në krahasim me kreditë tjera të biznesit, te të cilat norma mesatare e interesit gjatë vitit 2013 ishte 13.6 përqind (14.6 përqind në 2012) (figura 30). Rënia u shënuar edhe në normën mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare, e cila u zvogëlua në 12.1 përqind nga 12.5 përqind në vitin 2012.

Norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve shënoi rënie nga 3.3 përqind në 2012 në 2.8 përqind në 2013. Ndërsa, norma mesatare e interesit për depozitat e ekonomive familjare u zvogëlua në 2.7 përqind në dhjetor 2013 krahasuar me 3 përqind në dhjetor 2012. Sa i përket afatit të maturimit, norma mesatare e interesit në depozitat e ndërmarrjeve shënuan rënie në të gjitha kategoritë e depozitave të ndërmarrjeve përveç depozitave në shumat mbi 250 mijë euro me maturitet mbi 2 vite, ku norma mesatare arriti në 3.8 përqind nga 3.2 përqind sa ishte në

Figura 30. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

⁵ Të dhënat paraqesin mesataren janar-dhjetor 2013.

vitin 2012. Normat mesatare të interesit në depozitat e ekonomive familjare shënuan rënie në të gjitha kategoritë sipas afatit të maturimit.

3.3.2.3 Performanca e sektorit bankar


Performanca e sektorit bankar të Kosovës shënoi përmirësim gjatë vitit 2013. Profiti neto i sistemit bankar arriti në 26 milionë euro, nga 18.5 milionë euro sa ishte në vitin 2012 (figura 31). Rritja ishte kryesisht reflektim i rritjes vjetore prej 0.3 përqind të hyrave të sektorit dhe i rënies së gjithsej shpenzimeve për 2.2 përqind (figura 31). Këto lëvizje bënë që raporti shpenzime/të hyra në vitin 2013 të zvogëlohet në 88.7 përqind nga 90.9 përqind në 2012, gjë që sugjeron se efikasiteti i sektorit bankar ka shënuar rritje gjatë kësaj periudhe.

Treguesit kryesor të profitabilitetit të sektorit bankar shënuan përmirësim si rrjedhojë e rritjes së profitit. Kthimi në mesataren e kapitalit (*angl. Return on Average Equity*) shënoi përmirësim nga 7.1 përqind në vitin 2012 në 9.4 përqind në 2013. Kthimi në mesataren e aseteve gjatë (*angl. Return on Average Assets*) gjithashtu shënoi rritje nga 0.7 përqind në vitin 2012 në 0.9 përqind në vitin 2013 (figura 32).

Të hyrat e sektorit bankar, përkundër normës pozitive të rritjes, vazhduan të karakterizohen me ngadalësim të trendit të rritjes, që kryesisht reflekton ngadalësimin e aktivitetit kredidhënës nga bankat. Ngadalësimi i rritjes së të hyrave u shoqërua me rënie të shpenzimeve, por e cila u bazua kryesisht në zvogëlimin e shpenzimeve për provizione, si rezultat i shkallës më të ulët të rritjes së vlerës së kredive joperformuese në krahasim me vitin paraprak, që do të thotë se niveli aktual i profitit është mjaft i ndjeshëm ndaj lëvizjeve në cilësinë e portofolit kreditor.


Struktura e të hyrave të sektorit bankar mbetet e ngjashme me vitin paraprak. Të hyrat nga interesi vazhdojnë të jenë kategoria dominuese me pjesëmarrje prej 80 përqind në gjithsej të hyrat e sektorit bankar.

Figura 31. Bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 32. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2014)

Figura 33. Normat vjetore të rritjes së të hyrave dhe shpenzimeve



Burimi: BQK (2014)

Megjithatë, krahasuar me vitin paraprak, të hyrat nga interesi shënuan rënie prej 1.1 përqind, gjë që u reflektua edhe në zvogëlimin e pjesëmarrjes së të hyrave nga interesi në gjithsej të hyrat (figura 34). Kjo tregon se norma pozitive e rritjes së gjithsej të hyrave të sektorit bankar në vitin 2013 ka qenë rezultat i rritjes së të hyrave nga jo-interesi të cilat shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind.

Struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të cilat shënuan rënie vjetore prej 1.9 përqind në vitin 2013 (figura 35). Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit u karakterizua me rënie më të theksuar vjetore prej 6.1 përqind dhe, rrjedhimisht, përkundër pjesëmarrjes më të vogël, ishte kategoria kryesore që shkaktoi rënien e gjithsej shpenzimeve. Kjo rënie i atribuohet kryesisht rënies vjetore prej 8.4 përqind të shpenzimeve për provizione të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të jointeredit. Shuma më e ulët e provizioneve të ndara gjatë kësaj periudhe reflekton faktin se shkalla e përkeqësimit të portfolios së kredive në vitin 2013 ishte më e ulët në krahasim me vitin 2012.


Ndërsa, shpenzimet e interesit ishin kategoria e vetme që shënoi rritje (1.1 përqind), por që norma e rritjes ishte dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak (7.9 përqind në 2012).

3.3.2.4 Rreziqet e sektorit bankar

i. Rreziku i likuiditetit


Pozita e likuiditetit të sektorit bankar, gjatë vitit 2013, vazhdoi të jetë e kënaqshme. Të gjithë indikatorët shënuan përforsim dhe tejkallim të kërkesave rregullative, duke u reflektuar në ulje të mëtutjeshme të ekspozimit të sektorit ndaj rrezikut të likuiditetit. Modeli tradicional i sektorit bankar të Kosovës, ku burim kryesor i financimit janë depozitat vendore të cilat karakterizohen me kosto të ulët dhe qëndrueshmëri, ka ekspozim të ulët ndaj lëvizjes më të shpeshtë të çmimeve dhe ndryshimeve në ofertën e fondeve me të cilat karakterizohen tregjet e jashtme të financimit

Figura 34. Struktura e të hyrave, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 35. Struktura e shpenzimeve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 36. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

afatshkurtër. Gjithashtu pjesëmarrja e ulët e financimit me shumicë (*angl. wholesale funding*) dhe ekspozimi i ulët ndaj bankave amë bën, që sektori të jetë relativisht i mbrojtur nga rreziku i mundshëm i tkurrjes së huazimit nga bankat amë, që mund të rrjedhë nga kërkesat për grupet bankare evropiane që të bëjnë rritjen e kapitalizimit në nivel të konsoliduar.


Raporti kredi/depozita në dhjetor 2013 zbriti në 73.7 përqind nga 77.4 përqind në dhjetor 2012 (figura 36). Kjo rënie i atribuohet normës më të lartë të rritjes së depozitave në krahasim me kreditë, që rezultoi që raporti kredi/depozita të zbrësë në nivelin pothuajse më të ulët në pesë vitet e fundit. Niveli i ulët i këtij raporti sugjeron pozitë të kënaqshme të likuiditetit dhe hapësirë të mjaftueshme për rritje të kreditimit pa kërcënuar pozitën e likuiditetit.

Raporti i aseteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtëra shënoi ngritje në 48.0 përqind nga 39.3 përqind në dhjetor 2012 (figura 37). Me rregulloren perkatëse të BQK-së, bankat duhet të mbajnë raportin e mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në nivel minimal prej 25 përqind. Rrjedhimisht, sektori bankar i Kosovës mund të konsiderohet se ka aftësi të mjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve afatshkurtra si dhe për ballafaqimin me rreziqe potenciale të likuiditetit. Rezervat e detyrueshme të sektorit bankar gjithashtu vazhdojnë të qëndrojnë në nivel mjaft më të lartë (180.3 milionë euro më shumë) se kërkesat rregullative minimale prej 209.6 milionë euro, që mund të shërbejë si sinjal shtesë për gjendjen e mirë të likuiditetit që ka sektori bankar.

ii. Rreziku kreditor


Rreziku kreditor është ndër rreziqet kryesore ndaj të cilit ekspozohet sektori bankar i Kosovës. Gjatë vitit 2013, vërehet rritje e ekspozimit ndaj këtij rreziku në krahasim me vitin paraprak. Raporti i Kredive Joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*) ndaj gjithsej kredive arriti në 8.7 përqind në vitin 2013, krahasuar me 7.5 përqind në vitin 2012 (figura 38). Sidoqoftë, kjo rritje kryesisht reflekton ngadalësimin e rritjes së gjithsej kredive, përderisa vlera e NPL-ve nuk është karakterizuar me shkallë përshpejtuese të rritjes (figura 39). Rritje më e theksuar e normës së NPL-ve u shënuar në tremujorin e tretë, ndërsa tremujori i katërt u karakterizua me stabilizim të normës së NPL-ve. Rritja e përgjithshme e normës së NPL-ve erdhi si rezultat i rritjes së normës së NPL-ve në pesë nga bankat, ndërsa të tjerat shënuan përmirësim të portfolios.

Figura 37. Raporti asete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtëra



Burimi: BQK (2014)

Figura 38. Raporti NPL/gjithsej kreditë, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Sektori më i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor mbetet ai i ndërmarrjeve, në kuadër të cilit tregtia dhe prodhimtaria shënuan përkeqësimin më të theksuar të portofolit kreditor. Në dhjetor 2013, sektori i prodhimitarisë u karakterizua me 15.2 përqind kredi joperformuese (11.2 përqind në 2012), ndërsa ai i tregtisë shënoi normë të NPL-ve prej 12.2 përqind (10.5 përqind në 2012) (figura 40). Ngritje të konsiderueshme të normës së NPL-ve shënoi sektori i agrikulturës, ku norma e NPL-ve u dyfishua duke arritur në 8 përqind nga 3.4 përqind në dhjetor 2012. Sektori i ekonomive familjare mbetet me ekspozimin të ulët ndaj rrezikut kreditor me normë të NPL-ve në 2.6 përqind.

Përkundër rritjes së raportit ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizione për humbje nga kreditë. Norma e mbulueshmërisë së NPL-ve nga provizionet qëndroi në 110.6 përqind në vitin 2013 (112.6 në vitin 2012), gjë që zbutë ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor (figura 41).


Përmirësimi i profitabilitetit të sektorit bankar gjatë vitit 2013 ka rritur kapacitetin e bankave për të ndarë provizione të mjaftueshme për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Duke marrë parasysh që NPL-të zvogëluan trendin e tyre rritës në tremujorin e fundit të vitit 2013, pritjet janë që trendi rritës të zbutet edhe më tutje krahas prospekteve më të favorshme për zhvillimet ekonomike në vitin 2014. Megjithatë vazhdimi i rritjes së ngadalshme të kreditimit, përveç që mund të ndikojë në rritjen e normës së NPL-ve, gjithashtu mund të ketë ndikim negativ në kapacitetin për zgjerim të ndërmarrjeve dhe aftësinë e tyre për ristrukturimin dhe shlyerjen e kredive ekzistuese. Mirëpo, përmirësimi i ambientit të përgjithshëm ekonomik si dhe standardet më të shtrënguara të kreditimit që bankat kanë raportuar të kenë përdorur në dy vitet e fundit pritet të kenë efekt pozitiv në cilësinë e kredive dhe rrjedhimisht, mund të neutralizojnë efektin e lartpërmendur negativ nga ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë.

Figura 39. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2014)

Figura 40. NPL-të sipas sektorëve



Burimi: BQK (2014)

Figura 41. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2014)

iii. Rreziku i tregut

Ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor dhe ndryshimet në normat e interesit, mbetet i ulët. Kjo është kryesisht rezultat i nivelit të ulët të pozicioneve të hapura neto të bankave në valuta të huaja.


Gjatë vitit 2013, asetet në valutë të huaj arritën në 145.34 milionë euro (vlerë ekuivalente) nga 135.02 milionë në vitin 2012. Mirëpo, detyrimet në valutë të huaj gjithashtu u rritën në 145.37 milionë nga 133.11 milionë në dhjetor 2012 duke bërë që pozicioni i hapur neto në valutë të huaj të ngushtohet. Kjo bën që sektori bankar të jetë mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.

Sektori bankar gjithashtu ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut indirekt kreditor që mund të paraqitet si pasojë e kreditimit në valutë të huaj për ekonomi familjare dhe ndërmarrje, që nuk janë të mbuluara (angl: hedged) nga lëvizjet e kurseve të këmbimit. Pjesëmarrja e kredive të lëshuara në valutë të huaj ndaj gjithsej portofolit kreditor në dhjetor 2013 është vetëm 0.34 përqind (figura 42).

Ngjashëm, sektori bankar i Kosovës ka nivel të ulët të ekspozimit edhe ndaj rrezikut nga normat e interesit. Kreditë dhe depozitat, si zërat kryesorë në bilancin e gjendjes së sektorit bankar, kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këta zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Në vitin 2013, kreditë me normë fikse të interesit përbënin 91 përqind të gjithsej kredive. Ndërsa të gjitha depozitat e sektorit bankar vazhdojnë të kenë normë fikse të interesit (figura 43).


Megjithatë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të rifinancimit dhe riinvestimit të mjeteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe depozitave dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit deri

Figura 42. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj




Burimi: BQK (2014)

Figura 43. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2014)

Figura 44. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


në 30 ditë (figura 44) dhe rrjedhimisht ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen më shumë në shpenzimet se sa në të hyrat. Sidoqoftë, fakti që pothuajse të gjitha detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit përbëhen nga depozitat për të cilat sektori bankar lehtësisht reagon në përshtatjen e normës së interesit, bën që ekspozimi i sektorit bankar ndaj ngritjes së normave të interesit të jetë i ulët.

iv. Rreziku i solvencës

Sektori bankar i Kosovës është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit që kalon kërkesat minimale rregullative.⁶ Gjatë vitit 2013, niveli i kapitalizimit është përforcuar, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (*angl. Capital Adequacy Ratio: CAR*), që paraqet gjithsej kapitalin rregullativ ndaj RWA-ve, arriti në nivelin 16.7 përqind krahasuar me 14.2 përqind në dhjetor 2012 (figura 45). Norma e kapitalit të klasit të parë ndaj RWA-ve arriti në 12.8 përqind nga 11.6 përqind në 2012. Kjo ngritje erdhi kryesisht si rezultat i rritjes vjetore për 15.9 përqind të nivelit të kapitalit rregullativ (-7.7 përqind rënie në dhjetor 2012 që kryesisht ishte rezultat i ndryshimeve rregulatore në mënyrën e klasifikimit të kapitalit rregullativ⁷). Në anën tjetër, Mjetet e Peshuara ndaj Rrezikut (*angl. Risk Weighted Assets: RWA*) shënuan rënie prej 1.6 përqind (14.1 përqind rritje në dhjetor 2012) (figura 46).

Kapitali rregullativ i sektorit bankar në dhjetor 2013 arriti vlerën 321.2 milionë euro, duke tejkaluar kërkesën minimale për kapital rregullativ për 90.9 milionë euro. Cilësia e kapitalit është e lartë, ku 76.5 përqind e gjithsej kapitalit përbëhet nga kapitali i klasit të parë. Rritja vjetore prej 8.3 përqind e kapitalit të klasit të parë gjatë vitit 2013 kryesisht i atribuohet shtimit të kapitali aksionar si dhe përmirësimit të profitit të sektorit që përbën ndër burimet më të rëndësishme të rritjes së vazhdueshme të kapitalit. Megjithatë, rritja vjetore e gjithsej kapitalit rregullativ i atribuohet kryesisht rritjes së kapitalit të klasit të dytë i cili shënoi normë vjetore të rritjes prej 50.3 përqind. Burim i rritjes së kapitalit të klasit të dytë ishte borxhi i ndërvarur, i cili gjithnjë e më shumë po rrit pjesëmarrjen dhe rolin e tij në rritjen e kapitalit plotësues.

Figura 45. Kapitalizimi i sistemit bankar




Burimi: BQK (2014)

15.9 përqind të nivelit të kapitalit rregullativ (-7.7 përqind rënie në dhjetor 2012 që kryesisht ishte rezultat i ndryshimeve rregulatore në mënyrën e klasifikimit të kapitalit rregullativ⁷). Në anën tjetër, Mjetet e Peshuara ndaj Rrezikut (*angl.*

Risk Weighted Assets: RWA) shënuan rënie prej 1.6 përqind (14.1 përqind rritje në dhjetor 2012) (figura 46).

Figura 46. Kapitali rregullativ dhe RWA-të




Burimi: BQK (2014)

⁶ Sipas Rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

⁷ Ndryshimet në kapitalin rregullativ dhe RWA në dhjetor 2012 ishin kryesisht pasojë e ndryshimeve në Rregulloren e Adekuatshmërisë së Kapitalit të Bankave që u reflekton në ndryshimin e klasifikimit të kapitalit rregullativ duke zbritur kategori të caktuara, si dhe në ndryshime në strukturën e RWA-ve kryesisht duke shtuar pozicionin e 'Rrezikut operacional'. Norma e CAR prej 14.2 përqind përfshin këto ndryshime, përkundër që rregullorja përkatëse e BQK-së e rishikuar në prill të vitit 2013 iu lejoi bankave afat deri më korrik të vitit 2013 për të përfshirë pozicionin e 'Rrezikut operacional' në kalkulimin e RWA-ve. Përfshirja është bërë për arsye të konsistencës me vlerat dhe normat e raportuara në Raportin Vjetor 2012, i cili është draftuar para rishikimit të rregullores.

Vlera e RWA-ve në dhjetor 2013 zbriti në 1.92 miliard euro (1.95 miliardë euro në 2012) kryesisht si rezultat i rënies së aseteve të peshuara me 50%, të cilat përfshijnë kërkesat me maturim prej 1 viti ose më pak, si dhe ato të peshuara me 150% të cilat përfshijnë kërkesat direkte me maturitet prej '1 viti apo më pak' (figura 47). Kategoritë tjera nuk kanë pësuar ndryshime të theksuara. Asetet me peshë rreziku 100%, të cilat përfshijnë kreditë si dhe zërat jashtëbilancor, vazhdojnë të dominojnë strukturën e RWA-ve me pjesëmarrje prej 72.4 përqind. Pozicioni i shtuar rishtazi i rrezikut operacional ka pjesëmarrje në gjithsej RWA-të prej 9.2 përqind.

Figura 47. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2014)

Analiza Stres-test

Qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve potenciale në portofolin kreditor dhe në pozitën e likuiditetit është vlerësuar gjithashtu përmes analizës stress-test. Skenarë hipotetikë të tronditjeve janë aplikuar në të dhënat faktike të sektorit bankar për muajin dhjetor 2013, ku është vlerësuar ndjeshmëria e sektorit ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun e tregut, si dhe ndjeshmëria ndaj rrezikut të likuiditetit. Rezultatet e analizës stress-test sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

Rreziku kreditor

Metodologjia⁸

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se kriza ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian do të vazhdojë të reflektohet në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat është supozuar një rënie ekonomike më e theksuar prej 2.7 përqind për vitin 2012, gjë që do të rriste hendekun e prodhimit për 6.0 përqind. Ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (*angl. Non-Performing Loans: NPL*), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, ku pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit, duke supozuar rënie të normave të interesit për 2.0pp si dhe zhvlerësim të valutës euro ndaj valutave të tjera për 20 përqind. Krahas supozimeve e lartpërmendura, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të hyrave nga interesi si rezultat i dështimit të kredive (rritjes së NPL-ve). Andaj profiti i bankave është parashikuar duke marrë për bazëprofitin neto pas tatimit të vitit 2013, prej të cilit janë zbritur të hyrat që do të realizoheshin po që se NPL nuk do të rritej. Supozimi për rritjen e NPL aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor. Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar është vlerësuar përmes ndikimit të supozimeve në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar,

⁸ Për sqarime shtesë rreth metodologjisë, shih Raporti i Stabiliteti Financiar Nr. 4.

aseteve të peshuara me rrezik dhe rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Sektori bankar i Kosovës sugjerohet të ketë aftësi të kënaqshme për të përballuar rrezikun kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarit hipotetik të përshkruar më lartë. Nën supozimin se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8pp, euro do të zhvlerësohet ndaj valutave tjera për 20 përqind dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0pp, si dhe supozimit për profitin në nivel të vitit 2013, CAR për tërë sistemin do të mbetet në 15.0 përqind, që është mbi nivelin 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Megjithatë, në nivel të bankave, CAR për katër nga bankat do të zbriste nën nivelin 12 përqind dhe rrjedhimisht do të duhej një injektim kapitali prej 21.4 milionë euro (ekuivalent me vetëm 0.42 përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2013). Në këto rrethana, niveli i ri i pjesëmarrjes së NPL në gjithsej kreditë e sistemit bankar do të arrinte në 13.5 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i lartë i normës së NPL-it do të ishte 18.3 përqind. Duke u bazuar në supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 58.7 milionë euro (1.1 përqind të PBB-së). Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale meqë duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

Reziku i likuiditetit

Metodologjia

Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin e tërheqjes së një vlere më të theksuar të depozitave nga sistemi bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sistemit që të përballojë një tronditje të tillë. Në këtë analizë është konsideruar tërheqja e 8% të depozitave përgjatë një periudhe pesë ditore, duke ndarë 5% të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime operacionale të bankës. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Rezultatet

Nën supozimin e skenarit të mësipërm, rezultat e stres-testit sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës ka nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave. Problemet e para të likuiditetit në banka do të fillonin të shfaqeshin vetëm në ditën e pestë, dhe atë vetëm në dy prej bankave (tabela 5). Shuma e përgjithshme e tërheqjes së depozitave do të arrinte në 34 përqind të gjithsej depozitave, ndërsa shuma e mjeteve shtesë për tejkalimin e problemeve me likuiditet do të arrinte në 11.0 milionë euro (0.21 përqind e PBB-së).

Marrë parasysh rezultatet, mund të vlerësohet se edhe në rast të paraqitjes së skenarëve konservativ të mësipërm të tërheqjes së depozitave, sektori bankar i Kosovës do të tregonte qëndrueshmëri.

Tabela 5. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: reziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave 1/	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti kredi/depozita
Pas ditës së parë	0	0	79.7
Pas ditës së dytë	0	0	86.6
Pas ditës së tretë	0	0	94.1
Pas ditës së katërt	0	0	102.3
Pas ditës së pestë	2	10,991	111.2

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.
Burimi: BQK (2014)

3.3.3 Fondet pensionale


Edhe gjatë vitit 2013, normën më të lartë të rritjes së asetëve në kuadër të sistemit financiar të Kosovës e kishin fondet pensionale të Kosovës. Asetet e sistemit pensional arritën vlerën prej 918.7 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 23.3 përqind. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) menaxhon 99.4 përqind të asetëve të sektorit pensional, ndërsa pjesa tjetër menaxhohet nga Fondi

Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP).


Struktura e asetëve të FKPK-së gjatë vitit 2013 u dominua nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kishin një pjesëmarrje prej 71.2 përqind në gjithsej asetet (figura 49). Pjesa e mbetur përbëhet nga investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës që përfaqësojnë 5.8 përqind të gjithsej asetëve dhe nga paraja në BQK që përfaqëson 23 përqind të asetëve të FKPK-së.

Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e asetëve të FSKP-së. Gjatë vitit 2013, jashtë vendit janë investuar gjithsej 76.3 përqind të asetëve, nga të cilat 74.3 përqind në letra me vlerë dhe 2 përqind në para të gatshme. Pjesa e mbetur prej 23.7 përqind paraqet investimet në Kosovë, nga të cilat 23.4 përqind të asetëve janë në bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës (figura 50).


Në vitin 2013 është regjistruar përmirësim i performancës së

Figura 48. Struktura e investimeve të TKPK-së (2013)

Burimi: BQK (2014)

Figura 49. Struktura e asetëve të FKPK-së (2013)

Burimi: BQK (2014)

Figura 50. Struktura e asetëve të FSKP, në përqindje

Burimi: BQK (2014)

investimeve si në fondet e menaxhuara nga FKPK ashtu edhe në fondet e menaxhuara nga FSKP. Siç është paraqitur në tabelën 6, të dyja fondet kanë shënuar ngritje të çmimit të aksionit dhe rritje të kthimit nga investimet. Ky përmirësim i performancës së investimeve reflekton përmirësimin e kushteve në tregjet ndërkombëtare të aksioneve, ku edhe janë investuar pjesa më e madhe e mjeteve të fondeve pensionale të Kosovës. Në rritjen e besueshmërisë në tregjet globale financiare dhe rrjedhimisht, në rritjen e performancës së tyre, veçanërisht ka ndikuar përkushtimi i vendeve të

Tabela 6. Indikatorët kyç të fondeve pensionale

Përshkrimi	Vlera e asetëve (milione euro)		Nr. i kontribuesve		Çmimi i aksionit		Kthimi vjetor në asete	
	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012
FKPK	913.6	740.1	449 000	418 000	1.21	1.12	7.50%	7.20%
FSKP	5.1	4.5	3850	3740	129.9	129.9	6.60%	3.40%

Burimi: BQK (2014)


BE-së dhe institucioneve ndërkombëtare financiare për tejkalimin e problemeve të borxhit publik në disa nga vendet e zhvilluara.

3.3.4 Kompanitë e sigurimit

Struktura e sektorit të sigurimeve, gjatë vitit 2013 mbeti e ngjashme me vitet paraprake. Sektori i sigurimeve vazhdon të dominohet nga segmenti jo-jetë i cili përfaqëson 90 përqind të gjithëj sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 përqind paraqet segmentin e sigurimit të jetës (figura 51). Sipas pronësisë, struktura e sektorit vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 64.5 përqind të gjithëj asetëve të sektorit, por vërehet një rënie e pronësisë së huaj në krahasim me vitin paraprak (72.2 përqind në vitin 2012). Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve është dukshëm më e ulët në krahasim me sektorët tjerë financiar në Kosovë. Në dhjetor 2013, pjesëmarrja e asetëve të tri kompanive më të mëdha në vend ishte 35.6 përqind e gjithëj asetëve të sektorit të sigurimeve (38.1 2 përqind në vitin 2012).


Vlera e asetëve të sektorit të sigurimeve, i cili përfaqëson 3.1 përqind të gjithëj asetëve të sistemit financiar të Kosovës, në vitin 2013 arriti në 132.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.3 (16.3 përqind në vitin 2012). Në ngadalësimin e normës vjetore të rritjes kontribuoi rënia

Figura 51. Asetet e kompanive të sigurimit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 52. Struktura e asetëve të kompanive të sigurimit (2013)




Burimi: BQK (2014)

e theksuar e parapagimeve, aseteve teknike dhe aseteve të risigurimit. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 58 përqind të gjithë aseteve (figura 52). Pjesa tjetër përfaqësohet nga paraja e gatshme dhe asetet tjera (fiksë, teknike, të paprekshme, etj.). Struktura e detyrimeve kryesisht përbëhet nga rezervat teknike të cilat përfaqësojnë 81 përqind të gjithë detyrimeve.

Primet e kontraktuara gjatë vitit 2013 arritën vlerën 79 milionë euro (77 milionë euro jojetë dhe 2 milionë euro jetë) që, krahasuar me vitin paraprak, paraqet një rritje vjetore prej 11.8 përqind. Në kuadër të primeve të segmentit jojetë, 73.1 përqind e primeve përbëhet nga primet e sigurimeve të detyrueshme, që përfshijnë policat e sigurimit të palës së tretë (*angl. Third Party Liability: TPL*) dhe policat kufitare. Pjesa e mbetur e primeve nga sigurimi jojetë përbëhet nga kategoria e primeve vullnetare të cilat përfshijnë policat e sigurimeve shëndetësore, sigurimeve kasko, të pasurisë, etj.

Figure 53. Primet e kontraktuara dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve arritën vlerën 38.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24 përqind. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) shënuan rritje vjetore prej 7.5% në krahasim me vitin paraprak, duke arritur vlerën 5.17 milionë euro. Struktura e dëmeve të paguara dominohet nga pagesat për policat e detyrueshme, të cilat përfaqësojnë 61 përqind të gjithë dëmeve të paguara (64 përqind në vitin 2012). Gjatë vitit 2013 është vënë re një rritje e dëmeve të paguara për policat vullnetare, pjesëmarrja e të cilave në gjithë dëmet e paguara është rritur nga 36 përqind sa ishin në vitin 2012 në 39 përqind në vitin 2013. Rritja më e shpejtë e dëmeve të paguara në krahasim me primet e kontraktuara rezultoi në rritjen e raportit dëme të paguara/prime të pranuar në 49 përqind nga 44 përqind sa ishte në vitin 2012 (figura 53).

Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2013 u karakterizua me humbje neto prej 337 mijë euro, që është dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak kur ky sektor kishte regjistruar humbje në vlerë 3.1 milionë euro. Zvogëlimi i humbjeve u mundësua kryesisht nga menaxhimi më i mirë i shpenzimeve. Zvogëlimi i humbjes u reflektua edhe në indikatorët kryesorë të performancës të cilët u përmirësuan në krahasim me vitin paraprak. Kthimi Mesatar në Asete (*angl. Return of Average Assets: ROAA*) në vitin 2013 ishte -0.3 përqind krahasuar me -2.6 përqind sa ishte në vitin 2012, ndërsa Kthimi Mesatar në Kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*) u përmirësua në -0.7 përqind nga -6.8 përqind në vitin 2012. Sektori i sigurimeve mbetet mirë i kapitalizuar, me normë të kapitalizimit prej 35 përqind. Ndërsa, kapaciteti i sektorit për përballimin e humbjeve potenciale, që matet përmes raportit të kapitalit vetanak dhe rezervave teknike, në vitin 2013 arriti në 67 përqind nga 64 përqind sa ishte në vitin 2012.

3.3.5 Institucionet mikrofinanciare

Sektori i institucioneve mikrofinanciare (IMF) vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 91.6 përqind të gjithë aseteve të sektorit. Shkalla e koncentrimin të tregut në këtë sektor është më e ulët në krahasim me sektorin bankar. Në dhjetor 2013, pjesëmarrja e aseteve të tri IMF-ve më të mëdha në vend ishte 46.0 përqind e gjithë aseteve të sektorit (45 përqind në 2012). Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH) tregon një


ngritje të lehtë të koncentrimin në asete dhe rritje më të theksuar të koncentrimin në kredi (figura 54).

Vlera e aseteve të institucioneve mikrofinanciare në dhjetor 2013 arriti në 112.9 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 2.5 përqind. Rënia më e theksuar është vërejtur te kreditë, të cilat u zvogëluan për 6.7 përqind duke shënuar vlerën 72.3 milionë euro. Kategoria e lizingut shënoi rritje vjetore për 6 përqind duke arritur në 22.1 milionë euro. Kreditë vazhdojnë të dominojnë strukturën e aseteve, me pjesëmarrje prej 64.1 përqind (figura 55). Megjithatë, lizingu rriti pjesëmarrjen në strukturë në 19.5 përqind, duke sugjeruar një zhvendosje të lehtë të aseteve drejt lizingut.

Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik mbetet kryesisht e njëjtë me vitin paraprak. Kreditë për shërbime dominojnë me 46.3 përqind, nga të cilat 16.4 përqind janë kreditë për tregti. Kreditë për bujqësi kanë një pjesëmarrje prej 27 përqind, ndërsa pjesa e mbetur është destinuar për ndërtimtari, industri dhe energjetikë. Cilësia e kredive të IMF-ve vazhdon të karakterizohet me një pjesëmarrje relativisht të ulët të kredive joperformuese. Në dhjetor 2013, raporti i kredive joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ishte 5.3 përqind (5.4 përqind në 2012). Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizione për humbje nga kreditë, me një normë të mbulueshmërisë prej 107 përqind në vitin 2013, por që është më e ulët krahasuar me vitin paraprak (128.8 përqind në vitin 2012).


Normat mesatare të interesit në kreditë e lëshuara nga IMF-të vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me kreditë e lëshuara nga sektori bankar. Norma mesatare e interesit në kredi në vitin 2013 ishte 23.2 përqind (23.5 përqind në vitin 2012) (figura 56). Niveli më i lartë i normave të interesit të IMF-të është rezultat i financimit të aktivitetit kreditues nga burime të financimit prej jashtë vendit, të cilat kanë norma më të larta interesit. Burimi kryesor i financimit për IMF-

Figura 54. HHI për asetet dhe kreditë e IMF-ve




Burimi: BQK (2014)

Figura 55. Struktura e aseteve të IMF-ve



Burimi: BQK (2014)

Figura 56. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve




Burimi: BQK (2014)

të janë linjat kreditore marrë parasysh që këto institucione nuk e kanë të drejtën e pranimit të depozitave.

Të hyrat e sektorit të institucioneve mikrofinanciare u karakterizuan me rënie vjetore prej 7.5 përqind, duke shënuar vlerën 19.2 milionë euro. Gjatë vitit 2013, të hyrat u dominuan nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 80.9 përqind. Rënie më të theksuar prej 22.6 përqind shënuan shpenzimet duke arritur vlerën 19.5 milionë euro. Kjo rënie ishte rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të jointerestit për 23.6 përqind dhe rënies së shpenzimeve të interesit për 19.4 përqind. Këto zhvillime sugjerojnë menaxhim më efikas të mjeteve nga IMF-të. Treguesi i efikasitetit që mat raportin ndërmjet shpenzimeve dhe të hyrave në fund të vitit 2013 ishte 101.7 përqind, që tregon përmirësim krahasuar me vitin paraprak (121.6 përqind në 2012) (figura 57).

Sektori i institucioneve mikrofinanciare e mbylli vitin 2013 me humbje prej 0.3 milionë euro, që ishte dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak (4.5 milionë euro në 2012), duke reflektuar kështu ndikimin e zvogëlimit të shpenzimeve. Zvogëlimi i humbjes është reflektuar edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Në vitin 2013, kthimi mesatar në asete (*angl. Return on Average Assets: ROAA*) u përmirësua në -0.3 përqind nga -3 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, kthimi mesatar në kapital (*ROAE*) u zvogëluar në -1.1 përqind nga -14 përqind në vitin 2012.

Figura 57. Raporti shpenzime/të hyra



Burimi: BQK (2014)


3.3.6. Ndihmësit financiar

Vlera e aseteve të ndihmësve financiar, që përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP), në dhjetor 2013 u zvogëluar në 7.6 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 7.5 përqind. Gjatë vitit 2013, të hyrat shënuan arritën vlerën 5.6 milionë euro krahasuar me 5.2 milionë euro sa ishin në vitin 2012. Struktura e të hyrave dominohet nga kategoria e të hyrave nga transferet, me pjesëmarrje prej 81 përqind në gjithsej të hyrat. Në anën tjetër, shpenzimet arritën vlerën prej 2.6 milionë euro krahasuar me 2.2 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2012. Rrjedhimisht, të hyrat neto të ndihmësve financiar shënuan vlerën 3 milionë euro, e cila është e me vitin paraprak.

3.4. Sektori i jashtëm

Bilanci i Pagesave në Kosovë u karakterizua me përmirësim të pozicionit tregtar me jashtë, si rrjedhojë e rritjes së eksporteve dhe rënies së importeve. Deficiti në llogarinë rrjedhëse shënoi një rënie vjetore prej 10.7 përqind gjatë vitit 2013, që kryesisht ishte rezultat i zvogëlimit të bilancit negativ të tregtisë së mallrave. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2013 zbriti

Figura 58. Bilanci i llogarisë rrjedhëse, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

në nivelin më të ulët të shënuar në vitet e fundit në rreth 6.6 përqind të PBB-së (7.7 përqind të PBB-së në vitin 2012). Rritja e kërkesës së jashtme, sidomos nga vendet e rajonit, është reflektuar në rritjen e eksporteve të Kosovës në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, zhvlerësimi i Normës Reale Efektive e Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak mund të ketë ndikuar deri në një masë në rritjen e konkurrueshmërinë së mallrave të Kosovës kundrejt vendeve të rajonit. Në vitin 2013, importet u karakterizuan me rënie, që deri në një masë mund ti atribuohet zëvendësimit të një pjese të mallrave të importit me prodhim vendor dhe rënies së çmimeve të produkteve kryesore që importohen në Kosovë. Me bilance pozitive vazhduan të karakterizohen kategoritë e shërbimeve, të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse, përderisa rritja e flukseve në llogarinë kapitale dhe financiare përforcoi qëndrueshmërinë e financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse.

3.4.1 Llogaria rrjedhëse

Dinamika e zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse vazhdon të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të vendit. Bilanci tregtar në Kosovë vazhdon të jetë faktori kryesor i nivelit të lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse, përderisa bilanci pozitiv i tregtisë së shërbimeve dhe kategorive tjera si të ardhurat dhe transferet rrjedhëse vazhdojnë të kontribuojnë në ngushtimin e këtij deficiti. Në vitin 2013, deficiti në llogarinë rrjedhëse arriti vlerën prej 244.1 milionë euro (6.6 përqind e PBB-së), përderisa në vitin paraprak kishte vlerën prej 380.2 milionë euro (7.7 përqind e PBB-së).

Figura 59. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative



Burimi: ASK (2014)

3.4.1.1 Mallrat dhe shërbimet

Aktiviteti tregtar i vendit u karakterizua me rritje të eksporteve dhe rënie të importeve në vitin 2013. Duke shënuar vlerën prej 1.68 miliard euro (32.7 përqind e PBB-së), deficiti tregtar i Kosovës në vitin 2013 ishte më i ulët për 2.5 përqind krahasuar me vitin 2012. Rrjedhimisht, raporti i mbulimit të importeve nga eksporte arriti në 12.0 përqind në vitin 2013, krahasuar me 11.0 përqind sa ishte në vitin paraprak. Shkalla e hapjes tregtare apo raporti i aktivitetit tregtar të Kosovës ndaj PBB-së, në vitin 2013 u rrit në 53.4 përqind, krahasuar me 51.0 përqind sa ishte në vitin 2012.

Mallrat

Në vitin 2013, deficiti i llogarisë së mallrave zbriti në 2.16 miliardë euro, një rënie vjetore prej 3.4 përqind. Eksportet e Kosovës arritën vlerën prej 293.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 përqind (13.5 përqind rënie vjetore në vitin 2012). Në terma real⁹, eksportet shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind, rritje kjo më e ulët krahasuar me rritjen nominale, që pasqyron efektin e rritjes së çmimeve të disa produkteve minerale që Kosova eksportoi gjatë vitit 2013.

⁹ Për llogaritjen e eksporteve dhe importeve në terma real, janë përdorur Indeksi i Çmimeve të Importit (IPI) dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (PPI) të publikuara nga ASK.


Kategoria me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të Kosovës mbetet kategoria e metaleve bazë, e cila shënoi rënie të lehtë në vitin 2013 kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të metaleve gjatë kësaj periudhe (figura 60). Ndërsa, eksportet e produkteve minerale, pijeve dhe duhanit, produkteve të gomës, plastikës dhe të tjera, si dhe produktet bujqësore ndikuan pozitivisht në rritjen e eksporteve të Kosovës gjatë kësaj periudhe.

Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej eksporteve të Kosovës gjatë kësaj periudhe e kishte eksporti i produkteve minerale, që kryesisht përbëhet nga koncentrat i zinkut dhe plumbit dhe energjia elektrike. Gjithashtu, rritja e eksporteve të produkteve bujqësore si dhe artikujve të letrës në vitin 2013, kundrejt rënies së importeve të këtyre kategorive në këtë periudhë, është indikacion për rritjen e prodhimit vendor në këto kategori duke ndikuar në zëvendësimin e këtyre mallrave paraprakisht të importuara.

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë në vitin 2013 ishte 2.45 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.3 përqind (0.6 përqind rritje vjetore në vitin 2012). Në terma real, importet kanë shënuar rënie vjetore prej 2.5 përqind në vitin 2013. Kategoritë me rënie më të madhe të importeve në vitin 2013 ishin importi i makinerive, pajisjeve mekanike dhe elektrike, si dhe mjetet e transportit. Rënia e importeve në vitin 2013 u nxit edhe nga rënia e çmimeve të derivateve të naftës dhe çmimeve të metaleve, gjë që u reflektua në zvogëlimin e vlerës së importeve të produkteve minerale dhe produkteve të metaleve bazë, që njëherësh kanë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të gjithsej importeve të Kosovës (figura 61). Në anën tjetër, importi i produkteve të industrisë kimike ka shënuar rritje.


Sa i përket shpërndarjes gjeografike të tregtisë së jashtme të Kosovës, struktura e tregtisë mbeti pothuajse e pandryshuar nga periudhat paraprake. Aktiviteti tregtar mbeti i përqendruar më shumë në vendet e BE-së. Importet kanë origjinë kryesisht nga vendet e BE-së që përfshijnë rreth 40 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Më konkretisht, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Gjermania, Italia dhe Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Turqia dhe Kina gjithashtu kanë një pjesëmarrje

Figura 60. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve




Burimi: BQK (2014) dhe Bloomberg

Figura 61. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit



Burimi: BQK (2014), IFS dhe FAOUN

Figura 62. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje



Burimi: ASK (2014)


Importet kanë origjinë kryesisht nga vendet e BE-së që përfshijnë rreth 40 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Më konkretisht, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Gjermania, Italia dhe Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Turqia dhe Kina gjithashtu kanë një pjesëmarrje

të konsiderueshme në gjithë importet e Kosovës. Ndërkaq, në kuadër të vendeve të rajonit, Serbia dhe Maqedonia përfaqësojnë partnerët kryesor tregtar sa i përket importeve në vend. Në anën tjetër, eksportet e Kosovës në vendet e BE-së përfshijnë rreth 44 përqind të gjithë eksporteve të Kosovës, të përqendruara kryesisht në Itali dhe në masë më të vogël në Gjermani. Sa i përket vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportoje më shumë në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoni. Një pjesëmarrje e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës ka për destinacion edhe Indinë dhe Turqinë (figura 62).

Shërbimet

Bilanci i tregtisë së shërbimeve vazhdoi të karakterizohet me bilanc pozitiv edhe në vitin 2013, megjithëse më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2013, bilanci i shërbimeve kishte vlerën prej 308.4 milionë euro (346.2 milionë euro në vitin 2012) (figura 63). Rënie më të madhe e shënuan bilancet e tri kategorive kryesore në kuadër të shërbimeve siç janë shërbimet e udhëtimit, shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimet qeveritare. Kategoria më e madhe në kuadër të shërbimeve vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit, që kryesisht përbëhet nga shitja e shërbimeve për jorezidentët. Në vitin 2013, bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 306.0 milionë euro, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rënie vjetore prej 1.1 përqind. Rënia ishte e nxitur nga rritja më e shpejtë e importeve se sa rritja e eksporteve të kësaj kategorie. Bilanci i shërbimeve të telekomunikacionit në vitin 2013 kishte vlerën prej 33.1 milionë euro (48.3 milionë euro në vitin 2012), përderisa bilanci i shërbimeve qeveritare ishte 23.2 milionë euro (30.9 milionë euro në vitin 2012).

Figura 63. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

3.4.1.2 Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Në vitin 2013, llogaria e të ardhurave kishte bilanc pozitiv prej 121.8 milionë euro, krahasuar me 154.1 milionë euro në vitin 2012. Në kuadër të llogarisë së të ardhurave, të hyrat ishin 227.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 1.2 përqind. Në të njëjtën kohë, pagesat arritën vlerën prej 101.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 43.6 përqind. Rritja e të hyrave në llogarinë e të ardhurave rezultoi kryesisht nga nënkategoria e kompensimit të punonjësve jashtë vendit siç janë punëtorët sezonal si dhe punonjësit në Afganistan dhe Irak. Në vitin 2013, të hyrat nga kompensimi i punonjësve arritën vlerën prej 223.2 milionë euro (219.9 milionë euro në vitin 2012) (figura 64). Në të njëjtën kohë, edhe pagesat për kompensimin e punëtorëve, që kryesisht përfshijnë punëtorët jorezident

Figura 64. Transferet rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

të angazhuar në Kosovë për periudha afat shkurtër – më pak se një vit, arritën vlerën 4.3 milionë euro krahasuar me 5.6 milionë euro sa ishin në vitin 2012.

Bilanci pozitiv në llogarinë e të ardhurave u zvogëluar në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak kryesisht si pasojë e rritjes së pagesave dhe rënies së të hyrave në kuadër të të ardhurave nga investimet. Të hyrat nga investimet përbëhen kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore (letra me vlerë, depozita, etj.) në tregjet e jashtme, përderisa pagesat kryesisht përbëhen nga të ardhurat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në Kosovë. Në vitin 2013, të hyrat në kuadër të të ardhurave nga investimet u zvogëluar në 4.5 milionë euro (10.6 milionë euro në vitin 2012), përderisa pagesat arritën vlerën 101.6 milionë euro (70.8 milionë euro në vitin 2012). Të ardhurat nga investimet kishin bilanc negativ prej 97.1 milionë euro në vitin 2013 (60.1 milionë euro në vitin 2012).

Një nga kategoritë më të rëndësishme të bilancit të pagesave të Kosovës, që vazhdon të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, janë transferet rrjedhëse. Bilanci i llogarisë së transfereve rrjedhëse arriti vlerën prej 1.2 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (figura 65). Transferet rrjedhëse përbëhen nga transferet qeveritare (28.0 përqind) dhe transferet e sektorit privat (72.0 përqind). Transferet qeveritare arritën vlerën prej 341.9 milionë euro në vitin 2013, që paraqet rënie vjetore prej 14.8 përqind. Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut.


Transferet rrjedhëse të sektorit privat dominohen kryesisht nga remitencat, bilanci neto i të cilave përfaqëson rreth 62.7 përqind të gjithsej transfereve të sektorit privat. Në vitin 2013, remitencat arritën vlerën e 620.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (figura 65). Në anën tjetër, dërgesat e jorezidentëve në Kosovë drejt vendeve tjera shënuan vlerën prej 68.8 milionë euro (86.1 milionë euro në vitin 2012).

Sa i përket shpërndarjes gjeografike të remitencave, Gjermania dhe Zvicra kanë pjesëmarrjen më të lartë prej 33 përkatësisht 24 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë, pasuar nga vendet me pjesëmarrje më të ulët si Italia dhe Austria me 7 përkatësisht 6 përqind të gjithsej remitencave. Rreth 21.2 përqind e remitencave transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 35.2 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e remitencave transferohen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale.

3.4.2 Llogaria financiare

Në vitin 2013, bilanci i llogarisë financiare arriti vlerën prej 133.4 milionë euro krahasuar me 130.3 milionë euro në vitin 2012. Asetet shënuan rritje për 200.0 milionë euro, që krahasuar me vitin 2012 janë për 38.6 përqind më të ulëta, ndërsa detyrimet arritën vlerën prej 333.4 milionë euro që krahasuar me vitin 2012 janë për 25.0 përqind më të ulëta. Kontribuuesi kryesor në kuadër të bilancit pozitiv të llogarisë financiare vazhdon të jetë kategoria e investimeve të huaja direkte (IHD), ndërsa ndikim negativ në bilancin e llogarisë financiare vazhdon të ketë rritja e vazhdueshme e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së Kosovës.

Figura 65. Remitencat



Burimi: BQK (2014)

3.4.2.1 Investimet e Huaja Direkte

IHD-të në Kosovë, gjatë vitit 2013, ishin 258.9 milionë euro ose 13.1 përqind më të larta se sa në vitin 2012. Investimet e rezidentëve të Kosovës në vende tjera shënuan rritje prej 13.2 përqind dhe arritën vlerën prej 17.9 milionë euro. Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmëri.

Si rezultat i krizës globale financiare, IHD-të në raport me PBB-në kanë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2008, ndërkohë që në vitin 2013 është shënuar përmirësim i këtij treguesi nga 4.7 përqind në 5.0 përqind të PBB-së. Rritja e IHD-ve paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm edhe në kuptim të qëndrueshmërisë së financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse (figura 66). Në kudër të IHD-ve, rritje ka shënuar kategoria e kredive ndërmjet ndërmarrjeve dhe fitimi i ri-investuar (64.4 përkatësisht 26.0 milionë euro më shumë se sa në vitin 2012), ndërsa kapitali aksionar ishte për 60.4 milionë euro më i ulët se sa në vitin 2012.


Siç është paraqitur edhe në figurën 67, IHD-të në patundshmëri kanë shtuar dominimin në strukturën e gjithsej IHD-ve edhe gjatë vitit 2013. Me rritje janë karakterizuar edhe sektori i transportit dhe telekomunikacionit, shërbimeve financiare, energjetikës dhe tregtisë, ndërsa IHD-të në sektorin e ndërtimitarisë dhe prodhimit kanë shënuar rënie në strukturë. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Turqia paraqet vendin prej nga vjen pjesa më e madhe e IHD-ve (33.6 përqind), pasuar nga Zvicra (16.1 përqind), Gjermania (8.4 përqind), Shqipëria (7.9 përqind), etj. Përderisa investimet nga Turqia kanë shënuar rritje prej 32.3 përqind gjatë vitit 2013, investimet nga Gjermania dhe Zvicra kanë shënuar rënie për 56.2 përkatësisht 4.8 përqind. Gjithashtu, vlen të theksohet se investimet nga Shqipëria janë trefishuar në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012.

Siç është paraqitur edhe në figurën 67, IHD-të në patundshmëri kanë shtuar dominimin në strukturën e gjithsej IHD-ve edhe gjatë vitit 2013. Me rritje janë karakterizuar edhe sektori i transportit dhe telekomunikacionit, shërbimeve financiare, energjetikës dhe tregtisë, ndërsa IHD-të në sektorin e ndërtimitarisë dhe prodhimit kanë shënuar rënie në strukturë. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Turqia paraqet vendin prej nga vjen pjesa më e madhe e IHD-ve (33.6 përqind), pasuar nga Zvicra (16.1 përqind), Gjermania (8.4 përqind), Shqipëria (7.9 përqind), etj. Përderisa investimet nga Turqia kanë shënuar rritje prej 32.3 përqind gjatë vitit 2013, investimet nga Gjermania dhe Zvicra kanë shënuar rënie për 56.2 përkatësisht 4.8 përqind. Gjithashtu, vlen të theksohet se investimet nga Shqipëria janë trefishuar në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012.

3.4.2.2 Portfolio investimet, investimet tjera dhe asetet rezervë


Bilanci i investimeve portfolio gjatë vitit 2013 ishte -133.8 milionë euro (-184.9 milionë euro në vitin 2012). Investimet portfolio jashtë vendit, kryesisht në letra me vlerë të borxhit, shënuan vlerën prej 132.8 milionë euro (185.7 milionë euro në 2012). Pjesa më e madhe e investimeve portfolio përbëhen nga investimet e fondeve pensionale në instrumente të ndryshme financiare jashtë vendit, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore dhe bankave komerciale. Kategoria e investimeve tjera kishte një bilanc prej vetëm 5.1 milionë euro në vitin 2013 (369.2 milionë euro në 2012). Ky bilanc më i ulët i investimeve tjera krahasuar me vitin paraprak ishte për shkak të

Figura 66. Investimet e huaja direkte dhe deficitit i llogarisë rrjedhëse



Burimi: BQK (2014)

Figura 67. Investimet e huaja direkte sipas sektorëve kryesor ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

rritjes së aseteve, kryesisht në depozita dhe kredi, për 70.4 milionë euro dhe rritjes së detyrimeve për 75.5 milionë euro për dallim nga viti i paraprak ku asetet ishin zvogëluar për 146.3 milionë euro ndërsa detyrimet patën shënuar rritje për 222.9 milionë euro. Në vitin 2012 asetet u zvogëluan kryesisht për shkak të zvogëlimit të depozitave jashtë vendit, si dhe rritjes së kredive tregtare. Ndërkohë në vitin 2013 depozitat e investuara jashtë u rritën për 47.3 milionë euro ndërsa kreditë tregtare u zvogëluar nga 100.3 milionë euro në vitin 2012 në 19.1 milionë euro në vitin 2013 që lidhet edhe me nivelin më të ulët të importeve. Asetet rezervë, të cilat janë të investuara kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, gjatë vitit 2013 janë zvogëluar për 21.0 milionë euro.

3.4.3 Pozicioni ndërkombëtar i investimeve


Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI)¹⁰ neto në fund të shtatorit 2013 ishte pozitiv me vlerë prej 387.0 milionë euro. Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rënës deri në vitin 2011, ku si përqindje e PBB-së kishte arritur në 2.8 përqind, ndërsa ka filluar të rritet përsëri dhe ka arritur në 7.5 përqind të PBB-së në vitin 2013. Në këtë kontekst, investimet portfolio neto dhe investimet tjera ndikuan në përmirësimin e bilancit të PNI-së duke shënuar rritje prej 20.2 përkatësisht 23.8 përqind në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012. Në anën tjetër, bilanci i investimeve direkte vazhdoi të jetë negativ dhe shënoi rritje prej 9.6 përqind në vitin 2013.

Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc pozitiv (1.5 miliardë përkatësisht 539.6 milionë euro në vitin 2013), ndërsa sektorët tjerë¹¹ dhe Qeveriabilanc negativ (1.3 miliardë përkatësisht 321.8 milionë euro) (figura 69).

3.4.4 Borxhi i jashtëm


Në vitin 2013, Kosova kishte bilanc neto pozitiv të borxhit të jashtëm prej 1.9 miliard euro që do të thotë se borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës (3.5 miliardë euro) është më i lartë se sa borxhi i ekonomisë së Kosovës ndaj sektorit të jashtëm (1.6 miliard euro).

Figura 68. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 69. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro



Burimi: BQK (2014)

¹⁰ PNI paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të aseteve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korrigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Nëse PNI neto është pozitiv, kjo nënkupton që Kosova ka më shumë mjete të investuara jashtë se sa që ka detyrime ndaj sektorit të jashtëm.

¹¹ Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiar, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private dhe individët.

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshinë borxhin e jashtëm privat dhe borxhin e jashtëm publik¹², në vitin 2013 arriti në 1.6 miliard euro që është për 5.1 përqind më i lartë se sa në vitin 2012. Ndërsa, si përqindje e PBB-së, borxhi i jashtëm bruto prej 31.0 përqind në vitin 2013 ishte pothuajse i njëjtë me vitin paraprak (figura 70). Kjo bën që Kosova të ketë nivelin më të ulët në rajon për sa i përket ngarkesës me borxhe të jashtme.

Kosova qëndron mirë në krahasim me vendet tjera të rajonit edhe për faktin se borxhi i jashtëm publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto (383.9 milionë euro apo 24.1 përqind e borxhit të jashtëm bruto).


Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huat ndërmjet kompanive (figura 71). Rrjedhimisht, kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 672.6 milionë euro apo 42.2 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë (329.7 milionë euro ose 20.7 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm).

Borxhi i jashtëm i Qeverisë në vlerë prej 321.8 milionë euro është kryesisht borxh i trashëguar, që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 20.2 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm bruto. Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në shtator 2013 ishte 208.1 milionë euro ose 13.1 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat e jorezidentëve. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (62.1 milionë euro apo 3.9 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht stokut të alokimeve të të Drejtave Speciale të Tërheqjes (angl. Special Drawing Rights: SDR) nga FMN-ja.

3.5 Pritjet për vitin 2014


Projeksionet për rikuperim të aktivitetit ekonomik në nivel global, sidomos në vendet e Eurozonës, pritjet të kenë implikime edhe në ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2014. Kjo sidomos kur merret parasysh se, përderisa në pjesën e dytë të vitit 2013 rikuperimi në Eurozonë ishte më i koncentruar në vendet kryesore, gjatë vitit 2014 shenjat e para janë shfaqur edhe në ekonomitë periferike, përfshirë Greqinë. Projeksionet për rritje në eurozonë për vitin 2014 janë se rritja reale e PBB-së do të arrijë në 1.5 përqind. Reflektimet e përmirësimit të ekonomisë në Eurozonë transmetohen në ekonominë e Kosovës nëpërmjet remitencave, investimeve të huaja direkte si

Figura 70. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 71. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

¹² Në kuadër të borxhit publik përfshihet borxhi i Qeverisë dhe banka qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huat midis kompanive, sistemi bankar dhe sektorët tjerë.

dhe kërkesës së jashtme që pritet të ndikojë në eksportet e Kosovës. Për ekonominë e Kosovës, projeksionet aktuale sugjerojnë se rritja reale e PBB-së do të arrijë në 4.0 përqind. Përveç transmetimit të efekteve nga zhvillimet pozitive në eurozonë dhe partnerët kryesorë ekonomikë, përforcimi i aktivitetit ekonomik pritet të vijë edhe nga zhvillimet në ekonominë vendore.

Projeksionet për vitin 2014 sugjerojnë se konsumi do të rritet me normë më të shpejtë se në vitin 2013, rritje kjo e cila pritet të nxitet nga konsumi i sektorit privat. Norma nominale e rritjes së konsumit pritet të jetë në rreth 3.0 përqind. Konsumi privat gjatë vitit 2014 pritet të jetë rrjedhojë e rritjes së pagave dhe rritjes së dërgesave të emigrantëve. Rritja e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2014 pritet të jetë rreth 2 përqind, që i atribuohet zhvillimeve më të favorshme ekonomike në vendet e europiane, sidomos në Gjermani dhe Zvicër ku janë të koncentruar pjesa më e madhe e diasporës kosovare.

Komponenta e investimeve në vitin 2014 pritet të rritet me normë të përshpejtuar, ku bartësi kryesor i rritjes së investimeve pritet të jetë sektori privat. Rritja e investimeve pritet të nxitet nga rritja e kredive investuese në vend, por me ndikim më të lartë pritet të jenë investimet e huaja direkte të cilat janë parashikuar të rriten më shpejtë se sa në vitin 2013, të nxitur nga përmirësimet në eurozonë. Rritja nominale e komponentës së investimeve gjatë vitit 2014 pritet të jetë 5.5 përqind.

Përveç komponentës së konsumit dhe investimeve, rritja ekonomike në vend gjatë vitit 2014 pritet të ndikohet në masë të konsiderueshme edhe nga komponenta e neto eksporteve. Për vitin 2014, pritet rritje e eksporteve dhe rënie e lehtë e importeve. Eksportet gjatë vitit 2014 pritet të rriten me normë më të lartë se sa në vitin 2014, si rezultat i rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe procesuese në ekonominë e Kosovës por gjithashtu edhe si rezultat i rritjes së kërkesës në nivel global. Sa i përket importeve, pritjet për rënie të importeve në vlerë nominale bazohen në projeksionet aktuale për çmimet e naftës dhe të disa kategorive tjera të produkteve që Kosova importon më shumë. Projeksionet aktuale sugjerojnë se deficitin e komponentës së neto eksporteve do të bie për 3.2 përqind duke e bërë këtë komponentë kontribues të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Inflacioni gjatë vitit 2014 pritet të arrijë në 1.5 përqind krahasuar me 1.8 përqind sa ishte në vitin 2013. Kjo rënie e shkallës së inflacionit i atribuohet trendit global por edhe atij rajonal të çmimeve i cili është në rënie. Për EJJL-në, FMN-ja ka parashikuar që mesatarja e inflacionit të shënoji rënie nga 3.7 përqind në vitin 2013 në 2.9 përqind në vitin 2014.

Norma e rritjes së kreditimit për vitin 2014 pritet të ketë ngritje të lehtë, kryesisht si rezultat i kushteve më të mira makroekonomike nga njëra anë, pozitës së mirë të kapitalit të sektorit bankar, pozitës së lartë të likuiditetit dhe nivelit të kënaqshëm të portofolit kreditor. Më konkretisht, perspektiva e zhvillimit ekonomik për Kosovën është pozitive, me normë të parashikuar të rritjes së PBB-së më të lartë se në dy vitet e fundit. Rritja e PBB-së pritet të reflektohet në rritjen e kërkesës për kredi nga të dy sektorët, ai i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare. Rrjedhimisht, pritet edhe rritje e ofertës ngase perceptimet e bankave për rrezikun dhe aftësinë e klientëve për të kthyer kreditë do të zbuten. Për më tepër, perspektiva pozitive për rritje në Eurozonë mund të ketë efekt pozitiv ngase mund të reduktojë presionet për ngritje të nivelit të kapitalit dhe shtrëngim të kreditimit nga bankat amë te bankat në Kosovë. Nga ana e ofertës, gjendja e shëndoshë e sektorit bankar, e bazuar në nivelin e kapitalit në vazhdimësi mbi kërkesat minimale rregullative, cilësinë e mirë të portofolit kreditor, si dhe shkallën e kënaqshme të likuiditetit, tregon se bankat janë në pozitë të mirë që të zgjerojnë aktivitetin kredidhënës.

Sa i përket depozitave, pritshmëritë për vitin 2014 janë se ato do të rriten me ritme të ngjashme me atë të vitit 2013. Bartësit kryesorë të rritjes së depozitave do të vazhdojnë të jetë ekonomitë

familjare. Rritja e pagave të sektorit publik pritet t'i kontribuojë rritjes së depozitave, por që rritja e tillë mund të neutralizohet nga efekti që rënia e normave të interesit në depozita mund të ketë në motivet e depozituesve për të kursyer. Rritja më e lartë e pritur e PBB-së në Kosovë dhe Eurozonë pritet të rezultojë në klimë dhe performancë më të mirë të biznesit dhe në nivel më të lartë të dërgesave të emigrantëve, të cilat nga ana tjetër pritet të ndikojnë pozitivisht në rritjen e depozitave.

Normat e interesit në kredi priten të vazhdojnë trendin e tyre rënës. Rritja graduale e konkurrencës në sektorin bankar, si dhe përmirësimi gradual i kushteve që ndikojnë perceptimet për rrezikun, si për shembull rritja ekonomike dhe efikasiteti i gjyqësorit, pritet të reflektojnë në rënie graduale të normave të interesit në kredi. Normat e interesit në depozita kanë shënuar rënie në fillim të vitit 2014. Kjo rënie sugjerohet të ketë qenë rezultat i likuiditetit të lartë të sektorit si dhe presioneve në pozitën e profitabilitetit të bankave të shkaktuara nga rënia e të hyrave të interesit në vitin paraparak. Marrë parasysh që kredimi nuk pritet të rritet me norma shumë të larta, pozita e likuiditetit të sektorit mund të vazhdojë të jetë e lartë duke ndikuar që normat në depozita të mbesin në nivel të ngjashëm.

Norma e kredive joperformuese (angl. *non-performing loans: NPL*) e sektorit bankar ka treguar stabilitet në muajt e fundit të vitit 2013 si dhe në fillim të vitit 2014 dhe ky stabilitet pritet të vazhdojë gjatë tërë vitit 2014. Sidoqoftë, mund të ketë një rritje të lehtë të normës së NPL-ve nëse nuk përshpejtohet rritja e kreditimit. Vazhdimi i trendit të ngadalshëm të kreditimit, përveç që do të mund të ndikonte në rritjen e normës së NPL-ve, gjithashtu do të mund të kishte ndikim negativ në kapacitetin për zgjerim të ndërmarrjeve dhe aftësinë e tyre për ristrukturimin dhe shlyerjen e kredive ekzistuese. Megjithatë, përmirësimi i ambientit të përgjithshëm ekonomik si dhe standardet më të shtrënguara të kreditimit, që bankat kanë raportuar të kenë përdorur në dy vitet e fundit pritet të kenë ndikim pozitiv në cilësinë e kredive dhe rrjedhimisht, të neutralizojnë ndikimin e mundshëm negativ nga ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë.

Fitimi i sektorit bankar për vitin 2014 pritet të mbetet i ngjashëm me vitin paraparak. Përshpejtimi i ritmit të kredidhënies pritet të ndikojë pozitivisht në fitimin e sektorit përmes rritjes së të hyrave të interesit. Mirëpo, kthimi nga investimet tjera, si letrat me vlerë nuk pritet të rritet duke pasur parasysh presionet deflacioniste në Eurozonë të cilat ka të ngjarë të mbajnë normat e kthimit në nivel të ulët. Po ashtu, kthimi në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës nuk pritet të rritet, marrë parasysh likuiditetin e tepërt të sektorit bankar i cili pritet të ndikojë, që kërkesa për këto letra me vlerë të mbetet në nivel të lartë. Rrjedhimisht, ndikimi pozitiv i përshpejtimt të kreditimit pritet që deri në një masë të neutralizohet. Të hyrat nga jointerеси gjatë vitit 2013 kanë ndjekur trend rritës kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të shërbimeve. Për vitin 2014, çmimet e shërbimeve pritet të mbesin në nivel të ngjashëm me vitin 2013, mirëpo pritet të vazhdojë trendi rritës i vëllimit të shërbimeve që nuk gjenerojnë interes, duke bërë që të hyrat nga jointerеси të shënojnë rritje. Në anën e shpenzimeve, shpenzimet e interesit pritet të vazhdojnë me trend rënës edhe gjatë vitit 2014. Shpenzimet e përgjithshme gjithashtu pritet të vazhdojnë me trend rënës kryesisht si rezultat i masave të ndërmarra nga bankat për zvogëlimin e kostove operacionale dhe rritjen e efikasitetit. Në anën tjetër, shpenzimet për provizione pritet të rriten krahas rritjes së kreditimit edhe pse supozohet që kjo do të jetë një rritje e lehtë duke marrë parasysh që nuk pritet ndonjë devijim i theksuar i cilësisë së portofolit kreditor.

4. Mbikëqyrja e Institucioneve Financiare

4.1. Licencimi dhe Standardizimi

4.1.1 Licencimi

Të orientuar në objektivin themelor të BQK-së për një sektor financiar të shëndoshë dhe të qëndrueshëm, BQK-ja vazhdimisht promovon zhvillimin e një sektori financiar të drejtuar nga forcat e tregut, por që vepron brenda rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikëqyrjes të harmonizuar në bazë të direktivave të BE-së, si dhe parimeve dhe standardeve të nxjerra nga institucionet e njohura ndërkombëtare (BIS, IAIS and IOPS). Bazuar në objektivin e lartcekur janë prcaktuar edhe kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe veprimtarive tjera financiare në Republikën e Kosovës me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03/ L-209, Ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare Nnr.04L/093, Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës nr.04/L-101 dhe në aktet tjera nënligjore të nxjerra nga BQK-ja. Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj statusor, BQK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e institucioneve financiare dhe për të refuzuar kërkesat të cilat nuk i përmbushin këto kritere.

Kriteret e licencimit të përcaktuara me legjislacion, synojnë sigurimin e një tregu financiar të drejtë dhe të rregulluar nëpërmjet një procesi të ndërtuar mbi bazën e parimit të drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë. Kushtet dhe kriteret e licencimit janë të karakterit mbikëqyrës dhe nuk kanë për qëllim vendosjen e barrierave ndaj investitorëve qofshin ata vendor apo të huaj. Hyrja e investitorëve të huaj në tregun kosovar, veçanërisht në sektorin financiar, dëshmon politikën e hapur të BQK-së ndaj investimeve të huaja, pa i cenuar të drejtat e tyre ligjore dhe përmes trajtimit të barabartë të të gjithë aplikuesve.

Strategjia e BQK-së në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriteret etike dhe profesionale të nevojshme dhe të përshtatshme për aksionarët dhe menaxhmentin e propozuar, janë të aftë të aplikojnë një qasje që kërkon zhvillimin e matur të biznesit për të mbrojtur interesat e klientëve, duke ndihmuar në këtë mënyrë forcimin e sektorit financiar dhe rritjen e besueshmërisë së tij.

Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit ka për detyrë që të kontribuojë në kompletimin e kornizës ligjore për mbikëqyrje financiare në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare ashtu siç janë të paraqitura me “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive Bankare” të publikuara nga Banka për Rregullim Ndërkombëtar (anglisht: Bank for International Settlement-BIS), si dhe “Principet Themelore të Mbikëqyrjes Efektive të Sigurimeve” të publikuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Mbikëqyrësve të Sigurimeve (anglisht: International Association of Insurance Supervisors - IAIS). Në përmbushjen e këtij misioni, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të institucioneve që kërkojnë licencim respektivisht regjistrim për të operuar në Kosovë, siç janë bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimit, ndërmjetësuesit e sigurimeve, fondet pensionale si dhe të gjitha institucionet tjera financiare jobankare.

Aktiviteti i licencimit të mbikëqyrjes financiare gjatë vitit 2013 kryesisht ka përfshirë:

- Aprovimin e tetë (8) kërkesave të bankave në ndryshimin e aktit të themelimit/ statutit të bankave dhe kompanive të sigurimit;

- Aprovimin e tri (3) kërkesave për shpërndarje të dividendës të bankave dhe kompanive të sigurimit;
- Aprovimin e një kërkesë për ndryshim të pronësisë së kompanisë së sigurimeve;
- Aprovimin e pesëdhjetë e tetë (58) kërkesave për emërimë të drejtorëve, menaxhmentit të lartë dhe auditorëve të brendshëm të bankave, kompanive të sigurimeve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, si dhe institucioneve tjera financiare jobankare;
- Aprovimin e një (1) kërkesë të aktuarit të kompanive të sigurimeve;
- Aprovimin e nëntëdhjetë e gjashtë (96) kërkesave për hapje të degëve të reja , zyra të reja dhe zhvendosje të degëve dhe zyra të bankave, të kompanive të sigurimit, si dhe institucioneve tjera financiare;
- Aprovimin e gjashtëdhjetë e tetë (68) kërkesave të zyra dhe agjentëve për transfer të parave dhe shërbime të pagesave;
- Aprovimin e pesë (5) kërkesave për shtimin e veprimtarive dhe të produkteve të sigurimeve;
- Aprovimin e njëqind e nëntë (109) kërkesave të operatorëve dhe agjentëve të kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Aprovimin e dyzet e shtatë (47) kërkesave të institucioneve financiare për angazhimin e auditorit të jashtëm;
- Aprovimin e dy (2) kërkesave të ndryshimit të kushteve dhe termeve të policës për sigurime vullnetare të kompanive të sigurimit;
- Refuzimin e dy (2) kërkesave të anëtarëve të bordit drejtues të kompanisë së sigurimeve;
- Refuzimin e dy (2) kërkesave të operatorëve të kompanive të sigurimit.

Në rastet e miratuara të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankave, pesëmbëdhjetë (15) raste prej tyre janë anëtarë të bordit drejtues të bankave, tre (3) anëtarë të pavarur të komitetit të auditimit, shtatë (7) raste janë kryeshef ekzekutiv dhe zëvendës të kryeshefit ekzekutiv, katër (4) auditorë të brendshëm, si dhe shtatë (7) kryeshef ekzekutiv dhe anëtarë të bordit drejtues të institucioneve mikrofinanciare, Ndërsa, tek sigurimet, pesë (5) prej tyre janë kërkesa për aprovimin e anëtarëve të bordeve drejtuese të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, gjashtë (6) raste janë për drejtor dhe zëvendësdrejtor të përgjithshëm të kompanive dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, tetë (8) për drejtorë të departamenteve të ndryshme, si dhe tre (3) për auditorë të brendshëm .

Pas vlerësimit të performancës dhe efikasitetit të tyre gjatë vitit 2013 bankat kanë mbyllur 23 nëndegë bankare, kryesisht njësi të vogla. Po ashtu arsye tjetër e mbylljes është se bankat kohëve të fundit kanë investuar në zgjerimin e shërbimeve të automatizuara në mënyrë që t'u ofrojnë klientëve mundësi për të kryer transaksionet përmes e-banking, bankomatëve, terminaleve të shitjes (POS).

4.1.2 Standardizimi dhe Rregullativa

a) Kuadri ligjor

Gjatë vitit 2013, janë përgatitur dy projekt ligje me rëndësi të veçantë për sektorin financiar në Kosovë. Që të dy këto ligje janë përgatitur në bashkëpunim edhe me këshilltarët e thesarit amerikan, si dhe për pajtueshmërinë e tyre me direktivat e BE-së është konsultuar edhe zyra e Komisionit Evropian në Kosovë. Njëri nga këto ligje është projekt-ligji për sigurimet e përgjithshme, i cili do të zëvendësojë rregulloren ekzistuese të UNMIK-ut nr.2001/25. Drafti final i këtij ligji pritet që së shpejti të procedohet më tutje tek organet relevante për përgatitjen e tij finale dhe dërgimin në parlament për aprovim. Ky ligj është përpiluar bazuar në direktivat përkatëse të BE-së dhe është shqyrtuar edhe nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë.

Gjithashtu, pjesë përbërëse e ekipit punues për përgatitjen e këtij ligji ka qenë edhe këshilltari rezidentë i Thesarit Amerikan.

Një ligj tjetër, i cili është shumë i rëndësishëm për sektorin financiar në Kosovë është Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Ky ligj, i cili gjithashtu është përgatitur në bashkëpunim me këshilltarë të Thesarit Amerikan dhe është në fazën e tij finale, i është dërguar organeve përkatëse për procedim të mëtejshëm të tij për aprovim.

Me aprovimin e këtyre dy ligjeve do të plotësohet korniza e nevojshme ligjore, e cila do të mbulojë licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës. Është me rëndësi të ceket fakti se këto ligje janë të bazuara në direktivat e BE-së dhe në praktikën e mira ndërkombëtare për mbikëqyrjen e institucioneve financiare, të cilat vendosin bazat e shëndosha për një rregullim dhe mbikëqyrje të përshtatshme edhe për këto institucione financiare, në këtë rast kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Banka Qendrore tani ka një përvojë dhe ka të themeluar departamentet përkatëse të mbikëqyrjes së institucioneve financiare. Si rrjedhojë, pritet që me konsolidimin dhe zhvillimin e bazës ligjore do të lehtësohet edhe kontrolli i vazhdueshëm dhe mbikëqyrja adekuate e funksionimit dhe veprimtarisë së këtyre institucioneve. Në këtë mënyrë, do të ruhet stabiliteti i sektorit financiar në Kosovë dhe do të sigurohen shfrytëzuesit e shërbimeve të këtyre institucioneve financiare për marrjen e trajtimit të drejtë dhe përmbushjen e kërkesave të tyre me besim dhe siguri të plotë se janë të mbrojtur dhe kanë ku të adresojnë ankesat e tyre për parregullsitë e mundshme.

b) Korniza rregullative – Rregulloret e mbikëqyrjes së bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

Qëllimi i plotësimit të rregulloreve përkatëse për mbikëqyrje financiare është sigurimi dhe krijimi i një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për ofruesit dhe përdoruesit e shërbimeve financiare.

Në pajtueshmëri me Ligjin e Ri për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, gjatë vitit 2013, BQK-ja ka vazhduar me plotësimin dhe finalizimin e rregulloreve të mbikëqyrjes bankare, duke u bazuar edhe në standardet e Komitetit të Bazelit dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.

Gjatë viti 2013 janë plotësuar rregulloret bankare si vijon:

- Rregullorja për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave ,
- Rregullorja për Depozitën Ekuivalente të Kapitalit për Degët e Bankave të Huaja
- Rregullorja për Ekspozimet e Mëdha ,
- Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor.

Gjithashtu, gjatë vitit 2013 është punuar në përgatitjen e rregullores për kreditë hipotekare dhe rregulloren për procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave, të cilat janë në fazën e tyre finale dhe pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2014.

Gjatë vitit 2013 janë nxjerrë 7 rregullore për mbikëqyrjen e institucioneve mikrofinanciare. Gjithashtu është punuar në përgatitjen e rregulloreve shtesë të nevojshme për mbulimin e mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare, të cilat janë në formë të draftit dhe pritet të finalizohen në momentin e aprovimit të Ligjit të Ri për Institucionet Mikrofinanciare. Përveç këtyre, është punuar edhe në përgatitjen e legjislacionit sekondar, përkatësisht të rregulloreve që mbulojnë fushën e mbikëqyrjes së institucioneve financiare jobankare, të cilat gjithashtu do të nxjerren në momentin e aprovimit të Ligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Sa i përket fondeve pensionale, pas aprovimit të ligjit të ri të fondeve pensionale të Kosovës gjatë vitit 2012, BQK ka vazhduar plotësimin e kornizës rregullative për mbikëqyrjen e fondeve pensionale duke adaptuar edhe kërkesat e reja të ligjit. Rregulloret e përgatitura gjatë vitit 2013 nga grupet punuese janë pothuajse të gatshme dhe pritet të nxjerren gjatë vitit 2014.

Edhe viti 2014 do të jetë vit i vazhdimësisë së konsolidimit të kornizës ligjore për mbikëqyrjen e bankave, institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare, kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale, në përputhje me ligjet e reja dhe njëkohësisht për krijimin e një kornize rregullative që reflekton në nevojat dhe kërkesat e identifikuar gjatë një periudhe trembëdhjetë vjeçare të ekzistimit të mbikëqyrjes financiare në Kosovë.

c) Korniza Rregullative – kompanitë e sigurimeve

Me qëllim të krijimit të një tregu të qëndrueshëm, konkurrues dhe stabil, BQK-ja është angazhuar në krijimin e kornizës ligjore, duke zhvilluar progres në zhvillimin e saj. Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2013, BQK-ja ka përpiluar Draftligjin për Sigurimet, Ligj i cili do të zëvendësojë Rregulloren 2001/25 të UNMIK-ut. Ky draft Ligj është rishikuar edhe nga Zyra e Bashkimit Evropian, për të siguruar se është në pajtueshmëri edhe me Direktivën Evropiane dhe i cili gjatë vitit 2014 pritet të aprovohet edhe në Kuvendin e Kosovës.

Më datë 1 korrik 2013, për herë të parë në Kosovë edhe zyrtarisht ka filluar implementimi i sistemit Bonus-Malus, i cili sistem merr për bazë një histori një vjeçare të aplikuesit për sigurimet në kuadër të policës së sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia (MTPL). Implementimin e sistemit Bonus/Malus e mundëson “Qendra informative e Siguruesve” përmes grumbullimit dhe përpunimit të informacioneve për secilin sigurues. Në bazë të aksidenteve të shkaktuara ose jo gjatë periudhës, kalkulohet Bonusin ose Malusin që i takon policëmbajtësit duke filluar nga 10% e primit bazë.

Po ashtu, gjatë vitit 2013, BQK ka lëshuar një udhëzim administrativ, përmes së cilit i obligon të gjithë siguruesit dhe Byronë Kosovare të Sigurimeve, që pagesën e të gjitha llojeve të primeve ta bëjnë përmes sistemit bankar.

4.1.3 Mbrojtja e konsumatorit

Si licencues, rregullues dhe mbikëqyrës i institucioneve financiare dhe e autorizuar sipas ligjeve në fuqi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka rolin kyç në mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve financiare në Kosovë. Bazuar në rezultatet e vlerësimit diagnostik të misionit të Bankës Botërore është draftuar strategjia për mbrojtjen e konsumatorit dhe edukimit financiar për t'i siguruar Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës udhëzimet mbi veprimet, që do të implementohen për të forcuar pozitën e konsumatorëve të shërbimeve financiare në Kosovë.

Në kuadër të Departamentit të Licencimit dhe Standardizimit është themeluar Divizioni i Shqyrtimit të Ankesave të Shfrytëzuesëve të Shërbimeve Financiare, i divizion i cili do të përkujdeset që konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në kohën e duhur. Funkzioni i Divizionit të Ankesave të Shfrytëzuesëve të Shërbimeve Financiare përfshin pranimin, sistemimin dhe shqyrtimin e ankesave për pajtueshmërinë e aktiviteteve të institucioneve financiare me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe standardet që orientojnë mbikëqyrjen e institucioneve financiare duke përcjellur dhe monitoruar sjelljen e tyre në treg. Objektivi i këtij divizioni është vendosja e bazave për shpalosjen adekuate ndaj konsumatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare në Kosovë. Ky divizion shqyrton ankesat e adresuara nga depozitorët/huamarrësit, policëmbajtësit dhe shfrytëzuesit e të gjitha shërbimeve dhe produkteve të institucioneve financiare të mbikëqyrura nga BQK-ja dhe

furnizon mbikëqyrjen dhe rregullativën me rekomandimet konkrete për praktikat e identifikuara si jo të favorshme për konsumatorët për adresimin e tyre me veprime të ardhëshme.

Gjithashtu, është nënshkruar edhe një marrëveshje e bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe MTI-së në korrik 2013, që ka për qëllim lehtësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë përmes koordinimit të politikave dhe shkëmbimit të informacionit në interes të konsumatorëve të shërbimeve financiare.

4.2. Mbikëqyrja bankare e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

4.2.1 Ekzaminimet në vend (on-site) të bankave komerciale

Në funksion të një sistemi bankar stabil, gjatë vitit 2013 janë bërë ekzaminimet e bankave komerciale konform planit të paraparë. Konsistent me praktikat ndërkombëtare në fushën përkatëse, vëmendje e veçantë i është kushtuar rrezikut kreditor, likuiditetit, tregut dhe rreziqeve tjera, bazuar në qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Në theks të veçantë gjatë ekzaminimeve ka qenë përcjellja e përmbushjes së rekomandimeve të dala gjatë ekzaminimeve, vendimeve përkatëse si dhe vlerësimeve të pajtueshmërisë së bankave me kornizën ligjore në fuqi, posaçërisht rregulloreve të BQK-se të cilat kanë hyrë në fuqi nga data 3 dhjetor 2012.

Edhe gjatë vitit 2013, si rrezik kryesor në kuadër të sektorit bankar vazhdon të mbetet rreziku kreditor. Janë kryer ekzaminime të plota dhe të fokusuara në banka, me qëllim të aplikimit të mbikëqyrjes më të përafërt të bankave. Edhe këtë vit, bankat kanë vazhduar të aplikojnë një çasje më konzervative të strategjisë së rritjes në krahasim me vitin paraprak 2012. Për më shumë, gjatë vitit të kaluar janë realizuar gjithsej tetë ekzaminime të bankave, prej të cilave pesë ekzaminime të plota dhe tri ekzaminime të fokusuara.

Ekzaminimet e plota në banka kanë pasur qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të bankës, duke përfshirë kontrollet e brendshme, kapitalin, kualitetin e mjeteve, vlerësimin e politikave dhe procedurave, menaxhmentin, fitimet (në kontekst të përkrahjes së aktivitetit), likuiditetin dhe ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut, si dhe ekzaminimi i fushës së teknologjisë informative.

Ndërsa, ekzaminimet e fokusuara në banka kanë pasur qëllim përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluar të BQK-së, si dhe në raste të caktuara edhe përcjelljen e implementimit të vendimeve të BQK-së, të dala si rezultat nga ekzaminimeve paraprake të BQK-së. Gjatë ekzaminimit është vlerësuar procesi i lejimit dhe administrimit të kredive, trendi i kualitetit të kredive, adekuatshmëria e provizioneve për humbje nga kreditë, si dhe zërat jashtëbilancor.

Gjatë vitit 2013, sektori bankar në përgjithësi ka vazhduar të operojë në pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi. Megjithatë, gjatë ekzaminimeve në vend të bankave janë evidentuar disa mangësi në drejtim të përmbushjes së plotë të kornizës ligjore, sidomos pas hyrjes në fuqi të rregulloreve të reja bankare nga 03 dhjetori 2012, procesin e administrimit të rrezikut të kreditor, tejkalimin të kufizimeve të ekspozimeve kreditor, mjaftueshmërinë e kapitalit të peshuar në rrezik, depozitin ekuivalent të kapitalit të bankave, raportin e levës si dhe çështje të raportimit.

Gjatë vitit 2013 në disa banka janë evidentuar disa raste të mospajtueshmërisë së plotë me disa nene të kornizës ligjore të BQK-së në çështjet si: menaxhimi i rrezikut kreditor, mospajtueshmëria e procedurave të detajuara që përshkruajnë procesin e klasifikimit dhe provizionimit të kredive,

mospajtueshmëria e plotë e metodologjisë së provizioneve të përgjithshme për humbje nga kreditë, mos shpalosjen e normës efektive të interesit, si dhe çështje të tjera relevante.

Si rezultat i evidentimit të mospajtueshmërisë së plotë të bankave me kornizën ligjore në fuqi, janë ndërmarrë masa detyruese ndaj bankave në formë të vendimeve, si dhe në formë të rekomandimeve të specifikuar si çështje për vëmendje të bordit të drejtorëve të listuara si në vijim:

- Masat përmirësuese në formë të vendimeve;
- Ri-publikimi i pasqyrave financiare, bazuar në korrigjimet e pozicioneve financiare nga rezultat e ekzaminimit të BQK-së;
- Rritja e kapitalit aksionar, për të qenë në pajtueshmëri rregullore për mjaftueshmërin e kapitalit të bankave;
- Sjellja e ekspozimeve kreditore të huamarrësve në kufirin e përcaktuar sipas kornizës ligjore si dhe aprovimi i përjashtimeve të limiteve kreditore;
- Përmirësimi i praktikave të menaxhimit të rrezikut kreditor;
- Përpilimi i planit për përmirësimin e fitimeve, duke analizuar racionalizimin e shpenzimeve të kostove tjera që ngarkojnë pozitën financiare;
- Përpilimi i planit për zvogëlimin e përqendrimit të portofolit kreditor në ekspozimet e mëdha;
- Sigurimi i adekuatshmërisë së kapitalit pas korrigjimeve për ekspozimeve ndaj personave të ndërlidhur me bankën;
- Sigurimi i një sistemi të shëndoshë të kontrollit të brendshëm;
- Rishikimin dhe plotësimin e politikave të bankës në pajtueshmëri me kërkesat e rregulloreve të BQK-së.

Kutia 1. Ecuria e Procesit të Likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës

Procesi i likuidimit të Bankës Kreditore të Prishtinës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Deri në fundvitin 2013 janë rimbursuar gjithsej 54.3% e shumës së gjithsej depozitave, përkatësisht 99.8% e numrit të llogarive të depozitave. Procesi i likuidimit është e lidhur ngushtë me efikasitetin e arkëtimeve të kredive si dhe me marrjen dhe shitjen e burimeve dytësore të huamarrësve, siç janë hipotekat. Gjatë vitit 2013, nga kreditë janë arkëtuar gjithsej 165.2 mijë euro.

Tabela 7. Kreditë – Trendi i Arkëtimeve

Përshkrimi	Nr.Llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Nr.	%	Nr.	%
Kreditë me 13.03.2006		28,438,587				
Kreditë me 01.01.2013		21,789,058			6,649,529	23.4%
Kreditë me 31.12.2013		21,623,878			6,814,709	24.0%
Arkëtimet gjatë 2013		159,907			159,907	0.6%

Burimi: BQK (2014)

Gjatë vitit 2013 procesi i likuidimit ka vazhduar me mbledhjen e kredive, rimbursimin e depozitorëve, si dhe sigurimin e disa kredive me hipoteka shtesë dhe me kualitative, ku edhe janë arritur rezultate konkrete në marrjen e hipotekave shtesë nga kredimarrësit.

Tabela 8. Depozitat – Trendi i Rimbursimeve

Përshkrimi	Nr.Llogarive	Shuma	Ndryshimi në llogari		Ndryshimi në shumë	
			Nr.	%	Nr.	%
Depozitat me 13.03.2006	35529	33,454,222				
Depozitat me 01.01.2012	65	15,355,734	35464	0.9981705	18,098,488	54.1%
Depozitat me 31.12.2012	59	15,291,985	35470	0.9983394	18,162,237	54.3%

Burimi: BQK (2014)

Zyra e likuidatorit në vazhdimësi ka qenë në funksion të marrjes së të gjitha masave dhe veprimeve të mundshme me qëllim që gjatë procesit të likuidimit të merret parasysh parimi kryesor, që procesi i likuidimit në të gjithat fazat e tij të shoqërohet me maksimizimin e mjeteve likuide në dispozicion me qëllim të maksimizimit të kompensimit të depozituesve.

4.2.2 Ekzaminimet në vend (on-site) të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare

Në pajtim me objektivat e BQK-së në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sektorit financiar, BQK-ja në vazhdimësi ka performuar një mbikëqyrje të bazuar në rrezik, duke kryer ekzaminime direkte në vend si dhe monitorime nga jashtë. Gjatë vitit 2013 janë kryer disa ekzaminime të plota në institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare. Kjo, konform qasjes së bazuar në rrezik.

Përveç ekzaminimeve të rregullta është vazhduar me përcjelljen e përmbushjes së rekomandimeve dhe zbatimin e urdhëresave për institucionet përkatëse mikrofinanciare dhe jobankare. Në fokus të aktivitetit mbikëqyrës kanë qenë qeverisja e këtyre institucioneve si një ndër mangësitë më të theksuara, pastaj, rreziku kreditor – përshtatshmëria e njohjes dhe provizionimit të portofolit kreditor, rreziku i likuiditetit, niveli i kapitalit, fitimet, vlerësimi i politikave dhe procedurave të institucionit, si dhe vlerësimi i teknologjisë informative. Gjithashtu, mbi bazën e raporteve tremujore është bërë monitorimi – analizimi nga jashtë i performancës së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare kanë arritur avancim në zbatimin e kërkesave rregullative të BQK-së. Në raste të parregullsive, mostransparencës apo moszbatimit të kërkesave përkatëse, janë ndërmarrë masa korrektuese ndaj institucioneve në fjalë.

Disa nga masat thelbësore për evitimin e problemeve qeverisëse kundrejt institucioneve përkatëse kanë qenë: shqiptimi i dënimeve me gjobë monetare; vërejtja me shkrim për mosushtrimin me përgjegjësi të funksioneve përkatëse, të personave përgjegjës; rritja e kapitalit minimal në mënyrë që të plotësojë kapitalin e kërkuar me kornizën ligjore; kthimi i huamarrjeve tek institucionet e caktuara; evitimi i konfliktit të interesit; sigurimi/ndarja e funksionit adekuat të detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet poziatve përkatëse të punës; zëvendësimi i anëtarëve të komitetit të auditimit me anëtar të rinj joekzekutiv dhe në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; Sigurimi i pavarur i funksionit të auditimit të brendshëm; si dhe një varg veprimesh ekuivalente deri te raportimi i kredive të riprogramuara në pajtueshmëri me rregulloren për menaxhimin e rrezikut kreditor.

4.3. Parandalimi i pastrimit të parave

Banka Qendrore e Kosovës rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe fuqizimit të parandalimit të pastrimit të parave, duke e ristrukturuar Divizionin e Parandalimit të Pastrimit të Parave, shtuar numrin e kapaciteteve njerëzore e teknike dhe duke e ngritur në nivel të lartë të raportimit hierarkik. Me këtë rast Divizioni ka kompletuar procedurat interne dhe dokumentet tjera standarde të punës dhe tanimë është operacional.

Pas plotësim-ndryshim të ligjit përkatës, Divizioni ka draftuar edhe rregulloren dhe manualin për inspektime për institucione financiare, të cilat do të shërbejnë si dokumente praktike për zbatimin e mandatit ligjor në këtë lëmi. Për më tepër Banka Qendrore ka lidhur edhe Memorandum të Mirëkuptimit me Njësinë për Inteligjencë Financiare, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve sipas legjislacionit në fuqi, me theks të veçantë në fushën e ekzaminimeve/inspektimeve të sektorit financiar nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore,

në lidhje me zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Gjithashtu gjatë vitit, BQK-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë duke kontribuar në implementimin e projektit kundër krimit në Kosovë të iniciuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Synimi i këtij projekti është forcimi i kapaciteteve institucionale në bashkëpunim me Këshillin e Evropës në fushën e PPP/PFT.

4.4. Mbikëqyrja e sigurimeve

Sektori i sigurimeve në Kosovë është i rregulluar dhe i mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Synimi kryesor i BQK-së është krijimi i një ambienti të sigurt, të shëndoshë dhe stabil me qëllim të mbrojtjes së interesave të policëmbajtësve, palëve të dëmtuara, investitorëve potencialë si dhe të sigurojë cilësi dhe transparencë të plotë gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimeve të sigurimit. Në përputhje me këtë, Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (DMS) ka vazhduar aktivitetin mbikëqyrës me qëllim të sigurimit të stabilitetit në sektorin e sigurimeve, duke marrë masat e duhura dhe me kohë për zbatimin e një mbikëqyrjeje efektive dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të sigurimeve. Objektivi kryesor i DMS-së është mbrojtja e policëmbajtësve dhe palëve të dëmtuara, duke vepruar gjithnjë në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve të BQK-së, brenda të cilave industria e sigurimeve e zhvillon aktivitetin e saj sigurues, duke i kompensuar me rregull dëmet për klientët e saj.

BQK-ja edhe gjatë vitit 2013 është angazhuar në adaptimin e praktikave më të mira të mbikëqyrjes së sigurimeve, duke u bazuar në parimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, duke kontribuar kështu në rritjen e transparencës së operacioneve të siguruesve ndaj publikut.

Me kujdes të veçantë është mbikëqyrur pozicioni financiar i kompanive të sigurimit, gjë që ka rezultuar me përmirësim të vazhdueshëm të pozicionit financiar të sektorit të sigurimeve në Kosovë, përmirësim ky i cili ka reflektuar me mbrojtje më të mirë të interesave të policëmbajtësve dhe të dëmtuarve tjerë në përgjithësi. Një vëmendje e posaçme i është kushtuar treguesve financiarë lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit, margjinës minimale të solvencës, kërkesave për kapital variabil në emër të riskut sigurues si dhe të treguesve tjerë financiarë të likuiditetit dhe profitabilitetit. DMS-ja po ashtu me kujdes të veçantë e ka rishikuar nivelin e mjaftueshmërisë së provizioneve teknike për të vlerësuar nëse janë të mjaftueshme dhe nëse në çdo kohë mbulohen me asete likuide.

Ekzaminimet e plota kanë pasur si qëllim vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të kompanive të sigurimeve, duke përfshirë kontrollin e brendshme, pajtueshmërinë me ligjet, rregullat dhe rregulloret në fuqi, politikat, procedurat dhe praktikën e kompanive të sigurimeve, vlerësimin e kapitalit, solvencës dhe riskut sigurues, përshtatshmërinë e organeve drejtuese të kompanive të sigurimeve, marrjen në sigurim, procesimin e kërkesave për zhdëmtim, rezervat teknike, risigurimin, investimet. Gjithashtu, ekzaminimet e plota në kompani të sigurimeve kanë përfshirë edhe pjesën e parandalimit të pastrimit të parave dhe vlerësimin e teknologjisë informative. Bazuar në rezultatet e ekzaminimit, është bërë edhe lëshimi i vendimeve të caktuara, ku gjatë ekzaminimit është vlerësuar edhe zbatimi i vendimeve të BQK-së, sipas afateve të përcaktuara kohore.

Ekzaminimet e fokusuara kanë pasur si qëllim përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve nga ekzaminimet e kaluara të BQK-së, pozicione të veçanta të pasqyrave financiare, si dhe në raste të caktuara edhe përcjelljen e zbatimit të vendimeve të BQK-së që kanë dalë si rezultat i ekzaminimeve të kaluara.

Kompanitë e sigurimeve, në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të BQK-së. Megjithatë, ekzaminimet në vend të kompanive të sigurimeve kanë evidentuar mos pajtueshmëri me kornizën ligjore të BQK-së, si në vijim:

- Shpërndarja joadekuatë e investimeve – mjeteve likuide të kompanive në bankat komerciale, vonesa në trajtimin dhe pagesën e dëmeve në të shumtën e rasteve janë nënvlërësuar provizionet teknike. Është konstatuar shitja e produkteve të sigurimeve pa aprovimin paraprak të BQK-së, mos respektimi i tarifave si dhe mbajtja e rrezikut mbi limitet e përcaktuara nga BQK-ja.
- Po ashtu është konstatuar mungesë e sistemeve efektive të kontrolleve të brendshme, mosfunksionimi i komiteteve lidhur me transaksionet me palët e ndërlidhura, prezantimi i pasqyrave financiare nuk është bërë në harmoni të plotë me SNK-të, si dhe niveli i lartë i debitorëve të primeve dhe të arkëtueshmeve tjera, mosprovizionim i të arkëtueshmeve tjera mbi 90 ditë si dhe është konstatuar nivel i lartë i shpenzimeve.

Si rezultat i evidentimit të mospajtueshmërisë me kornizën ligjore në fuqi, ndaj kompanive të sigurimeve janë ndërmarrë masat, si në vijim:

- Masa përmirësuese në formë të “Vendimeve” si shqiptimi i vërejtjeve i dënimeve me gjoha monetare, shkarkimi i personave përgjigjes, ndërprerja e shitjes së produkteve vullnetare nga personat përgjigjes. Po ashtu gjatë vitit 2013 kompanitë e sigurimeve kanë bërë shtim të kapitalit themeltar dhe variable si dhe janë bërë korrigjime në investimet e fondeve të kompanive.

4.4.1. Struktura e origjinës së kapitalit të siguroeseve në Kosovë

Gjatë vitit 2013 numri dhe struktura e pronësisë së siguroeseve të cilat ushtruan aktivitet sigurues jetë dhe jojetë në Kosovë mbeti e pandryshuar. Numri i përgjithshëm siguruesve gjatë vitit 2013 ishte trembëdhjetë (13), ku dhjetë (10) prej tyre vazhduan të ofrojnë produkte të sigurimit jo-jetë, ndërsa tri (3) tjera ofruan produkte të sigurimit të jetës.

Tabela 9. Siguruesit dhe origjina e kapitalit

Vendi i origjinës së Kapitalit	Viti 2013			Viti 2012		
	Numri	Kapitali	Përqindje	Numri	Kapitali	Përqindje
Austria - Shqipëria	4	16,543,771	35.80%	5	16,842,698	37.20%
Kosova	4	15,385,907	33.30%	3	12,387,020	27.30%
Slovenia	2	7,245,506	15.70%	2	6,821,620	15.10%
Kroacia	1	3,456,145	7.50%	1	4,073,579	9.00%
Shqipëria	1	485,975	1.10%	1	1,702,719	3.80%
Turqia	1	3,135,862	6.80%	1	3,493,632	7.70%
Gjithsejt	13	46,253,165	100.00%	13	45,321,267	100.00%

Burimi: BQK (2014)

Nga gjithsej numri i siguroesve (shih. tabelën 9), 4 prej tyre ishin siguroes me kapital të jashtëm të përzier (Austri dhe Shqipëri), 4 tjerë me kapital vendor, 2 me kapital nga Sllovenia dhe nga një siguroes me kapital nga Kroacia, Shqipëria dhe Turqia. Nëse e krahasojmë këtë strukturë të pronësisë me strukturën e vitit paraprak (2012), atëherë mund të shohim se ka pësuar një ndryshim të vogël në favorin e siguroesve me pronësi vendore. Kjo për faktin se gjatë vitit 2013 një siguroes jojetë me kapital të përzier Austri – Kosovë ka kaluar tërësisht në pronësi vendore dhe njëkohësisht ka ndryshuar emri dhe logon e tij.

4.4.2. Struktura e mjeteve sipas vendit te origjinës

Gjithsej mjetet e sektorit të sigurimeve në Kosovë më 31 dhjetor 2013 ishin 132.0 mln euro, ku asetet me pronësi vendore përfaqësojnë 35.1% të totalit të mjeteve të sektorit të sigurimeve (shih tabelën 10), në krahasim me vitin paraprak që përfaqësonte 24.0%. Ky ndryshim në përbërjen e strukturës së mjeteve është bërë për faktin se një siguruesi me kapital të përzier Austri-Kosovë, ashtu siç është cekur më lartë, ka ndryshuar strukturën e pronësisë dhe ka kaluar 100% si sigurues me kapital vendor.

Tabela 10. Struktura e mjeteve sipas origjinës së sigurueseve

Pershkrimi	Viti 2013		Viti 2012	
	Mjetet	Përqindje	Mjetet	Përqindje
Austria - Shqipëria	38,229,237	28.96%	51,364,555	39.46%
Kosova	46,349,655	35.11%	31,269,927	24.02%
Slllovenia	21,239,475	16.09%	20,140,339	15.47%
Kroacia	7,256,889	5.50%	7,820,206	6.01%
Shqipëria	8,055,087	6.10%	9,204,372	7.07%
Turqia	10,876,482	8.24%	10,371,407	7.97%
Gjithsejt	132,006,825	100.00%	130,170,806	100.00%

Burimi: BQK (2014)

4.4.3. Proceset në zhvillim

BQK-ja është në proces të rifreskimit të memorandumit të mirëkuptimit me Shqipërinë, me qëllim të thellimit të mëtejme të bashkëpunimit të dyanshëm në shkëmbimin e informatave në fushën e sigurimeve, si dhe në trajtimin dhe pagesën korrekte të dëmeve si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga automjetet e siguruar në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë.

Po ashtu, çështja e njohjes reciproke të sigurimeve nga auto përgjegjësia me qëllim të lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe automjeteve midis Kosovës dhe Serbisë është në proces të negocimit mes dy vendeve.

Me aprovimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit të Përgjithshëm të Sigurimeve do të krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore në sektorin e sigurimeve. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, BQK-ja si autoritet mbikëqyrës dhe rregullator, do të jetë e obliguar që të rishikojë komplet infrastrukturën ligjore të sektorit. Shumica e rregulloreve që aktualisht janë në fuqi do të jenë subjekt i rishikimit dhe përmirësimit të tyre.

Një çështje tjetër për t'u adresuar mbetet çështja liberalizimit të kontrolluar të tarifave të autopërgjegjësive. Liberalizimi i tarifave të autopërgjegjësive ka qenë edhe rekomandim i misionit të Bankës Botërore në Kosovë.

4.5. Mbikëqyrja e Pensioneve

Sistemi pensional i Kosovës gjatë vitit 2013 nuk ka pasur ndonjë ndryshim të theksuar edhe pse lëvizja e çmimit të njësive në tregjet financiare, ndikon drejtpërsëdrejti në mjetet pensionale të investuara jashtë Kosovës. Qëllimi i mbikëqyrjes së Divizionit të Pensioneve mbetet mbikëqyrja dhe rregullimi i fondeve pensionale, ofruesve të pensioneve, menaxhuesve të mjeteve, investimeve dhe ruajtja e mjeteve të kontribuuesve.

Sistemi pensional në Kosovë funksionon në bazë të Ligjit 04/L-101 cili ka hyrë në fuqi më 30 mars të vitit 2012.

Ligji në fjalë përcakton dhe rregullon tri (3) shtylla të sigurimit pensional:

- Pensionin bazë të moshës së vjetër për të gjithë të moshuarit mbi 65 vjeç dhe financohet nga të hyrat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (shtylla e I-rë);
- Pensionet e kursimeve individuale që i siguron Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK), financohet nga kontributet e obligueshme të punonjësve dhe punëdhënësve (shtylla e II-të) dhe;
- Pensionet plotësuese individuale financohen nga kontributet vullnetare plotësuese individuale dhe të punëdhënësve (shtylla e III-të).

Në bazë të Ligjit 04/L-101 për Pensionet në Kosovë, shtylla e dytë financohet nga kontributet mujore të detyrueshme të cilat janë të përcaktuara me Ligj ku 5% kontribuojnë të punësuarit në bruto pagën e tyre dhe 5% kontribuojnë punëdhënësit. Çdo pagesë transferohet në llogaritë individuale të kontribusve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Për vitin 2013 janë kryer ekzaminime të plota në bazë të planit për ekzaminime të Divizionit të Mbikëqyrjes së pensioneve.

Tabela 11. Ekzaminimet e kryera nga mbikëqyrja e pensioneve gjatë vitit 2013

Përshkrimi	I Plot	I fokusuar
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës	1	0
Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve	1	0
Gjithsejt	2	0

Burimi: BQK (2014)

Divizioni i Mbikëqyrjes së Fondeve Pensionale në vitin 2013 ka filluar rishikimin, përshtatjen dhe harmonizimin e legjislacionit sekondar të pensioneve me Ligjin për Fonde Pensionale të Kosovës nr. 04/L-101 dhe rregullativën e Bashkimit Evropian.

Po ashtu është edhe duke u përgatitur udhëzuesi për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe rregullativën e nevojshme.

a) Shtylla e II-të

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës "FKPK".


FKPK është themeluar për të administruar dhe menaxhuar kursimet individuale pensionale të obligueshme (shtyllën e dytë), përderisa nuk liberalizohet tregu i pensioneve, FKPK është i vetmi institucion i cili merret me menaxhimin dhe administrimin e shtyllës së dytë ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi pensionet

nr. 04/L-101.

Fondi i Kursimeve Pensionale të

Kosovës është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, e amendamentuar me Rregulloren 2005/20 dhe e amendamentuar me Ligjin për Fonde pensionale në Kosovë nr. 04/L-101, si entitet ligjor joprofitabil; me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesëshëm, mbrojtje të aseteve pensionale dhe pagimin e kursimeve pensionale.

Figura 72. Çmimi i njësisë janar-dhjetor 2013



Burimi: FKPK (2014)

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës drejtohet nga Bordi Udhëheqës i cili ka tetë (8) anëtarë dhe Drejtori Menaxhues të cilët udhëheqin dhe mbikëqyrin punën e FKPK-së.

Numri i kontribuuesve më 31 dhjetor 2013 ishte 449,000 ndërsa në vitin 2012 ka qenë 418,064 kontribues.

Vlera e mjeteve në menaxhim të Fondit në vitin 2013 është rritur për 173,477,306.54€ ndërsa shumën prej 119,156,249.53€ janë kontribute të pranuar gjatë vitit 2013.

Gjithsej vlera e mjeteve në menaxhim nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës më 31 dhjetor 2013 ishte 913,602,429.01€ ndërsa në vitin 2012 vlera e mjeteve nën menaxhim ishte në shumë 740,125,122.47€.

Gjatë vitit 2013 FKPK ka investuar mjete në tregjet e huaja në vlerë prej 650,832,611.24€.

Fondi i kursimeve pensionale në bazë të Ligjit nr. 04/L-101 ka investuar në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në shumën prej 53,122,906.79€.

Fondi i Kursimeve Pensionale gjatë vitit 2013 ka pasur një kthim pozitiv nga investimi i mjeteve në vlerë prej 68,124,736.79€ apo 7.46% ndërsa në vitin 2012 kthimi nga investimet ka qenë në vlerë prej 53,654,123.00€ apo 7.18%.

Fitimin neto për vitin 2013 ishte në vlerë prej 63,525,266 euro

Tabela 12. Struktura e investimit të mjeteve pensionale deri më 31 dhjetor 2013

Institucionet ku janë të investuara mjetet pensionale	Klasa e Asetit	Mjetet	Pjesëmarrja në %
Vanguard	Ekuitete	313,444,532	34.31%
Schroders	Bono	96,379,844	10.55%
European Credit Managment	Treg i Kredive	23,403,321	2.56%
Aquila	Diversified	26,986,630	2.95%
AXA GILB	Bono të lidhura me inflacionin	57,478,701	6.29%
BNY Mellon	Të ndryshme	133,139,594	14.57%
Letrat me Vlere te Qeversise Kosoves		53,122,907	5.81%
BQK	Të painvestuara	209,646,849	22.95%
Gjithsej		913,602,377	100.00%

Burimi: BQK (2014)

Në fund të vitit 2012 vlera e njësisë së aksioneve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ishte 1.117 € ndërsa në vitin 2013 është rritur në 1.2117€ ose për 7.34%.

Për vitin 2013 në bazë të vendimit të bordit ekzekutiv Fondi i Kursimeve Pensionale ka paguar tarifën e mbikëqyrjes e cila ngarkohet në Taksën Menaxhuese në vlerë prej 15,539.00€.

Në tabelën në vijim është pasqyruar përqindja e pjesëmarrjes së aset menaxherëve në investimin e mjeteve pensionale sipas klasëve të asetëve në total mjetet e FKPK-së për vitin 2013.

b) Shtylla e III

Fondi Slloveno - Kosovar i Pensioneve “FSKP”


FSKP është themeluar si shoqëri aksionare “Prva Group” nga Ljubljana dhe Korporata “Dukagjini” nga Peja, më 4 shtator 2006, në bazë të Ligjit 04/L-101. FSKP-ja është licencuar si Fond Pensional Suplementar.

Më 31 dhjetor 2013 mjetet e Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve arritën vlerën 5,070,437.00€ €, ndërsa vlera e mjeteve në F1 me 31 dhjetor 2012 ka qenë 4,467,722.66€.

Vlera e njësi së aksioneve me 31 dhjetor 2013 ishte 138.56 € ndërsa me 31.12.2012 ka qenë 129.97€.

Numri i kontribuuesve për vitin 2012 ka arritur në 3,704 anëtarë ndërsa në vitin 2011 numri i kontribuesve ka qenë 3,590.

Figura 73. Vlera e njësisë së Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve 2007-2013



Burimi: FKPK (2014)

Tabela 13. Struktura e investimit të mjeteve pensionale nga FSKP-ja deri më 31 dhjetor 2013

Përshkrimi	Mjetet në Euro
Aksione	379,163
Obligacione dhe letra të tjera fikse me vlerë	3,214,794
Depozita	1,077,501
Kesh	116,286
Asetet tjera	282,693
Gjithsej	5,070,437

Burimi: FSKP (2014)


Ngjashëm me institucionet tjera financiare edhe operatorët e sistemit të pensioneve si Fondi ashtu edhe FSKP-ja, u janë nënshtruar ekzaminimeve “on-site” dhe “off-site” të kryera nga Divizioni i Pensioneve dhe të Tregut të BQK-së po ashtu gjatë vitit 2013 Fondi Slloveno-Kosovar ka paguar Tarifën për Mbikëqyrje në vlerë prej 5,000.00€.

5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

5.1. Operacionet dhe menaxhimi i parave të gatshme


BQK-ja gjatë vitit 2013 siguroi një ofertë kualitative dhe kuantitative të parave të gatshme për sektorin bankar, me qëllim të shlyerjes së transaksioneve me para të gatshme të ekonomisë dhe qytetarëve. Si rrjedhojë, funksioni dhe qëllimi strategjik i BQK-së për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi gjatë vitit 2013 është përmbushur në mënyre të suksesshme.

Figura 74. Furnizimi me para të gatshme



Burimi: BQK (2014)


Figura 75. Pranimi i parave të gatshme



Burimi: BQK (2014)


Përgjegjësitë e BQK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme gjatë vitit 2013 sikurse në vitet paraprake kishte të bëjë në radhë të parë me valutën euro meqë euroja është valuta që përdoret zyrtarisht në Kosovë.

Figura 76. Furnizimi me kartëmonedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2014)

Figura 77. Furnizimi me monedha euro sipas denominimeve (numri i copëve)



Burimi: BQK (2014)


Vlera e përgjithshme e furnizimit me para të gatshme në vitin 2013 shënoi një rënie prej 9.17 për qind krahasuar me vitin 2012. Struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve, që në radhë të parë përcaktohet nga kërkesat e sektorit bankar, nuk patën ndryshim të dukshëm nga viti 2012 në vitin 2013. Të kartëmonedhat euro vazhduan të dominojnë furnizimet me denominimet e ulëta – 5, 10, 20 dhe 50 euro, ndërsa vëllimet e denominimeve prej 100, 200 dhe 500 euro mbeten dukshëm më të ulëta. Gjatë vitit 2013, vëllimet e denominimeve të ulëta në vlerë prej 20 dhe 10 euro patën rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë, kurse vëllimi i denominimit në vlerë prej 50 euro kishte një rënie të lehtë.

Siç është paraqitur në figurat e mëposhtme, gjatë vitit 2013, BQK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me afër 10.5 milionë copë kartëmonedha euro (në shumë prej mbi 266.5 milionë euro) dhe mbi 1 milion copë monedha euro (në shumë rreth 0.2 milion euro).

Furnizimi me monedha euro, njëjtë sikurse gjatë vitit 2012, në vitin 2013 kryesisht u dominua nga monedhat me vlerë të vogël nga 1 eurocent deri në 5 eurocent. Vëllimet e furnizimit të denominimeve të ulëta në vlerë prej 2 euro cent dhe 1 euro cent gjatë vitit 2013 patën rënie të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë kurse vëllimi i furnizimit të denominimit prej 5 eurocent shënoi rritje. Vëllimet e furnizimit të denominimeve prej 10 eurocent e deri tek dy euro shënuan rënie të konsiderueshme.


Vlera e përgjithshme e parave të gatshme të pranuar si depozita shënoi një rënie të lehtë prej 3.29 përqind në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. BQK-ja pranoi afër 15.7 milionë copë kartëmonedha euro (mesatarisht rreth 63,000 copë kartëmonedha në ditë) dhe afër 2.5 milionë copë monedha euro (mesatarisht rreth 10,000 copë monedha në ditë), si depozita në para të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Të shprehura në vlerë, këto depozita arritën përafërsisht shumat prej 735.5 milionë euro dhe 2.0 milionë euro, përkatësisht. Struktura e kartëmonedhave euro të pranuar gjatë vitit 2013 nuk pati ndonjë ndryshim të madh nga viti paraprak, ndërsa struktura e monedhave të pranuar gjatë vitit 2013 gjegjësisht prerjet e monedhave prej 1 euro dhe 50 eurocent patën një vëllim të shtuar të depozitimit krahasuar me monedhën prerje prej 2 euro e cila shënoi një rënie të lehtë.

Figura 78. Kartëmonedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i



Burimi: BQK (2014)

Figura 79. Monedha euro të pranuar sipas denominimeve (numri i copëve)




Burimi: BQK (2014)

Gjatë vitit 2013, ngjashëm me vitet e kaluara, paratë e gatshme neto¹³ të depozituara ishin në një vlerë më të lartë se sa paratë e gatshme të furnizuara. Në fakt, duke arritur në rreth 471 milionë euro, ndryshimi i tillë ishte në një masë më të lartë se sa në vitin e mëhershëm që ishte rreth 469.2 milionë euro. Kjo rritje ishte kryesisht si rezultat i zvogëlimit të kërkesës së sektorit bankar për furnizim me kartëmonedha euro.

Meqë BQK-ja mbanë vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme, tepricat janë dërguar në eurozonë, ku më pastaj kthehen në mjete interes-prurëse dhe përdoren edhe për kryerjen e pagesave ndërkombëtare. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2013 arritën shumën prej 460.2 milionë eurove duke qenë më e ulët se sa një vit më herët kur ishin 465.5 milionë euro. Ky zvogëlim i neto dërgesave në vitin 2013 erdhi si rrjedhojë e rritjes së importit të parave të gatshme plotësisht të reja nga Eurozona me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Ecuritë e eksporteve dhe importeve të parave të gatshme gjatë viteve të fundit janë të paraqitura në dy figurat në vijim.


¹³ Depozitat minus Tërheqjet

Figura 80. Eksporti i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Figura 81. Importi i parave të gatshme (vlera), në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Ashtu sikurse në vitet e kaluara, operacionet me para të gatshme vijuan të kryhen përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat standarde të BQK-së. Të gjitha paratë e gatshme të pranuar nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera u procesuan (afër 15.7 milionë copë kartëmonedha euro dhe 2.5 milionë copë monedha euro) dhe u klasifikuan sipas shkallës së vjetërsimit.

Figura 82. Numri i kartëmonedhave të vjetërsuara të tërhequra nga qarkullimi (numri i copëve)



Burimi: BQK (2014)


Figura 83. Proporcioni i kartëmonedhave të tërhequra nga qarkullimi nga gjithsej të pranuar



Burimi: BQK (2014)


Rreth 6 milionë copë kartëmonedha euro (38.3 për qind e numrit të përgjithshëm kartëmonedhave euro të depozituara nga sektori bankar) gjatë vitit 2013 u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi duke u dërguar në bankat qendrore të Eurozonës.

Figura 84. Furnizimi me kartëmonedha të reja (numri i copëve)



Burimi: BQK (2014)

Figura 85. Proporcioni i kartëmonedhave të reja të futura në qarkullim nga gjithsej të furnizuara




Burimi: BQK (2014)

Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro tejet të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në

qarkullim në Republikën e Kosovës. Kartëmonedhat që më së shumti u klasifikuan si tejet të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi ishin ato të denominimeve 50, 20, 10 dhe 5 euro për shkak të qarkullimit më të madh të tyre në ekonomi.

Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të kartëmonedhave plotësisht të reja euro, të cilat u sollën nga Eurozona. Gjatë vitit 2013, BQK-ja furnizoi sektorin bankar me më shumë se 4.1 milionë copë kartëmonedha të reja euro (39.21 për qind e të gjithë numrit të kartëmonedhave euro të furnizuara). Të gjitha kartëmonedhat e reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve të ulëta (20, 10 dhe 5 euro), me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të një cilësie standarde të lartë (cilësia adekuate për bankomatë).

Figura 86. Parate euro te falsifikuara te konfiskuara ne nivel te Kosoves (numri i copëve)



Burimi: Agjencia e Kosovës për Forenzikë (2014)

Për sa u përket masave kundër falsifikimit, BQK-ja ka përcjellë rastet e parave të falsifikuara gjatë vitit 2013. Në veçanti, vazhdoi të bashkëpunojë me autoritetet për avancimin e raportimit të parave të gatshme të dyshuara si false. Më tutje në vitin 2013, BQK-ja së bashku me Policinë e Kosovës dhe Laboratorin e Forenzikës publikuan në ueb¹⁴ faqen e BQK-së statistikën mbi paratë e falsifikuara në nivel të Republikës së Kosovës. Më tutje, materiale edukative u publikuan me qëllim të informimit të publikut të gjerë mbi tiparet e sigurisë së kartëmonedhave.

5.2. Mirëmbajtja dhe transaksionet e llogarive

BQK-ja ofron shërbime bankare për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe institucione të tjera, siç janë bankat dhe institucionet tjera financiare, subjektet publike, bankat e huaja, bankat qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare (Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore) dhe organizatat ndërkombëtare, siç është specifikuar në nenin 9 të ligjit nr. 03/L-209 të BQK-së.

Tabela 14. Shuma e transaksioneve sipas llojeve kryesore të pagesave (në mijëra euro)

Llojet e transaksioneve	2009	2010	2011	2012	2013
Transaksionet me para të gatshme	+411,055	+423,658	+535,190	+468,755	+470,786
Depozita në para të gatshme	+601,207	+648,911	+760,082	+762,596	+737,524
Tërheqje të parave të gatshme	+190,152	+225,253	+224,892	+293,841	+266,738
Transferet vendor	+41,169	+392,587	+462,867	+335,267	+581,797
Transferet vendor ardhës	+1,225,527	+1,568,021	+1,615,232	+1,568,574	+1,554,535
Transferet vendor dalës	+1,184,358	+1,175,434	+1,152,365	+1,233,308	+972,738
Transferet ndërkombëtar	(-463,816)	(-408,689)	(-558,778)	(-366,873)	(-321,676)
Transferet ndërkombëtar ardhës	+202,755	+326,319	+266,706	+372,967	+653,710
Transferet ndërkombëtar dalës	+666,571	+735,008	+825,483	+739,840	+975,386

Burimi: BQK (2014)


¹⁴ <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,141>

Në vitin 2013, sikurse edhe viteve të mëparshme, këto shërbime përbëheshin kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe kryerja e pagesave, duke përfshirë çfarëdo forme të kreditimit.

Gjatë vitit 2013, BQK-ja ka mbështetur avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe akordimeve të Ministrisë së Financave dhe të AKP-së. Format e pagesave dhe mënyrat e komunikimit u janë përshtatur kërkesave të tyre. Vlen të veçohet elektronizimi i plotë i urdhërtransferëve ndërkombëtarë të Ministrisë së Financave.


Përderisa pjesa më e madhe e operacioneve me para të gatshme të BQK-së gjatë vitit 2013 u kryen në emër të dhe për llogari të bankave komerciale, pjesa më e madhe e pagesave vendore të BQK-së janë kryer në emër të dhe për llogari të Thesarit¹⁵.

Figura 87. Vëllimi i transaksioneve vendore shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2014)


Figura 88. Vlera e transaksioneve vendore shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Si pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë në Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN), BQK-ja ka dërguar dhe ka pranuar urdhërpagesat vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve të saj. Gjatë vitit 2013, përmes SEKN-së, BQK-ja ka dërguar në emër të klientëve të saj afër 345 mijë urdhërpagesa shkuarëse (një rritje prej 20 përqind krahasuar me vitin paraprak) dhe ka pranuar për llogari të tyre afër 104.8 mijë urdhërpagesa ardhëse (një rritje prej 8.5 përqind krahasuar me vitin paraprak).

Figura 89. Vëllimi i transaksioneve vendore ardhëse, numri



Burimi: BQK (2014)

Figura 90. Vlera e transaksioneve vendore ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Shprehur në vlerë, urdhërpagesat shkuarëse në vitin 2013 arritën mbi 973 milionë euro (një zvogëlim prej 21.1 përqind krahasuar me vitin paraprak) dhe urdhërpagesat ardhëse arritën mbi 1.55 miliardë euro (një zvogëlim prej 0.9 përqind krahasuar me vitin paraprak). BQK-ja ka mbetur, sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve, pjesëmarrësi më i madh në SEKN.

¹⁵ Thesari – Ministria e Financave.

Kur flitet për transaksionet e pagesave vendore, duhet theksuar se të gjitha bankat komerciale i gjenerojnë vetë ato si pjesëmarrëse në SEKN, kurse institucionet e sigurimit numrin më të madh të pagesave të tyre e kryejnë nëpërmes bankave komerciale. Në të vërtetë, të gjithë llogarimbajtësit e tjerë të BQK-së i shfrytëzojnë shërbimet e pagesave të ofruara nga BQK-ja në mënyrë të kufizuar, pasi që të gjithë ata kanë llogari në banka komerciale.


Sa u përket transaksioneve ndërkombëtare, në vitin 2013, numri më i madh i tyre u krye nga BQK-ja me urdhër të Thesarit. Në anën tjetër, duke marrë për bazë vlerën e tyre, pjesa më e madhe e transaksioneve

Figura 91. Evoluimi i depozitave të klientëve kryesorë të BQK-së, milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 92. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, numri



Burimi: BQK (2014)


Figura 93. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare ardhëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


ndërkombëtare të kryera nga BQK-ja kanë të bëjnë me transferet e fondeve të bankave komerciale. Të dhënat vjetore për pesë vitet e fundit mbi transaksionet ndërkombëtare janë të paraqitura në katër figurat në vijim.

Figura 94. Vëllimi i transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, numri



Burimi: BQK (2014)

Figura 95. Vlera e transaksioneve ndërkombëtare shkuarëse, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Më 31 dhjetor 2013, depozitat e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës arritën shumën prej 206.8 milionë euro, ndërsa ato të AKP-së arritën shumën prej 550.3 milionë euro.

Në mesin e llogarimbajtësve të tjerë, bankat komerciale dhe institucionet e sigurimit janë më të rëndësishmit sa i përket nivelit të depozitave në BQK. Depozitat e bankave komerciale dhe

institucioneve të sigurimeve që mbahen në BQK kryesisht kanë të bëjnë me obligimet e tyre rregullatore. Ato përbënin 22.5 përqind të gjithsej depozitave që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2013. Më 31 dhjetor 2013, depozitat e bankave komerciale dhe institucioneve të sigurimit ishin në shumën prej 332.8 milionë euro. Niveli i depozitave të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) të mbajtura në BQK u rrit në masë të konsiderueshme gjatë vitit 2013.

Tabela 15. Niveli i depozitave sipas llojeve të llogarive (në milionë euro)

Llojet e llogarive	2009	2010	2011	2012	2013
I. Llogaritë rrjedhëse	959.0	441.8	677.9	1,146.4	1,266.8
Agjencia Kosovare e Privatizimit	451.0	65.1	265.3	549.4	530.3
Institucionet Qeveritare	88.2	48.8	89.3	73.7	12.9
Bankat Komerciale	233.2	203.6	209.7	302.1	327.8
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	53.1	77.0	73.4	169.3	156.5
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	123.1	38.1	21.0	27.3	209.7
FSDK + Të tjera	1.7	1.7	10.8	19.1	24.3
Kompanitë e Sigurimeve	7.7	5.8	7.7	5.0	5.0
Institucionet Ndërkombëtare (UNMIK, EULEX etj)	0.8	1.7	0.7	0.4	0.3
Fondet Pensionale Suplementare	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II. Depozitat e afatizuar	125.0	597.1	425.5	152.0	133.0
Agjencia Kosovare e Privatizimit	0.0	457.1	320.5	0.0	20.0
Institucionet Qeveritare	125.0	140.0	105.0	152.0	113.0
Bankat Komerciale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet Ndërkombëtare (FMN, BB)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TKPK + Institucionet Publike (PTK, KEK, etj)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
FSDK + Të tjera	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kompanitë e Sigurimeve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Institucionet Ndërkombëtare (UNMIK, EULEX etj)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Fondet Pensionale Suplementare	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
III. Letrat me vlerë të qeverisë	0.0	84.7	0.0	46.0	81.0
Institucionet Qeveritare	0.0	84.7	0.0	46.0	81.0
Gjithsejt gjendja	1,084.0	1,123.6	1,103.4	1,344.4	1,480.8

Burimi: BQK (2014)

Këto depozita përbënë rreth 14.16 për qind të gjithsej depozitave, që u mbajtën në BQK gjatë vitit 2013 dhe në fund të vitit arritën shumën prej 209,647 milionë euro.

5.3. Sistemi i Pagesave

Një prej funksioneve parësore të BQK-së është funksionimi i një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave ndërbankare në vend, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare.

Gjatë vitit 2013, Sistemi Ndërbankar i Pagesave është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë ndëroperues, duke realizuar kliringun dhe shlyerjet me kohë dhe në pajtim me standardet dhe procedurat përkatëse. Po ashtu, Regjistri i Poseduesve të Llogarive Bankare ka funksionuar mirë dhe kemi bërë progres në përmirësimin e aplikacionit dhe rritjen e qasjeve të përdoruesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke përfshirë të gjitha degët në vend.

Një ndër aktivitetet me rëndësi në fushën e sistemeve të pagesave gjatë vitit 2013 ishte miratimi i Ligjit për Sistem të Pagesave, si dhe rishikimi dhe harmonizimi i rregullativës përcjellëse, duke përforcuar kompetencat mbikëqyrëse të sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregut në industrinë bankare. E arritur tjetër me rëndësi është edhe realizimi i projektit të pagave për shërbyesit e administratës publike dhe projektit të pensioneve për të gjitha kategoritë e skemave sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

5.3.1 Operimi i Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar

Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), i cili aktualisht është sistem i vetëm ndërbankar i pagesave në vend, funksionon si një sistem hibrid i cili mundëson procesimin ndër bankar të një sërë instrumentesh të pagesave.

Gjatë vitit 2013 u shënuan rritje në vëllim dhe vlerë të transaksioneve të SEKN-së, u bë avancim i mëtejme i sistemit dhe është funksionalizuar pjesëmarrja e “IS Bank” në SEKN që gjatë këtij viti filloi së operuari në Kosovë.

Figura 96. Numri i transaksioneve në SEKN





Figura 97. Vlera e transaksioneve në SEKN



Gjatë këtij viti, në SEKN janë procesuar rreth 6.8 milionë transaksione me vlerë totale prej afërsisht 6.4 miliardë euro.

Rritja e vazhdueshme në vëllim dhe vlerë të transaksioneve ndërbankare të SEKN-së pasqyron rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besueshmërisë në sistemin bankar. Sikurse viteve të mëparshme, në vitin 2013, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme.

Figura 98. Mesatarja ditore e numrit të transaksioneve në SEKN





Figura 99. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve në SEKN




Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve është rritur për 56.9 përqind dhe vlera e transaksioneve është rritur për 13.28 përqind. Rritja e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Mesatarja ditore e vlerës së transaksioneve të SEKN-së në vitin 2013 ishte 25.9 milionë euro, krahasuar me rreth 22.9 milionë euro në vitin 2012. Ndërsa, mesatarja e transaksioneve ditore të SEKN-së në vitin 2013 ishte afër 27.4 mijë, krahasuar me rreth 17.5 mijë në vitin 2012, që konsiderohet rritje e madhe krahasuar me vitin e kaluar. Nga një këndvështrim më afatgjatë, vërehet se SEKN-ja gjatë këtij viti ka pasur qarkullimin më të lartë që prej fillimit të operimit të sistemit.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numrit të transaksioneve të SEKN-së ishte procesimi i pagave të shërbyesve të administratës publike, si dhe pagesave për kategoritë e skemave sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes SEKN-së. Ndërsa, në rritje të vlerës kanë ndikuar kryesisht transaksionet e letrave me vlerë.


Në kuadër të SEKN-së realizohen disa kategori të veçanta të pagesave, si: pagesat e rregullta (individuale dhe masive), pagesa prioritare (individuale dhe masive), Kos-Giro, Debitimi Direkt si dhe shlyerjet e letrave me vlerë. Nivelet e vëllimeve dhe vlerave të këtyre kategorive të pagesave për vitet 2012 dhe 2013 janë të paraqitura në figurat në vijim.

Figura 100. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre (në mijëra)



Burimi: BQK (2014)

Figura 101. Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre (në milionë)



Burimi: BQK (2014)

Pagesat e rregullta (individuale dhe masive) përbëjnë rreth 62.79 për qind të vëllimit dhe rreth 59.84 për qind të vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Transaksionet Kos-Giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Transaksionet Kos-Giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të entiteteve të mëdha faturuese. Gjatë vitit 2013 numri i pagesave Kos-Giro është rritur për 27.4 përqind, ndërsa vlera e tyre shënoi rritje prej rreth 1 përqind.

Transaksionet prioritare (urgjente) procesohen dhe shlyhen menjëherë gjatë orarit të punës në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2013, sa i përket vëllimit, ato përfaqësuan më pak se 1 përqind të transaksioneve, ndërsa sa i përket vlerës, ato përfaqësuan mbi 11.94 përqind të transaksioneve. Ky lloj vazhdon të përdoret kryesisht për kryerjen e pagesave urgjente dhe të atyre me vlera më të mëdha.

Debitimi Direkt si instrument dhe skemë e re e pagesave në Kosovë ende nuk është duke u përdorur në atë masë sa mënyrat tjera të pagesave, kështu që, gjatë vitit 2013, ky lloj i transaksioneve përfaqësonte në total më pak se 1 përqind të vëllimit dhe vlerës së transaksioneve të SEKN-së.

Referuar vlerës së përgjithshme të transaksioneve të shlyera në SEKN, gjatë vitit 2013 vlera e përgjithshme ka qenë 6,435,180,448 €, ku tri institucionet e para me vlerë më të madhe të transfereve të iniciuara zënë 65.46 përqind të vlerës së përgjithshme, ndërsa të gjitha institucionet tjera zënë 34.54 përqind. Sa i përket numrit të transfereve të iniciuara, nga numri i përgjithshëm i tyre 6,793,431, tri institucionet e para me numër më të madh të transfereve të iniciuara zënë 56.10 përqind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjithë institucionet tjera zënë 43.9 përqind. Një pasqyrë e detajuar e treguesve të përqendrimit të pjesëmarrjes së

institucioneve më aktive në SEKN gjatë vitit 2013, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem, është paraqitur në tabelën 16.

Tabela 16. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e iniciuara/dërguara në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
3 banka	56.10%	65.46%
6 bankat tjera	43.90%	34.54%
Gjithsejt	6,793,431	6,435,180,448

Burimi: BQK (2014)

Sa i përket transfereve të pranuar, tri institucionet me vlera më të mëdha të transfereve të pranuar zënë 67.14 përqind të shumës së përgjithshme, ndërsa gjithë institucionet tjera zënë 32.86 përqind. Ndërsa nga numri i përgjithshëm i transfereve të pranuar, tri institucionet e para zënë 72.58 përqind të numrit të përgjithshëm, ndërsa të gjitha institucionet tjera 27.42 përqind. Thesari në Ministrinë e Financave është ndër pjesëmarrësit më të mëdhenj për transaksionet e pranuar nga SEKN (3,475,529 transaksione me vlerë prej 1,554,602,575.06 Euro) duke përbërë rreth 51 përqind të numrit dhe 27 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve të pranuar (tabela 17).

Tabela 17. Treguesit e përqendrimit për transaksionet e pranuar/hyrëse në SEKN

Sistemi SEKN	Vëllimi	Vlera
3 banka	72.58%	67.14%
6 bankat tjera	27.42%	32.86%
Gjithsejt	6,793,431	6,435,180,448

Burimi: BQK (2014)

5.3.2 Mbikëqyrja, analizat dhe zhvillimet e sistemeve të pagesave

Legjislacioni mbi funksionimin e sistemit të pagesave në Kosovë autorizon DSP-në për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave për të siguruar efikasitetin dhe besueshmërinë e këtij sistemi dhe pajtueshmërinë e tij me dispozitat ligjore, ruajtjen e besimit të publikut në sistemin dhe instrumentet e pagesave dhe promovimin e konkurrencës së lirë në tregun e shërbimeve të pagesave.

Në kuadër të fushës së mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, DSP ka themeluar dhe zhvilluar funksionin përkatës në linjë me parimet dhe standardet ndërkombëtare, janë bërë publikime të rregullta të treguesve analitikë për instrumente të pagesave në Kosovë. Po ashtu, gjatë këtij viti janë kryer inspektime të rregullta në banka me qëllim monitorimin e procesimit të pagesave sipas procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore.

Sa i përket fushës së analizave në kuadër të sistemeve të pagesave, ka vazhduar publikimi i analizave të rregullta rreth zhvillimeve të sistemeve të pagesave, si dhe materialeve tjera informative me karakter edukimi financiar për publikun. Gjatë këtij viti janë publikuar këto analiza dhe materiale informative:

- Analiza mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë (në baza tremujore);
- Analizë mbi mënyrat e dërgimit të remitancave në Kosovë;
- Analizimin e zhvillimeve të skemës së pagesave Kos-Giro dhe e Debitimit Direkt.
- Raporte krahasuese mes Kosovës dhe vendeve në rajon mbi zhvillimet e infrastrukturës së sistemeve të pagesave.
- Broshura informative për Sistemin e Pagesave në Kosovë


- Broshura informative dhe fletushka për para elektronike
- Fletushka për përdorim të kartelave bankare, etj.

Në kuadër të përmirësimeve të rregullativës së sistemit të pagesave është bërë zëvendësimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/26 mbi Transaksionet e Pagesave me Ligjin për Sistemin e Pagesave të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 24 prill, 2013. Në këtë kuadër janë rishikuar, përshtatur dhe miratuar këto rregullore: a) Rregullore për Kliringun dhe Funkcionimin e Llogarive për Shlyerje, b) Rregullore për Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar si dhe Udhëzimi Operacional për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare.

5.3.3 Instrumentet e pagesave dhe infrastruktura bankare për shërbime të pagesave


Sa u përket instrumenteve të pagesave dhe infrastrukturës bankare të shërbimeve të pagesave, vlen të theksohet se paraqitet një zhvillim i qëndrueshëm, i prirë me rritje dhe zgjerim si në aplikim të teknologjive inovative ashtu edhe në përdorim të instrumenteve elektronike.

Figura 102. Numri i kartelave të debitit sipas llojit



Burimi: BQK (2014)


Figura 103. Numri i kartelave të kreditit sipas llojit



Burimi: BQK (2014)


Bazuar në metodologjinë për raportimin e instrumenteve të pagesave, bankat komerciale kanë vazhduar raportimin e rregullt të statistikave për instrumente të pagesave në Departamentin e Sistemit të Pagesave në BQK.

Figura 104. Numri i terminaleve ATM



Burimi: BQK (2014)

Figura 105. Numri i terminaleve POS



Burimi: BQK (2014)


Nga të dhënat e mbledhura, përpunuara dhe të analizuara gjatë vitit 2013 është krijuar një pasqyrë e gjerë mbi nivelin e zhvillimit të sistemit kombëtar të pagesave.

Në vazhdimësi, numri i kartelave me funksion pagese është rritur. Rrjeti i terminaleve të bankave në Kosovë po ashtu është në rritje. Në dhjetor të vitit 2013, janë raportuar 645,048

kartela me funksion debiti, 109,332 kartela me funksion krediti dhe 15,017 kartela me parapagim. Këto kartela kanë mundur të përdoren në 496 terminale ATM (bankomat) dhe 9,071 terminale POS (pika të shitjes) të vendosura nëpër Kosovë.


Në krahasim me vitin paraprak, numri i terminaleve ATM është rritur për 2.7 për qind dhe numri i terminaleve POS me 5.6 për qind.

Figura 106. Vëllimi vjetor i transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2014)

Figura 107. Vlera vjetore e transaksioneve të instrumenteve elektronike të pagesave



Burimi: BQK (2014)

Viti 2013 u karakterizua me një tendencë rritëse të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Numri i pagesave e-banking brenda vendit u rrit për 67.05 për qind, ndërsa vlera e tyre u rrit për 76.5 për qind. Numri i pagesave në POS terminale është rritur për 10.5 përqind, ndërsa vlera e tyre është rritur për 8.1 për qind. Po ashtu edhe tërheqjet në ATM terminale u karakterizuan me rritje. Numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2013 është rritur për rreth 4.5 përqind, ndërsa vlera e tërheqjeve është rritur për 7.2 përqind.

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2013, numri i përgjithshëm i llogarive bankare të klientëve ishte rreth 1.85 milion, që paraqet një rritje prej 1.7 përqind krahasuar me fundin e vitit 2012. Rreth 98.62 përqind e llogarive janë të rezidentëve, ndërsa rreth 1.38 përqind janë të jorezidentëve.

Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2013, rreth 131 mijë llogari kishin qasje "online" nga interneti për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, duke shënuar një rritje prej 35.3 për qind në krahasim me vitin 2012.

Tabela 18. Numri i llogarive

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve			Të aksesueshme nga interneti		
	2011	2012	2013	2011	2012	2013
Llogaritë e klientëve (1+2)	2,059,878	1,824,266	1,855,383	68,990	97,089	131,365
1-Llogari të rezidentëve (a+b)(%)	98.34%	98.40%	98.62%	94.80%	97.00%	97.10%
a-Individuale (%)	94.36%	93.20%	93.25%	80.00%	78.70%	80.11%
b-Kompani (%)	5.63%	6.80%	6.75%	20.00%	21.30%	19.89%
2-Llogari të jo-rezidentëve (c+d) (%)	1.66%	1.60%	1.38%	5.20%	3.00%	2.90%
c-Individuale (%)	96.60%	96.50%	96.35%	90.80%	94.90%	92.50%
d-Kompani (%)	3.40%	3.50%	3.95%	9.20%	5.10%	7.50%

Burimi: BQK (2014), raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave"

Bazuar në të dhënat statistikore, zhvillimi i infrastrukturës ka një ritëm më të shpejtë krahasuar me vendet e regjionit. Inkurajues mbetet trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Sa i përket krahasimit të Kosovës me vendet në rajon, shihet se trendi i shpejtë i zhvillimit gjatë viteve të fundit ka ndikuar, që sot Kosova të ketë përmirësuar pozitën e saj krahasuar me vendet fqinje.

Tabela 19. Tabela krahasuese e instrumenteve dhe terminaleve të pagesave¹⁶

Përshkrimi	Banorë	ATM për milion banorë	POS për milion banorë	Kredit Kartelat për milion banorë	Debit Kartelat për milion banorë	E-Banking për milion banorë
Kosova	1.79	270	4,800	53,599	335,001	54,240
Shqipëria	2.8	294	1,895	17,562	257,075	19,616
Republika Çeke	10.51	391	10,345	179,076	787,777	-
Turqia	74.72	486	28,566	727,277	1,221,400	-
Slovenia	2.06	868	18,770	54,394	1,227,509	-
Bullgaria	7.38	768	8,544	129,781	929,331	-
Hungaria	9.93	483	9,617	126,495	773,156	-
Bosnja	3.84	334	5,031	52,830	394,223	25,011
Mali i Zi	0.62	502	16,340	82,092	489,726	56,147
Kroacia	4.39	930	20.6	36,727	1,518,145	-
Maqedonia	2.06	414	16,149	143,600	561,438	189,185

Burimi: BQK (2014) dhe bankat qendrore apo autoritetet mbikëqyrëse të shteteve përkatëse

Numri i terminaleve dhe instrumenteve të pagesave, si dhe përdorimi i tyre në Kosovë ka shënuar rritje dhe ka tejkaluar disa vende fqinje.


5.4. Menaxhimi i Mjeteve

Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve është përgjegjës për plasmanin e mjeteve financiare nën menaxhim të BQK-së, si dhe për operimin e sistemit qendror depozitar dhe platformës elektronike për tregtimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Mjetet e depozituara në BQK u takojnë kryesisht institucioneve qeveritare si Ministria e Financave, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si dhe institucioneve financiare (rezervat e obligueshme për likuiditet).

5.4.2 Menaxhimi i Investimeve


Sipas Politikës së Investimeve të BQK-së, objektivat kryesore të përcaktuara gjatë menaxhimit të mjeteve janë: siguria, likuiditeti dhe kthimi në investime. Në pajtim me këtë politikë, gjatë vitit 2013, të gjitha mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë investuar në instrumente financiare. që hyjnë në kategorinë e instrumenteve të sigurta dhe likuide.

Figura 108. Raporti i shpërndarjes së investimeve të portofolit të BQK-së



Burimi: BQK (2014)

Figura 109. Shuma e përgjithshme e mjeteve në portofolion e investimeve e shprehur në milion euro në çdo fundvit



Burimi: BQK(2014)

¹⁶ Të dhënat në tabelë janë nga viti 2012 pasi që shumica e vendeve në rajon të dhënat për vitin 2013 nuk i kanë publikuar ende.

Kategoritë e instrumenteve financiare në të cilat janë investuar mjetet nën menaxhimin e BQK-së janë:

- depozitat e afatizuara bankare me afat maturimi deri në një vit të përcaktuar sipas Politikës së Investimeve të BQK-së dhe në institucione financiare me rangim/vlerësim kreditor superior, përkatësisht euro-depozita bankare të afatizuara me banka komerciale dhe qendrore të shteteve më kredibile të Eurozonës dhe

- bonot e Thesarit të shteteve më të zhvilluara të Eurozonës me afat maturimi deri në një vit të emetuara në valutën euro.

Figura 108 paraqet raportin e shpërndarjes së mjeteve në portofolion e BQK-së, ku investimet në letrat me vlerë ishin relativisht të ulëta në fillim të vitit ku në muajin janar kemi pjesëmarrjen prej 24.67% nga portfolio e përgjithshme.


Me përmirësimin e kushteve për investime në tregun e letrave me vlerë të shteteve të Eurozonës, kjo pjesëmarrje ka shënuar rritje ku pika maksimale e përqendrimit të investimeve në këtë kategori të investimit të mjeteve financiare në raport me totalin e portfolios së BQK-së arrihet në muajin shtator prej 51.18%.

Rrjedhimisht trendi në plasmanin e investimeve në banka komerciale ka shënuar rënie në mesatare me qëllim të ngritjes së sigurisë, likuiditetit dhe kthimit në investime. Letrat me vlerë të emetuara nga shtetet e Eurozonës, janë instrumentet më likuide të cilat kanë shënuar njëkohësisht kthim më të lartë në portfolion e BQK-së nga investimet përgjatë vitit 2013.

Viti 2013 u karakterizua si vit i rritjes për mjetet totale në portfolion e investimeve të BQK-së. figura 109 tregon rritjen e mjeteve të investuara nga ana e BQK-së sipas gjendjes së tyre më 31 dhjetor të viteve përkatëse.


Në figurën 110 pasqyrohet portfolio investuese sipas kategorive të instrumenteve financiare për vitin 2013 krahasuar me vitet paraprake, ku vërehet pjesëmarrja më e madhe në investimin e

Figura 110. Shpërndarja e portfolios investuese në çdo fundvit




Burimi: BQK(2014)

Figura 111. Lëvizja e normave në tregun ndër-bankar të Eurozonës dhe lëvizja e normave në depozita të investuara nga BQK



Burimi: BQK (2014)

Figura 112. Norma e kthimit të investimeve në portfolio dhe rreziku për dy periudhat gjashtëmujore të vitit 2012



Burimi: BQK(2014)

mjeteve në letrat me vlerë dhe një shpërndarje më e barabartë nëpër kategoritë e instrumenteve financiare.

5.4.2.1 Performanca e portfolios për vitin 2013

Viti 2013 është karakterizuar si vit i vazhimit të krizës së borxheve në Eurozonë. Banka Qendrore Evropiane (BQE) bëri uljen e normës kryesore të huadhënies dhe normës së operacioneve të refinancimit dy herë gjatë këtij viti. Kjo ndikoi drejtpërdrejt në zvogëlimin e normave të interesit në tregun

ndërbankar të Eurozonës.

Figura 111 paraqet lëvizjen e kthimeve nga investimet në portfolion e BQK-së në raport me tregun ndërbankar të Eurozonës, respektivisht normën EURIBOR 2 –javor (Norma Mesatare e Huadhënies ndërbankare për valutën Euro) e cila konsiderohet normë referuese për depozitat e afatizuara bankare të BQK-së në bankat qendrore dhe komerciale të shteteve të Eurozonës.

Figura 113 paraqet kthimin më të favorshëm në investimet në letrat me vlerë krahasuar me depozitat bankare, e cila vërehet për dy periudhat gjashtëmuajore të vitit 2013.

Investimet në letra me vlerë siç pasqyrohen në figurën 113 investohen në periudha më të gjata krahasuar me investimet në depozita bankare. Pavarësisht këtij fakti, mesatarja e ditëve deri në maturim për letrat me vlerë mbetet e ulët, respektivisht 75 ditë. Kjo nënkupton që i është kushtuar rëndësi e veçantë edhe likuiditetit që është objektiv primar i Politikës së Investimeve të BQK-së.


5.4.2 Menaxhimi i Rrezikut

Investimet bëhen në letrat me vlerë të emetuara nga shtetet më kredibile të Eurozonës dhe në institucionet bankare me vlerësim kreditor superior sipas vlerësimeve nga Agjencitë Kreditore Ndërkombëtare, Standard&Poor's dhe Moody's.

Rreziqet financiare të cilat menaxhohen gjatë investimit të mjeteve financiare nga ana e BQK-së janë: rreziku kreditor, rreziku i normës së interesit, rreziku i likuiditetit dhe rreziku operacional.

Rreziku kreditor. Të gjitha investimet janë bërë në raport me kriteret e rangimit afatshkurtër kreditor të përcaktuar në Politikën e Investimeve P-2/A-2 (Moody's/S&P) dhe përmes shpërndarjes të investimeve i cili është i


Figura 113. Horizonti kohor mesatar i shprehur në ditë deri në maturim për dy kategoritë e plasmaneve



Burimi: BQK(2014)

e cila vërehet për dy periudhat gjashtëmuajore të vitit 2013.

Figura 114. Shpërndarja e portfolios sipas rangimit kreditor afatshkurtër (S&P)



Burimi: BQK (2014)

përcaktuar sipas limiteve të shprehura në përqindje për shtete dhe institucione bankare. Gjatë vlerësimit të bankave me të cilat bashkëpunon BQK është marrë për bazë niveli i likuiditetit të tyre, kapitali bazë, vlerësimi i aksionarëve si dhe zvogëlimi i depozitave nga klientët e tyre.

Rreziku i normës interesit është matur duke krahasuar normën e kthimit nga investimet në portfolion e BQK-së me normën EURIBOR dyjavor (norma mesatare e huadhënies ndër-bankare për valutën Euro) si normë krahasuese. Devijimi standard nga norma e interesit për vitin 2013 është 0.047% që nënkupton se norma mesatare e interesit varijon për +/- 0.047 përqind që konsiderohet si rrezik minimal.

Rreziku i likuiditetit. Investimet kryesisht janë bërë në bono të Thesarit dhe depozita bankare me afat të shkurtër në raport me nivelin e likuiditetit të përcaktuar sipas Politikës për Investime.

Rreziku operacional. Ky rrezik ekziston në të gjitha aktivitetet dhe mund të rezultojë deri në humbje, si pasojë e gabimeve të personelit apo sistemit elektronik gjatë procesit të realizimit të investimeve. Gjatë vitit 2013, nuk ka pasur asnjë rast të paraqitjes së këtij rreziku gjatë investimit të mjeteve financiare.

5.4.3 Letrat me vlerë

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Borxhet Publike nr. 03/L-175, neni 2, paragrafi 1.1. dhe 1.2. vepron si agjent fiskal për Ministrinë e Financave (MeF) për mbajtjen e ankandeve, regjistrimin, emetimin dhe transferimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

BQK në pajtim me kalendarin për emetimin e letrave me vlerë gjatë vitit 2013 ka mbajtur 21 ankande përmes platformës elektronike. Sipas Rregullores për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë, neni 1 paragrafi 1.26 dhe Neni 7, të gjitha ankandet janë realizuar përmes sistemit të akterëve primarë ku tetë banka komerciale janë të autorizuara të veprojnë si akterë primarë.

Përveç Akterëve Primar, pjesëmarrës në tregun e letrave me vlerë ka qenë edhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës i cili ka dorëzuar ofertat në ankande përmes akterit primar.

Nga 21 ankande të mbajtura gjatë vitit 2013, në 11 prej tyre janë emetuar bono thesari me afat maturimi 91 ditë, në 7 prej tyre me afat maturimi 182 ditë dhe në 3 të tjera me afat maturimi 364 ditë (1 vit). Në figurën 115 paraqitet struktura në përqindje e bonove të Thesarit sipas afatit të maturimit. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ka marrë pjesë në 6 ankande përmes akterit primar, në 3 prej tyre për bono Thesari me afat maturimi prej 182 ditë dhe në 3 të tjera

Figura 115. Struktura e Letrave me Vlerë sipas afateve të maturimit





Figura 116. Struktura e pjesëmarrësve në ankande



me afat maturimi prej 364 ditë. Rrjedhimisht, ky institucion jobankar përbën 18.18% të pjesëmarrjes në tregun e letrave me vlerë gjatë vitit 2013. Në figurën 116 paraqitet struktura e pjesëmarrësve në ankande e shprehur në përqindje sipas gjendjes më 31 dhjetor 2013.

Viti 2013 u karakterizua me emetimin për herë të parë të bonove të Thesarit me afat maturimi prej 364 ditë me normë mesatare të kthimit prej 1.99 përqind. Normat vjetore të kthimit gjatë vitit 2013 kanë shënuar trend të rënies si rezultat i rritjes së kërkesës për pjesëmarrje në këto ankande. Norma mesatare vjetore e kthimit për bonot e thesarit me afat maturimi 91 ditë në vitin 2013 ka shënuar rënie në 0.57 përqind prej 2.52 përqind sa ishte në vitin 2012 dhe për bonot e Thesarit me afat maturimi 182 ditë në 1.27 përqind, nga 2.71 përqind sa ishte në vitin 2012. Norma mesatare vjetore e kthimit për të gjitha bonot e Thesarit në vitin 2013 ka qenë 1.01 përqind krahasuar me 2.55 përqind sa ishte në vitin 2012. Në figurën 117 paraqiten normat mesatare vjetore të kthimit më datën 31 dhjetor të viteve përkatëse.


Gjatë vitit 2013 të gjitha ankandet janë realizuar me sukses pasi që shumatat e ofertuara vazhdimisht kanë tejkaluar pothuajse për dy herë shumatat e emetuara nga MeF. Në figurën 118 janë paraqitur të gjitha ankandet e mbajtura në vitin 2013 ku vërehet një interesim i shtuar nga ana e akterëve primarë për pjesëmarrjen e tyre në të gjitha ankandet e veçanërisht në ato për bono Thesari me afat maturimi prej 182 dhe 364 ditë.

Gjatë vitit 2013 BQK-ja, ka krijuar kushtet e duhura për zhvillimin e tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu, gjatë vitit 2014 është planifikuar emetimi i fletëobligacioneve qeveritare me afat maturimi më të gjatë se një vit.

5.5. Regjistri i Kredive të Kosovës


Funksioni dhe roli i Regjistrimit të Kredive është i bazuar në platformën mbi infrastrukturën financiare. Kështu, me qëllim të arritjes së objektivave sipas

Figura 117. Normat mesatare vjetore të kthimit për vitin 2012 dhe 2013, në përqindje




Burimi: BQK(2014)

Figura 118. Ankandet e Bonove të Thesarit



Burimi: BQK (2014)

Figura 119. Numri i përdoruesve të regjistruar



Burimi: BQK (2014)

praktikave më të mira në fushën e raportimeve kreditore, që nga 3 janari 2006, BQK-ja ka vërë në funksion sistemin e Regjistrimit të Kredive (RKK).

Regjistri i Kredive mbledh dhe shpërndan informatat mbi gjendjen kreditore të personave fizikë dhe juridikë, me qëllim të përmirësimit të procesit vlerësues të klientëve kreditorë si dhe për të përkrahur funksionin mbikëqyrës të Bankës Qendrore.

RKK-ja ka të dizajnuar aplikacionin e bazuar në internet me qasje të drejtpërdrejtë në kohë reale nga institucionet financiare anëtare të sistemit të RKK-së, si dhe portalin për qytetarë (www.raportikreditor.org), ku

çdo subjekt i të dhënave ka mundësi për t'u pajisur me raport kreditor. Gjithashtu përmes këtij portali, ofrohen udhëzime të nevojshme të fokusuara në edukimin financiar të qytetarëve, të cilat ndikojnë në ngritjen e njohurive mbi obligimet dhe përgjegjësitë e kredimarrësve.


Në bazë të rregullores së Regjistrimit të Kredive, anëtare të sistemit të RKK-së, janë të gjitha institucionet financiare të përcaktuara nga Banka Qendrore për të qenë ofrues të kredive, duke përfshirë të gjitha bankat dhe institucionet mikrofinanciare të licencuara, si dhe ato institucione financiare jobankare dhe kompani të sigurimeve të licencuara për t'u marrë me aktivitete të veçanta kreditore. Aktualisht janë mbi 1000 përdorues aktiv në sistemin e Regjistrimit të Kredive. Gjatë vitit 2013, Regjistri i Kredive ka regjistruar 385 përdorues të ri si rrjedhojë e kërkesave të paraqitura nga institucionet anëtare (figura 119).

Përdoruesit e sistemit të Regjistrimit të Kredive, të cilët janë të autorizuar nga institucionet kredidhënëse, i qasen sistemit me qëllim të hulumtimit mbi obligimet dhe historitë kreditore të aplikantëve kreditorë. Sipas statistikave që dalin nga sistemi i Regjistrimit të Kredive, numri i hulumtimeve gjatë vitit 2013 kap shifrën prej 623,334 hulumtime (figura 120).

Sipas Rregullës për Regjistrimin e Kredive


dhe mbështetur në sistemin e zhvilluar të RKK-së, të gjitha institucionet kredidhënëse, anëtare të sistemit të Regjistrimit të Kredive janë të obliguara, që të raportojnë informacionet mbi kreditë e

Figura 120. Numri i hulumtimeve në sistemin e RKK-së




Burimi: BQK (2014)

Figura 121. Numri i kredive të reja



Burimi: BQK (2014)

Figura 122. Struktura e kredive sipas klasifikimit



Burimi: BQK (2014)

aprovuara dhe të shpërndara. Gjatë vitit 2013 nga ana e institucioneve kredidhënëse, në sistemin e Regjistrit të Kredive janë raportuar 191,676 kredi të reja (figura 121).


Raportimi i Kredive nga institucionet anëtare në sistemin e RKK-së, klasifikohen në bazë të Rregulloreve të BQK-së për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor dhe pastaj të klasifikuara raportohen në baza mujore në sistemin e RKK-së. Në figurën 122, 123 dhe 124 janë paraqitur ekspozimet kreditore në bazë të klasifikimeve të raportuara në sistemin e RKK-së për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

Në Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK), si subjekt i të dhënave paraqitet çdo person fizik dhe juridik që ndërmerr një obligim kredie. Obligim kredie nënkuptohet çdo hua, kredit kartelë, garancion, lizing ose produkt tjetër me natyrë kreditore. Përpos rolit si kredimarrës subjektet e të dhënave mund të paraqiten edhe si bashkëkredimarrës, garantues, apo edhe si aksionar dhe drejtor të entitetit juridik të cilit i lëshohet obligimi kreditor.

Bazuar në Rregulloren e Regjistrit të Kredive si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të kontrollimit të informacioneve vetanake, çdo kredimarrës mund të marrë raportin kreditor. Kjo mundësohet nga secila bankë apo edhe drejtpërdrejt nga Banka Qendrore e Kosovës. Figura 125 paraqet numrin e raporteve të marrura nga kredimarrësit.


Edhe në vitin 2013, Regjistri i Kredive ka kontribuar drejtpërsëdrejti në raportin Të Bërit Biznes (Doing Business) të Bankës Botërore, i cili krahason praktikat rregullative në 189 ekonomi në të gjithë botën. Kontributi i regjistrit të kredive është i ndërlidhur me indikatorin mbi kreditë (getting credit) dhe në bazë të raporteve të publikuara në katër vitet e fundit nga Banka Botërore, ky indikator për Republikën e Kosovës vazhdimisht është duke u vlerësuar si më pozitiv nga të gjithë indikatorët tjerë.

Figura 123. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve




Burimi: BQK (2014)

Figura 124. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 125. Numri i i kërkesave për raporte kreditore



Burimi: BQK (2014)

Përcjellja e trendeve zhvillimore (globale dhe rajonale) në fushën e raportimeve kreditore është pjesë e pandashme e punëve dhe aktiviteteve të cilat zhvillohen në Divizionin e Regjistrimit të Kredive (DRK). Këto aktivitete ndërlidhen edhe me hulumtimet mbi mundësitë integruese në organizma evropian. Që nga viti 2010, Regjistri i Kredive është anëtarë e plotë në Asociacionin Evropian mbi raportimet kreditore – ACCIS. Kështu, edhe gjatë vitit 2013, DRK-ja ka marrë pjesë në konferencën vjetore në nivel evropian, si dhe në takime të grupeve profesionale të organizuara nga ky asociacion. Pjesëmarrja në këto ngjarje ishte rast që DRK-ja nga afër të prezantojë Regjistrin e Kredive në nivele ndërkombëtare, si dhe të informohet me praktikën më të mira dhe të arriturat e fundit mbi zhvillimet në fushën e raportimeve kreditore.

5.6. Aktiviteti në fushën e analizave ekonomike dhe stabilitetit financiar

Gjatë vitit 2013 BQK-ja ka vazhduar të ofrojë analiza rreth zhvillimeve ekonomike në vend, duke përfshirë analizat e zhvillimeve makroekonomike dhe të stabilitetit financiar. BQK-ja ka publikuar edhe numrin 4 të Raportit të Stabilitetit Financiar, i cili paraqet një analizë gjithëpërfshirëse mbi stabilitetin financiar. Progres është shënuar edhe në hartimin e Raportit të Bilancit të Pagesave, i cili prezanton një pasqyrë të detajizuar të zhvillimeve në bilancin e pagesave të Kosovës. Përveç kësaj, në Raportin e Bilancit të Pagesave gjatë vitit 2013 janë publikuar analiza e karakterit kërkimor mbi përcaktuesit e IHD-ve në vendet e EJL-së, si dhe punimi mbi financimin e tregtisë. Që nga viti 2013, BQK-ja ka avancuar raportin e saj mbi Vlerësimin Tremujor të Ekonomisë duke e publikuar si material të veçantë. Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar avancimi edhe në segmentet tjera të vlerësimit të stabilitetit financiar siç janë stres-testi për sektorin bankar, treguesit e paralajmërimit të hershëm, modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike, si dhe analizat tjera për përdorim të brendshëm. Gjatë vitit 2013, BQK ka vazhduar të realizojë në baza tremujore Anketën e Kreditimit Bankar me bankat që operojnë në Kosovë. Gjatë këtij viti, BQK-ja po ashtu ka marrë përsipër përpilimin e analizës mbi ngarkueshmërinë me borxh të kredimarrësve në Kosovë.

Për vitin 2014, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar të BQK-së planifikon të rrisë frekuencën e publikimit të Raportit të Stabilitetit Financiar, si dhe të shtojë numrin e publikimeve rreth zhvillimeve makroekonomike në vend.

5.7. Aktivitetet në fushën e statistikave

Gjatë vitit 2013, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka bërë hapa të rëndësishëm në avancimin e mëtutjeshëm të sistemit statistikor në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare. Funkzioni statistikor është avancuar me përmirësimin e bazës ligjore për mbledhjen e informatave, rritjen e mbulueshmërisë me informata të reja nga institucionet raportuese, zgjerimin e gamës së statistikave të publikuara, diseminimin e më shumë statistikave në FMN dhe Bankë Botërore, implementimin e metodologjisë së re ndërkombëtare, harmonizimin e statistikave sipas *acquis comunitare* dhe me avancim të sistemit të përpunimit të të dhënave. Edhe gjatë vitit 2013, Departamenti i Statistikës i BQK-së ka vazhduar të ofrojë një gamë të gjerë me të dhëna për sektorin financiar dhe sektorin e jashtëm.

BQK në përpjekje për të përmirësuar kornizën ligjore me të cilën sqarohet përgjegjësia për grumbullimin e të dhënave statistikore për të plotësuar mandatin e saj sipas nenit 25-28 të Ligjit për BQK-në, ka amendamentuar bazën ligjore për statistikën e sektorit të jashtëm. *Rregullorja mbi statistikën e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare* është plotësuar në dhjetor 2013, duke specifikuar në detaje përgjegjësitë e raportuesve që duhet të raportojnë në BQK dhe informatat (format) të cilat duhet të plotësohen.

Në përpjekje për të përmirësuar kualitetin e statistikave, BQK ka bërë rritjen e mbulueshmërisë me informata të reja nga institucionet raportuese dhe ka futur në raportim korporata të tjera

jofinanciare. Kryesisht janë ftuar për raportim korporata me pronësi të huaj, të dhënat e të cilave janë të nevojshme për përpilimin e statistikave të investimeve të huaja direkte në Kosovë dhe borxhit të jashtëm. Në 2013 është lansuar një version i korrigjuar i anketës për ndërmarrjet.

Vitin e kaluar, Departamenti i Statistikës ka zgjeruar gamën e publikimeve duke ofruar informata të reja për institucionet mikrofinanciare, institucionet që merren me lizing si dhe agjencitë për transferimin e parave. Tabelat e reja ofrojnë të dhëna për bilancin e gjendjes, kreditë sipas sektorëve institucionalë, sektorëve ekonomikë, lizingun, kreditë e reja të lëshuara brenda muajit, normat efektive të interesit në kredi dhe pasqyrat e bilancit të suksesit. Këto statistika janë në përputhshmëri të plotë me standardet statistikore ndërkombëtare të FMN-së, Bankës Qendrore Evropiane, Eurostatit dhe institucioneve tjera relevante.

Publikimi i statistikave të rregullta, përfshirë edhe statistikat e reja që DS ka publikuar për herë të parë është bërë në baza të rregullta në *Buletin Mujor Statistikor* dhe në kuadër të *Serive Kohore në FMN dhe Bankë Botërore*. Kërkesa për informata të reja është duke u rritur, posaçërisht për normat e interesit në kredi dhe depozitë. BQK-ja ka bërë një avancim në sistemin e procesimit të këtyre të dhënave dhe gjatë vitit 2014 pritet të publikohen më shumë informata për normat e interesit në kredi dhe depozitë.

Gjatë vitit 2013, publikimi i statistikave në kuadër të *Serive Kohore* është dyfishuar me publikimin e të gjitha tabelave edhe në gjuhën shqipe dhe serbe. Më parë, në kuadër të *Serive Kohore* kanë qenë të publikuara vetëm në gjuhën angleze. Në *Buletin Mujor Statistikor* tabelat kanë qenë të publikuara në gjuhën shqipe, mirëpo me një format të reduktuar dhe në verzionin pdf. Në kuadër të *Serive Kohore*, tabelat e publikuara janë në formatin MS Excel në gjuhën shqip, serbe dhe angleze.

Bashkëpunimi me *FMN-në*, *Eurostatin* dhe institucionet vendore ka vazhduar. BQK-ja është koordinator e vendit për Sistemin e Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (angl. General Data Dissemination System - GDDS) të FMN-së. Të dhënat për indikatorët kryesorë të Kosovës janë publikuar sipas afateve të parapara (mujore, tremujore, dhe vjetore) në kuadër të faqes së BQK-së. Bashkëpunimi ka vazhduar edhe me Eurostatin. BQK-ja ka marrë pjesë në takimet e rregullta të *Komitetit për Statistikat Monetare, Financiare dhe Statistikat e Bilancit të Pagesave* që mbahet në Eurostat (Luksemburg). Të dhënat e kërkuara nga Eurostatit për sektorin financiar dhe sektorin me jashtë janë dërguar në Eurostat sipas kërkesave të parashtruara. BQK ka thelluar bashkëpunimin me Eurostatin me qëllim të harmonizimit të metodologjisë sipas vendeve të Bashkimit Evropian. Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, BQK-ja është anëtare e Këshillit Statistikor të Kosovës i cili është organ kolegjal për të dhënë këshilla për përgatitjen dhe zbatimin e programit të statistikave zyrtare të Kosovës dhe për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit statistikor të Kosovës. Në përgjithësi, BQK-ja ka një bashkëpunim shumë të mirë me prodhuesit zyrtarë të statistikave në Kosovë, bankat qendrore të vendeve fqinje dhe me institucionet ndërkombëtare.

Puna gjithashtu ka vazhduar me zvillimin e një softueri të ri për procesimin e statistikave të sektorit të jashtëm. Softueri për statistikat e sektorit me jashtë rrit profesionalizmin në punë duke mundësuar importimin, procesimin, ruajtjen dhe nxjerrjen e të statistikave në mënyrë efikase. Sistemi i mëhershëm ka qenë kryesisht i bazuar në MS Excel. Sistemi i ri do të shërbejë si përkrahje e konsiderueshme në rritjen e profesionalizmit, duke pasur parasysh volumin gjithnjë në rritje të statistikave të prodhuara karshi resurseve të limituara dhe afateve të publikimit. Për më shumë, ky softuer e lehtëson shumë punën për të plotësuar kërkesat për raportim në Eurostat të cilat janë shumë të detajizuara (psh. të dhënat sipas shteteve, instrumentave financiarë, aktiviteteve ekonomike dhe në *Seri Kohore*). BQK-ja në bashkëpunim me Bankën Botërore është duke dizajnuar një softuer të ri, i cili do të përdoret nga disa departamente të ndryshme. Në kuadër të këtij projekti është paraparë që disa softuerë aktualë

të inkorporohen në këtë softuer. Me këtë do të rritet mundësia për të kontrolluar konsistencën në të dhëna të ndryshme por edhe për të kursyer nga shërbimet e mirëmbajtjes.

Për nga aspekti i metodologjisë, BQK ka bërë një avancim të rëndësishëm në procesin e implementimit të standardeve të reja të FMN-së për statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare. FMN në vitin 2009 ka publikuar *Manualin e ri për Bilancin e Pagesave dhe Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare* (anglisht: *Balance of Payments and International Investment Position – 6th Edition -BPM6*). Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian pritet ta implementojnë në vitin 2014. BQK-ja nga shtatori 2013, ka filluar raportimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionin e investimeve ndërkombëtare në FMN sipas metodologjisë së re. Implementimi i plotë, i cili përfshin edhe publikimin e materialeve lidhur me ndryshimet metodologjike do të bëhen në 2014 paralel me vendet e BE-së.

Për më shumë është bërë progres i rëndësishëm në harmonizimin e metodologjisë të statistikave të sektorit me jashtë sipas Eurostatit (*acquis* komunitar). Fillimi i raportimit të rregullt ashtu siç e bëjnë vendet e Bashkimit Evropian është një nga objektivat e BQK-së për vitin 2014 për statistikave të bilancit të pagesave, të tregtisë së jashtme në shërbime, të investimeve të huaja direkte dhe ato të pozicionin të investimeve ndërkombëtare.

Publikimi i rregullt, periodik dhe me kohë i statistikave paraqet një atribut të veçantë të Departamentit të Statistikës të BQK-së. Përkundër rritjes së gamës së statistikave të prodhuara në njërin anë dhe numrit të njëjtë të resurseve në anën tjetër është arritur, që publikimi i statistikave të bëhet konform afateve të specifikuara në ueb-faqen e BQK-së. *Seritë Kohore* dhe *Buletini Mujo Statistikor* (edicioni i dhjetorit 2013 paraqet edicionin numër 148) paraqesin publikimet statistikore kryesore të BQK-së. Përveç tyre, statistikave të prodhuara nga Departamenti i Statistikës i BQK-së shërbejnë si informata kyçe edhe për publikimet tjera të BQK-së si: Raporti Vjetor, Raporti i Stabilitetit Financiar dhe Buletini i Bilancit të Pagesave.

BQK-ja ka vazhduar me diseminimin në baza të rregullta në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankë Botërore, Eurostat dhe institucionet tjera me rëndësi të statistikave ekzistuese periodike mbi sektorin financiar dhe të jashtëm.

Gjatë vitit 2013, BQK-ja nuk ka marrë ndonjë asistencë teknike nga jashtë për nevojat të ngritjes së sistemit statistikor, përveç trajnimeve në formë të seminareve të ofruara nga organizata ndërkombëtare. FMN është një nga sponzoruesit kryesorë të trajnimeve të stafit të DS-së së BQK-së. Në anën tjetër, Drejtori i Departamentit të Statistikës të BQK-së ka ofruar asistencë teknike si ekspert i FMN-së në fushën e statistikave të sektorit me jashtë në Republikën e Kiribatit dhe ka marrë disa kërkesa për misione të tjera për vitin 2014.

6. Zhvillimet e brendshme

6.1. Auditimi i Brendshëm

Në përputhje me mandatin ligjor të përcaktuar me Ligjin e BQK-së nr. 03/L-209 (nenet 60 dhe 61), Zyra e Shefit të Auditimit të Brendshëm të BQK-se gjatë vitit 2013 ka kryer auditime të rregullta të përcaktuara me plan, por edhe auditime të rastit - Ad Hock. Në zhvillimin e aktiviteteve të tije, Auditimi i Brendshëm (AB) i është përmbajtur Standardeve Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale të AB-së.

Veprimtaria e AB-së gjatë vitit 2013 ka mbuluar aspektet që kanë të bëjnë me qeverisjen korporative, operacionet e zhvilluara dhe sistemet e informimit në nivel të organizatës.

Auditimet e rregullta janë kryer në baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Nga viti në vit, në mënyrë progresive kemi rritur mbulimin me auditime të tilla.

Fushëveprimi dhe mbulueshmëria e auditimit është mbështetur nga Universi i Auditimit që paraqet gjithë përfshirjen e aktiviteteve të auditimit, departamentet/divizionet dhe fushat që auditohen brenda periudhës trevjeçare 2013-2015.

Në univers dhe në plan vjetor të auditimit janë përfshirë departamente dhe fusha me rrezikshmëri dhe prioritet të lartë, të cilat në veçanti ndërlidhen me ruajtjen e pasurisë dhe reputacionit të BQK-së.

Auditimet e kryera, kanë përfshirë fushat e rëndësishme përmes së cilave operon BQK-ja. Theks i veçantë i është dhënë, funksionimit të kontrolleve të brendshme brenda BQK-së, menaxhimit financiar dhe të proceseve administrative, si dhe auditimit të sigurisë së sistemeve mbështetëse të TI-së.

AB, në përputhje me rekomandimet e dala nga Mekanizimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar “Safeguards Assessments” ka kryer auditime gjithëpërfshirëse dhe janë nxjerrë raporte në të cilët janë dhënë rekomandime përkatëse.

Gjithashtu, janë kryer katër (4) auditime të pavarura tremujorëshe dhe janë nxjerrë raportet përkatëse në lidhje me procesin e rekonsilimit të llogarive të Qeverisë. Auditime kryera na janë besuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në bazë të kërkesës së dalë nga një memorandum i mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së.

Me kërkesë të menaxhmentit të lartë, Departamenti i AB-së ka kryer edhe auditime rasti të paplanifikuara (Ad Hock).

Në vazhden e përcjelljes së Portofolios së Investimeve në bankat korrespondente të BQK-së, AB gjatë vitit 2013 ka përgatitur 47 raporte speciale në baza javore.

Në përputhje me Ligjin për BQK-në, Shefi i AB-së ka raportuar te Komiteti i Auditimit në baza tremujore. Raportimi, ka përfshirë një pasqyrim të përmbledhur të të gjeturave dhe rekomandimeve nga auditimet individuale të kryera gjatë vitit 2013. Raportet e dorëzuara më pas janë diskutuar nga Komiteti dhe nga Bordi i BQK-së dhe më pas çështjet janë adresuar te menaxhmenti ekzekutiv për trajtim të mëtutjeshëm.

Përmes këtyre raportimeve janë synuar dy qëllime kryesore:

- Për t'i komunikuar Menaxhmentit të BQK-së rezultatet e aktiviteteve të AB-së, çështjet e rëndësishme të identifikuara dhe të adresuara, ngecjet dhe masat e ndërmarra dhe progresin drejt përmirësimit, si dhe pajtueshmërinë me kornizën ligjore në arritjen e objektivave të BQK-së, si dhe

- Për të treguar përgjegjshmërinë e funksionit të AB-së në kryerjen e aktiviteteve të auditimit gjatë vitit dhe nivelin e performancës së arritur.

AB, gjatë vitit ka përcjellë procesin e adresimit të rekomandimeve dhe për nivelin e implementimit ka raportuar në mënyrë të veçantë të Menaxhmenti.

Për sa i përket bashkëpunimit me Bankat Qendrore të rajonit me të cilat BQK-ja ka ndërtuar marrëdhënia bashkëpunimi, gjatë vitit 2013 kemi realizuar vizita zyrtare me Bankën Popullore të Maqedonisë. Për të avancuar praktikën dhe metodologjinë e auditimit gjegjësisht standardizimit të raporteve të AB-së në bashkëpunim me Bankën e Maqedonisë kemi implementuar me sukses dy module të aplikacionit ARS, krijimit të Universitetit të Auditimit dhe krijimin e Raporteve të Standardizuara të AB-së.

Një projekt tjetër, gjithashtu i rëndësishëm i cili është implementuar ka të bëjë me aplikacionin-softuerin IDEA përmes së cilës është krijuar mundësia e kryerjes së auditimit në mënyrë më të avancuar, të shpejtë dhe më gjithëpërfshirëse.

